


871

24 35

---

**HISTORIA  
E  
LETTERSISE**



**ROMAKE**

871  
24 3P

UNIVERSITETI I TIRANËS "ENVER HOXHA"  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

MYZAFER KHAXHIU

HISTORIA E  
LETËRSISË ROMAKE

(Ripunim )



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR  
TIRANË

Redaktor : MARIE MATO

Hyri në shtyp qershor 1989  
Doli nga shtypi tetor 1989

Tirazhi 500 Formati 70x100/16 Stash 2204-82  
Shtypur në Kombinatin Poligrafik  
Shtypshkronja e Dispensave Tiranë 1989

## KREU I

### LETËRSIA ROMAKE

Nga mesi i shekullit III para erës së re filloi të zhvillohet letërsia e dytë e shoqërisë antike, letërsia romake.

Roma, komuniteti qëndror i fisit të latinëve, i dha emrin e saj gjithë Gadishullit Apenin në historinë e lashtë.

Gadishulli i Apenineve, që e ndan detin Mesdhe në pjesën perëndimore dhe në atë lindore, ka pasur rëndësi të madhe në historinë e pellgut të detit Mesdhe. Grekët e vjetër, Itali, fillimisht, quanin vetëm pjesën jugore të gadishullit të Apenineve. Vetëm duke filluar nga shekulli III para erës së re me këtë emër u përfshi i gjithë gadishulli.

Historikisht Italia është ndarë në tri pjesë : në pjesën jugore, të përbërë në përgjithësi nga provincat e sotme të Apulisë, Bazilikatës dhe të Kalabrisë si dhe nga ishulli i Sicelisë, që gjeografikisht është vazhdim i gadishullit Apenin; në pjesën e mesme ose qëndrore, të përbërë kryesisht nga Etruria (sot Toskana), Latiumi dhe nga krahina me pjellore Kampania; në pjesën veriore, të përbërë kryesisht nga pjesa kontinentale e vendit.

Shoqëria romake e skllavopronarisë në vijë të përgjithshme kaloi në po ato etapa zhvillimi nëpër të cilat kaloi dhe shoqëria greke: formimin e shoqërisë me klasa, politit me kontradiktat klasore, tipike për atë, dhe me rendin shtetëror republikan, më vonë koncentrimin e skllavërisë, shkatërrimin ekonomik të pronarëve të vegjël të lirë, shkatërrimin e politit dhe kalimin në diktaturën ushtarake. Por me gjithë ngjashmërinë dhe tipin e përbashkët



të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Greqisë dhe të Romës, rritja dhe dekadencia e shoqërisë romake të skllavopronarëve ndodhën në një kohë pak më të vonët në krahasim me Greqinë dhe me një ritëm tjetër, në rrethana të tjera historike dhe gjeografike, në rrethana të tjera ndërkombëtare: për këto arsye historia e Romës paraqet në vetvete një radhë veçorish specifike. Në periudhën e lulëzimit të saj me të madh Roma filloi ekspansionin dhe nënshtroi Greqinë, që ishte gjithnjë në rënie, dhe vendet helenistike. "Në Romë, siç thotë Engelsi, gjithë procesi përsëritet në shkallë më të lartë".

Kontradiktat shoqërore skllavopronare u acaruan shumë në Perandorinë Romake, gjë që shpuri në shkatërrimin e shoqërisë antike dhe përgatiti terrenin për krijimin e një mënyre të re e me përparimtare prodhimi, për krijimin e shoqërisë feudale, që do të mbështetej jo në shfrytëzimin e punës së skllavëve, por në atë të bujkrobërve.

Në këtë mënyrë, në Romë u përsërit rruga e përshkruar nga shoqëria greke, por në formë më të ndryshme dhe me të koklavitur. Kjo ngjashmëri në zhvillimin shoqëror midis Greqisë dhe Romës përcakton dhe ngjashmërinë që kanë në mes tyre letërsia romake me letërsinë greke, ashtu siç përcajtojnë veçoritë specifike të zhvillimit të tyre shoqëror dhe specifiken dhe origjinalitetin e letërsive të tyre.

Meqënëse u zhvillua më vonë se Greqia, Roma gjeti shpeshherë te grekët përgjigje të gatshme për çështjet e saj ideologjike. Shumë forma botëkuptimore e ideologjike, që zotëruan në Greqi në etapat e ndryshme të rrugës së saj historike, u panë të përshtatshme edhe për shoqërinë e dytë antike, për shoqërinë romake, në etapa të caktuara të zhvillimit të saj. Gjithçka morën romakët nga feja dhe filozofia, nga letërsia dhe arti grek ua përshtatën

nevojave të tyre, veçorive specifike të zhvillimit historik të tyre. Kështu letërsia romake është një letërsi me tipare origjinale, një etapë e veçantë në zhvillimin e përgjithshëm të letërsisë evropiane.

Rëndësia historike e letërsisë romake qëndron jo vetëm në faktin se ndihmoi në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë së Evropës Perëndimore, por edhe se u bë hallkë ndërlidhëse në mes të letërsisë greke dhe asaj evropiane. Në epokën e Rilindjes si dhe në shekujt XVII dhe XVIII letërsia greke është parë në Evropë përmes letërsisë romake. Idetë estetike të dramaturgjisë antike në teatrin e klasicizmit evropian depërtuan më tepër përmes veprës së dramaturgut romak Senekes, sesa përmes Eskitit, Sofokliut, dhe Euripidit. Eposi evropian i asaj kohe i drejtoi sytë më tepër nga "Eneida" e Virgjilit sesa nga poemat epike të Homerit. Vetëm "neohumanizmi" borgjez i shekullit XVIII iu drejtua drejtpërsëdrejti letërsisë greke. Ky orientim i ri bëri që në shekullin XIX të fillojë të duket një farë nënçmimi për letërsinë romake, duke e konsideruar atë si një imitim të thjeshtë të letërsisë së lashtë greke. Kjo pikëpamje është në themel krejtësisht e gabuar. Më gjithëse këto dy letërsi janë të një tipi, sepse të një tipi ishin dhe shoqëritë në të cilat u zhvilluan ato, dhe letërsia romake vërtet pati ndikim të fortë nga letërsia greke, që u zhvillua më parë, kurrësi nuk mund të thuhet se ajo është kopje e thjeshtë e origjinalit grek. Veç asaj në disa raste ajo u bë sintezë e gjithëatyre që dha letërsia greke në etapa të ndryshme të zhvillimit të saj. Kështu p.sh. Virgjili në "Eneiden" ose Horaci në lirikat e tij iu drejtuan letërsisë greke të periudhës klasike, duke përdorur njëkohësisht ç'kish më të mirë nga ana e stilit edhe letërsia helenistike. Me një fjalë ata u përpoqën të japin një sintezë të artit të grumbulluar gjatë shekujve.

### 1. PERIUDHA PARALETRARE

Letërsia romake, u zhvillua relativisht vonë. Ajo lindi aty nga mesi i shekullit II, në procesin e helenizimit të kulturës romake, atëherë kur Roma ishte bërë përfundimisht një polis skllavopronar dhe kishte mundur ta shtrinte pushtetin e vet në tërë Italinë.

Periudha e rënies së rendit fisnor dhe e lindjes së shoqërisë me klasa, periudhë që në Greqi njohu një lulëzim të madh letrar, për letërsinë romake kaqoi pothuaj pa asnjë fryt. Kjo prapambetje e letërsisë në krahasim me tempin e zhvillimit politik dhe shoqëror të komunës

romake i ka rrënjët e saj jo në "paaftësinë" e romakëve për të krijuar vepra arti, siç pohojnë ndonjëherë studiuesit borgjezë, por në kushtet specifike të historisë së hershme të Romës.

Roma ishte një nga komunitet e Laciut-it të lashtë, kra-hine në bregun perëndimor të Italisë, në jug të Etrurisë, që korrespondon afërsisht me Toskanën e sotme. Banorët e Laciut, latinët, përbënin një nga hallkat e zinxhirit të fiseve të Italisë, që kishin midis tyre afërsi kulture ose dhe gjuhësore. Gjuha latine i përket grupit të gjuhëve të ashtuquajtura "italike". Një degëzim tjetër të këtij grupi përbëjnë të folmet umbro-sabelike, midis të cilave me të njohura janë gjuha e umbreve (në pjesën lindore të Italisë Qëndrore) dhe gjuha e okseve (në Italinë e Mesme dhe Jugore).

Në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të parë popullsia e Italisë paraqiste një larmi të madhe etnografike dhe gjuhësore, sepse nga Alpet dhe nëpër detin Adriatik, në mijëvjeçarin II dhe në periudhën e mëvonshme, këtu qenë dyndur dhe vendosur me banim fise të ndryshme nga pikëpamja etnike.

Pjesën më të madhe të gadishullit të Apenineve në këtë kohë e banonin fiset indoevropiane të Italisë, më të rëndësishmet nga të cilët ishin latinët (në krahinën Latium), oskët (në Kampania), umbrët (krahina Umbria në Italinë e Mesme). dhe grupi i fiseve sabelike në pjesën e sipërme të pellgut të lumit Tiber, duke u përfshirë këtu Sabinët, që më vonë u shpërngulën në drejtim të Jugut, dhe pasi u përzier me oskët morën emrin samoritë. Këto fise në shumicën e tyre kishin depërtuar në Itali me sa duket në fillim të mijëvjeçarit I para erës së re nga krahinat e Evropës Qëndrore. Në Itali këto fise u përzier me fise të ndryshme.

Përveç italikëve, disa krahina të vendit i banonin fise të ndryshme ilire (p.sh. japigët në krahinën e Puljes, në juglindje të Italisë). Ka të ngjarë që të njëjtit grup gjuhësor t'i përkisnin edhe venetët në pjesën lindore të Italisë Veriore si dhe fiset që zakonisht quhen mbeturina të popullsisë autoktone më të lashtë të vendit (ligurët në pjesën perëndimore të Italisë Veriore, sikanët në Siceli, etj.

Toskana e sotme, në pjesën veriperëndimore të gadi-

shullit të Apenineve banohej nga etruskët, origjina etnike e të cilëve sot për sot nuk është përcaktuar. Kjo krahinë quhej Eturi.

Në zonën bregdetare të Italisë Jugore dhe pjesërisht të Italisë Qëndrore, si dhe në pjesën lindore të Siqelisë në shek. VIII-VI para erës së re, qenë ngulur kolonistët grekë, që kishin themeluar një varg qytetesh të rëndësishme : në gadishullin e Apenineve : qytetet Kuma, Neapoli (Krotoni), Sibarisi, Tarenti etj, në Sicili: Sirakuza, Mesana, Akraganti etj. Nga fiset që nuk flitnin në ndonjë gjuhë italiane ishin etruskët, të ardhur nuk dihet se nga në Itali në shekullin VIII para erës së re, dhe grekët, që kishin mbushur Sicilinë dhe Italinë e Jugut me një rrjetë kolonish të tyre, të cilat u quajtën me emrin "Magna Grecia" (Greqia e madhe).

Etruskët dhe grekët bënë me njëri-tjetrin luftë për hegjemoninë detare në brigjet perëndimore të Italisë. Laci-umi, i vendosur midis Etrurisë dhe kolonive greke të Kampansjës, u fut dhe ai në vallen e luftës.

Tradita e historianëve romakë e çon themelimin e Romës aty nga gjysma e shekullit VIII para erës së re (zakonisht nga viti 753). Megjithatë banorët e parë në territorin e Romës së ardhshme, latinët dhe sabinet, janë dukur përpara asaj date tradicionale, aty nga shekulli X-IX para erës së re. Bashkimi i këtyre ngulimeve u bë më vonë.

Rol vendimtar në formimin e polisit romak luajti epoka kur në Romë sunduan mbretërit e dinastisë etruske. Roma, që shërbeu si përçuese e ndikimit etrusk në Lacium, zinte vendin kryesor midis qyteteve të tjera latine. Në etapën e parë të historisë së Romës kushtet historike ndihmuan për një zhvillim të mbarë të kulturës së këtij polisi të ri. Në atë kohë u duk shkrimi, ndërsa feja filloi të ndërlikohej. Besimet e lashta të romakëve ishin mjaft primitive : sendet dhe proceset e veçanta kishin perënditë e veta që ndodheshin brenda këtyre sendeve dhe proceseve dhe ishin lidhur me to në mënyrë të pazgjidhshme. Këto hyjni përfytyroheshin prej romakëve të lashtë në formën e kafshëve, të ujkut, të qukapikut etj. Më vonë, krahas këtyre besimeve primitive filluan të futen, pjesërisht përmes etruskëve, kultet fetare greke dhe hyjnitë e tyre me formë njerëzore. Kështu hynë dhe u ngulën në Romë figurat e mitologjisë greke.

Nga fundi i shekullit VI para erës së re, mbretërit etruskë u përmbysën dhe u vendos republika aristokratike. Tani gjendja e Romës ndryshoi shumë, ajo e humbi epërsinë e saj në Lacium dhe u detyrua të bëjë luftëra të vazhdueshme me fqinjët e saj. Brendapërbrenda komunës romake në këtë kohë u zhvillua lufta midis plebejve dhe patricëve. Në këtë luftë të gjatë që vazhdoi gati dy shekuj (nga shekulli V deri në IV) plebejtë fituan mjaft të drejta politike, megjithëse aristokracia vazhdoi të ruajë gjithnjë privilegjet e saj, e përkrahur nga pronarët e vegjël të tokës dhe nga mbeturinat e rendit fisnor.

Etruskët ushtruan ndikim të madh kulturor në Romë në kohët e lashta. Shkrimi tek ata ishte përhapur shumë, megjithëse librat e tyre kishin karakter fetar dhe ushin mbushur me formula magjish. Etruskët nuk arritën të krijojnë letërsi artistike. Edhe fqinjët e tjerë të Romës nga fiset italike nuk mundën të ndikojnë për një farë zhvillimi letrar, sepse ata vetë ndodheshin në një nivel kulturor më të ulët se vetë romakët. Të gjithë këta faktorë: konservatorizmi, sundimi ideologjik i magëve dhe i falltarëve, ndikimi kulturor i etruskëve e frenuar zhvillimin ideologjik në përgjithësi dhe u bënë pengesë serioze për lindjen dhe zhvillimin e letërsisë artistike në Romë. Kjo gjë u pasqyrua veçanërisht në poezi e cila për shumë kohë vazhdoi të ruajë karakter folklorik.

Edhe në Romën e lashtë ashtu si në Greqi, kënga pati karakter sinkronik; ajo lindi si nevojë praktike për të shoqëruar procese të ndryshme të punës, akte e ceremoni fetare.

Permendoret me të lashta të poezisë romake janë himnet fetare, që janë ruajtur në shërbimet e priftërinjve-falltarë. Në muajt mars dhe tetor të çdo viti shoqata e priftërinjve të hyjnisë Mars kryente një ekskursion rreth qytetit të Romës. Të veshur si në luftë, me mburoja, shtiza dhe armë të tjera ata kërcenin nëpër rrugët e qytetit duke goditur me forcë mbi mburojat, duke thirrur e duke u drejtuar lutje fetare perëndive të ndryshme.

Një tjetër shoqatë priftërinjsh krentonte në muajin maj një festë treditore kushtuar hyjneshës së bujqësisë Dea Dia-s. Tri ditë me radhë falltarët dhe priftërinjtë kërcenin duke u drejtuar vazhdimisht lutjet e tyre hyjnine



që t'u jepnin prodhimet e mbara. Këto lloje këngësh u regjistruan dhe rastësisht kaluan edhe në brezat e mëvonshëm. Disa lloje të tjera këngësh i dimë jo nga shënimet e drejtpërdrejta, por nga ato që njoftojnë shkrimtarët romakë. Kështu këta na flasin për këngë të ndryshme të punës që këndoheshin kur vilej rrushi, kur tirej dhe endej leshi, na flasin për këngë barinjsh dhe lundërtarësh.

Ka aty-këtu ndonjë të dhënë edhe për këngët e djepit, nënnulla si dhe këngët për lodrat e fëmijëve. Me shumë të dhëna ka për këngët e riteve. Në raste varrimesh, shoqëruar me tingujt e flautes, ekzekutoheshin neniet, këngë që romakët ia kushtonin hyjneshës Nenia, si mbrojtëse e të vdekurve. Këndonin ose qanin me ligje gratë, të afërmit e të vdekurit, e në mënyrë të veçantë vajtojtat profesionale. Neniet shprehnin dhembjen e në të njëjtën kohë i thurnin lëndata të vdekurit, sepse sipas përfytyrimeve të njerëzve të lashtë, fjalët lavdëruese do të vdiqmonin atë në botën tjetër.

Fjala nenie takohet edhe te frigjianet në Azinë e Vogël, kurse në Romë kjo fjalë ka të ngjarë të jetë futur përmes etruskëve, me të cilët romakët kishin shumë ngjashmëri dhe pika kontakti në punën e riteve. Më vonë me fjalën nenie nisen të quajnë çdo këngë të trishtuar, monotone dhe të mërzitshme.

A) Edhe pasi u zhdukën, neniet nuk humbën plotësisht nga pikëpamja letrare; ato vazhduan të ndikojnë në epitafet shkruar në vargje :

E le nënën tënde  
Në dhimbje, në vaj  
Vdekje e ligë të rrëmbou  
Vajzë të virgjër e fatkeqe,  
Dritë moj e imja  
E le nënën në mjerim.

Ritmika dhe metri i vargut kanë frymën e poezisë popullore. Shembull për këtë mund të shërbejnë proverbat dhe fjalët e urta të popujve të ndryshëm. Kështu dalëngadalë u formua vargu. Vargu më i vjetër i letërsisë romake ishte vargu "saturnian", i përbërë nga dy të shkurtër me 5-7 rrokje. Ky ishte vargu primitiv italik. Ai u quajt "satur-

nian" për nder të hyjnisë shumë të lashtë Saturnit, të cilin biri i tij Jupiteri, sipas miteve, e dëboi nga qielli dhe e bëri mbret të Italisë. Ky lloj vargu ishte i përthyeshëm dhe i larmishëm, dhe nuk u përfshi në ligjet e rrepta të sistemit metrik të mëvonshëm; prandaj dhe dalëngadalë u zhduk.

Në festat që bëheshin për të siguruar me anën e riteve fetare pjellshmëri këndoheshin këngë tallëse si jambet greke. Ashtu si te grekët, edhe te romakët e qeshur, tallja dhe goja e prishur mbaheshin si mjete që ndihmonin për të marrë prodhime të bollshme si dhe për t'u ruajtur nga "demonët" e këqinj që e kishin zili lumturinë e njerëzve. Këto këngë u quajtën fescenine, ka të ngjarë nga emri i qytetit Fescennium në Eturinë e Jugut.

Edhe poeti romak Horaci në "Mesazhet" e tij flet për këto lloje këngësh :

Në këto festa hyri zakoni i fescenineve,  
ku fshatarët me vargje shpotitëse mbulonin  
me radhë njeri-tjetrin...

Momenti i "fyerjeve" rituale duket sidomos në mënyrë të qartë në këngët triumfale. "Triumfi" ishte nderi më i lartë që mund t'i bëhej një komandanit të ushtrisë, i cili kishte korrur një fitore të shkëlqyer kundër armikut. Me një parakalim solemn ushtria hynte në Romë; triumfatori atë ditë merrte trajtën e Jupiterit Kapitolin, përëndisë më të lashtë të komunës romake. I veshur si Jupiteri, mbi një karro të artë, të hequr nga katër kuaj të bardhë ai shkonte drejt tempullit të Kapitolit, ku vinte mbi krye kurorën e fitores me dafina.

Gjatë kohës së procesionit luftëtarët këndonin këngë që "turpëronin" komandantin. Në triumfin e Jul Cezarit, p.sh. këndonin për plangprishjen dhe shturjen e tij :

Qytetarë, ruani gratë, me ne është kurvar tullaci,  
gjithë prenë rrush e kumbulla e bëri,  
në Romë pare mori hua...

Sharjet dhe fyerjet ishin pjesë e domosdoshme ceremonive triumfale. Gjithë karakteri i triumfit riiste qartë për faktin

se triumfatori në këto ceremoni paraqitej si mishërim i perëndisë së komunës, por më vonë ky identifikim u quajt si diçka jo e drejtë dhe skllavi që mbante mbi kryet e triumfatorit kurorën e artë i përsëriste atij vazhdimisht: "Kthe kryet nga mbrapa dhe mos harro se ti je njeri".

Për të mënjanuar rrezikun se mos triumfatorin e "hanin me sy" i jepnin atij disa nuska të posaçme. Për këtë arsye në këngët triumfale kishte mjaft sharje dhe poshtërime, që të mos ndizej cmira dhe zilia e të mos merrte sysh triumfatorin.

Burimet përmendin dhe një lloj tjetër këngësh folklorike, këngët e gostisë. Mjaft të dhëna interesante lidhur me këtë na jep Katoni, burrë shteti romak dhe shkrimtar i shekullit II para erës së re. Sipas fjalëve të tij, dikur nëpër gostira nga të pranishmit këndoheshin me radhë këngë të shoqëruara nga flauti, që u thurnin lavde burrave të shquar. Nga këto këngë, që me sa duket ishin të llojit liriko-epik nuk ka mbetur asnjë gjurmë. Ky zakon, për të cilin flet Katoni, ishte shumë më përpara atij. Madje edhe autorë që kanë jetuar para Katonit dhe ata që kanë ardhur më vonë nuk kanë pasur asnjë dokument rreth këngëve të gostisë për të cilat ata kanë folur. Problemi për gjenezën e eposit në Romë është bërë vazhdimisht objekt diskutimesh.

Në veprat e historianëve romakë ne gjejmë një paraqitje mjaft sistematike të jetës së komunës romake, duke filluar nga momenti i "themelimit" hipotetik të saj në vitin 753 para erës së re, po ashtu na jepen të dhëna të hollësishme edhe rreth personaliteteve të veçanta të Romës së lashtë. Sikur të gjitha këto të dhëna të ishin të vërteta, atëherë mund të thuhej se asnjë popull i lashtë nuk e ka njohur me saktësi të kaluarën e tij sa e ka njohur populli romak. Sidoqoftë shumë gjëra nga tregimet e historianëve romakë duket se kanë karakter legjendar. Gojëdhënat për dy binjakët që themeluan Romën, Romulin dhe Remin, për vajzën Tarpea që i dorëzoi armikut kështjellën, që mbronte babai i saj, për dyluftimin e tre vëllezërve binjakë Horacë me tre vëllezër binjakë Kuriace etj. të gjitha këto janë subjekte tipike folklorike, të njohura në popuj të ndryshëm. Te zbukuruara nga legjendat janë edhe figurat e personaliteteve të republikës së hershme, si Koriolani, Cincinati ose Kamili.

Me legjendat e vendit u bashkuan edhe legjendat greke, të cilat depërtuan në Laciun ose drejtpërsëdrejti nga grekët e Kampanjës, ose përmes Etrurisë. Italia që në kohë të lashta njihej në mitologjinë greke. Kjo njihej me emrin "Hesperia", vendi "i mbrëmjes", i "perëndimit", prandaj dhe vendi i vdekjes. Madje udhëtimet e Odisesë, Polifemi dhe Eoli, Circea dhe zbritja e Odisesë në botën e të vdekurve janë lokalizuar pranë Italisë dhe Sicilisë. Sipas strofave të fundit të veprës së Hesiodit, "Teogonia", Latini është djali i Odisesë dhe i Circes, që sundoi mbi tirrenasit (etruskët). Në Itali mendohej të kishin ngrysur ditët e fundit të jetës së tyre heronjtë e mitit grek, Diomedei dhe Filokteti. Këto legjenda u morën edhe nga fiset italiane, të cilat e quanin veten të lidhur me këta heronj. Në Laciun u përhap veçanërisht legjenda mbi heroin trojan Eneun, një nga personazhet e "Iliadës". Eneu, djali i Afërditës dhe i trojanit Ankis, braktisi atdheun pas rrënimit të tij dhe erdhi në Laciun, ku u martua me Lavinian, vajzën e mbretit Latin. Djali i tij, Askani u mbajt si themelues i Alba Longes, që ishte qendra më e madhe latine para se të themelohej Roma. Si pasardhës të Askanit romakët mbanin Romulin. Kështu që figurat e epopesë homerike hynë në këtë mënyrë në ciklin e gojëdhënave romake.

Lodrat rituale, që ishin të zakonshme për fiset që merreshin me bujqësi, hynë edhe në Romë. Në festat e ndryshme organizoheshin procesione njerëzish me maska, që bërthmën rrugëve duke ndërruar fjalë me publikun. Këto lodra rituale shoqëroheshin me gjeste dhe me dialoge të improvizuara. Këngët shpotitëse fescenine të festave bujqësore ekzekutoheshin me maska dhe kishin të gjitha vetitë e lirisë karnavaleske. Veçanërisht e pasur me elemente karnavaleske ishte festa e Saturnaleve në muajin dhjetor, në të cilën "përmbyseshin" marrëdhëniet e zakonshme shoqërore; zotërinjtë u shërbenin skellërve, caktohej me short "mbretit i Saturnaleve", vendimet e të cilit ishin të detyruara për të gjithë pjesëmarrësit e festës. Këto mund të quhen si elementet fillestare të dramës. Format më të koklavitura të lodrave dramatike hynë në Romë nga jashtë, nga vendet fqinje. Sipas dëshmiave të historianëve romakë, për herë të parë në vitin 364 para erës së re u organizuan "lodrat skenike" si mjet për të zbutur zemërimin hyjnor" gjatë

epidemisë : me këtë rast u ftuan të vijnë nga Etruria kërcimtare, të cilët ekzekutonin valle mimike. Ndikimi etrusk në lodrat skenike të Romës duket edhe në terminologjinë : aktorët në Romë emëroheshin me fjalën etruske historiones. Një lloj tjetër i lodrave skenike hyri nga fqinjët që ndodheshin në jugë të Romës, nga oskët e Kampanjës. Kjo lodër skenike u quajt atelana (nga emri i qytetit të Kampanjës, Atela). Atelanta ishte dramë e shkurtër me një akt me maska të përhershme karikature. Atelana ishte dramë folklorike dhe luhej nga aktorë amatorë dhe joprofesionistë. Ajo ruajti edhe në kohë të mëvonshme elemente të lirisë karnavaleske : përqueshte persona të veçantë dhe institucione shoqërore.

Në folklorin romak gjejmë gjithashtu edhe forma të vogla si proverba, shprehje të ndryshme etj. Fjalët e këtyre formave të vogla folklorike ishin me rimë dhe plot aliteracione. Në një lutje të vjetër për mbrodhësi në prodhimin bujqësor thuhet : pastores pecuaque selva servassis (ruaj shëndoshë e mirë barinjtë dhe dhentë). Ritmika e lashtë e llojeve folkloristike ndikoi edhe në poetet e parë romakë, të cilët deri sa nuk ishin futur format poetike greke, përdorën vargun saturnian.

Poezia deri në shekullin III para erës së re kishte karakter gojor, megjithëse në Romë shkrimi njihej që më parë. Ka mbishkrime që u përkasin shekujve VI madje dhe VII para erës së re. Kurse nga gjysma e shekullit V kishte ligje të shkruara ("ligjet e 12 tabelave"). Magjistratet dhe priftërinjtë bënë në këto tabela shënime të ndryshme lidhur me veprimtarinë e tyre. Rëndësi më të madhe kishin materialet e kolegjit të priftërinjve madhorë. Çdo vit prifti më i lartë vinte një dërasë, në të cilin pastaj shënoheshin ngjarjet më të rëndësishme të vitit. Këto shënime vjetore që u quajtën annale (annales) dhe që u mbajtën nga priftërinjtë pontifikse shërbyen më vonë si pikënisje për historiografinë romake.

Veprimtaria shtetërore e Romës krijoi disa kushte edhe për zhvillimin e fjalimit publik në senat, në mbledhje të popullit dhe në gjyqe. Një nga llojet e oratorisë së lashtë romake ishte edhe "fjala lavdëruese në varrim". Varrimi te romakët e pasur bëhej me salltanet shumë të madh. Sipas fytyrës së të vdekurit bëhej maska, ku shënohej emri dhe



ofiqi që kishte ai. Maska të tilla ruheshin në sallën kryesore të shtëpisë romake (atrium). Kështu që të parët dukej sikur mbeteshin në shtëpi së bashku me pasardhësit e tyre. Kur vdiste ndonjë nga përfaqësuesit e fisnikërisë romake gjatë procesionit të varrimit hypnin nëpër qerre një-rëz që mbanin në fytyrat e tyre maskat e të parëve të të vdekurve. Procesioni kthehej në një manifestim të gjallë dhe drejtohej për nga forumi, ku përqëndrohej tërë jeta publike e Romës. Aty njeriu më i afërt i të vdekurit ose dhe ndonjë tjetër, i caktuar nga shteti, mbante "fjalën lavdëruese" të rastit, ku numëroheshin me radhë të gjitha meritat e të vdekurit dhe të të parëve të tij. Prireja për të rritur lavdinë e familjes dhe të fisit shpesh çoi deri në falsifikime. Shkrimtarët romakë shpeshherë ankohen për arsye se tradita historike ka qenë shtrembëruar nga "fjalimet lavdëruese" të permortshme dhe nga mbishkrimet e rreme të shënuara në maska. Vetëm fisnikëria, domethënë pasardhësit e personave që zinin ofiqe të larta në shtet, mund të paraqitnin këtë "maskaradë të permortshme". Shtresat e tjera të popullsisë nuk kishin të drejtë. Edhe fjalimi publik u zhvillua kryesisht në rrethet e aristokracisë. Mbledhja popullore vetëm mund të votonte për propozimet që bëheshin, kurse përfaqësuesit e popullit pothuajse nuk kishin të drejtë të dilnin me fjalime të hartuara në prozë përpara publikut. Madje edhe më vonë kur në Romë u zhvillua letërsia artistike proza mbahej si më e përshtatshme për aristokratët sesa poezia.

"Poezia nuk nderohej" - shkruan për kohët e lashta shkrimtari romak i shekullit II para erës së re Katoni: kush merrej me të thoshin se kish qejf për gostira dhe atëhere e quanin të papunë.

## 2. SHOQËRIA DHE KULTURA ROMAKE NË SHEKULLIN III DHE NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT II PARA ERËS SË RE

Me mbarimin e luftës midis patricëve dhe plebejve aty nga shekulli IV dhe III Roma u formua si polis plotësisht. Nga shekulli IV deri në gjysmën e shekullit III Roma ka nënshtruar komonet fqinje të krahinës së Laciumit, ka pushtuar krejt pjesën qendrore të Italisë, Etrurinë në Veri dhe në Jug krejt kolonitë greke. Roma tani ka shtënë

në duart e saj pothuaj tërë Gadishullin Apenin, me përjashtim të pjesës veriore të quajtur Galia cisalpine (Galia këndeje Alpeve).

Mbas gjithë këtyre pushtimeve, Roma nga politika italiane kaloi në politikën mesdhetare. Ajo tani synonte drejt ekspansionit botëror për kushtet e asaj kohe. "Luftërat imperialiste - thotë Lenini, - janë bërë edhe në terrenin e skllavërisë. Lufta e Romës me Kartagjenën ka qenë nga të dyja anët luftë imperialiste". Me dobësimin e Kartagjenës si fuqi detare, Roma mundi të pushtojë ishujt e Mesdheut Perëndimor dhe një pjesë të Spanjës. Në shekullin II para erës së re, Roma u shndërrua në një fuqi të madhe. Në këtë kohë ajo nënshtroi Maqedoninë dhe Greqinë evropiane, hodhi në dorë bregdetin perëndimor të Azisë së Vogël dhe pushtoi krahinën e Kartagjenës ("Afrikën" - siç quhej në atë kohë), gadishullin e Pireneve dhe Galinë cisalpine.

Luftërat e njëpasnjëshme sollën si rrjedhim grumbullimin e madh të skllavërve dhe të pasurive, të cilat u përqëndruan në duart e klasës sunduese. Me grumbullimin e kapitaleve të mëdha dhe me punën e lirë të skllavërve aristokracia kaloi në krijimin e ekonomive të mëdha lokale që morën formën e pronave shumë të gjera, që u quajtën latifunde.

Në gjirin e aristokracisë romake u krijuan grupëzime me influencë në jetën shtetërore. Njeri prej tyre kërkonte të ndalohehin pushtimet dhe të krijoheshin një rrjetë shtetesh de jure të pavarura, por në realitet të nënshtuar senatit. Ky grupëzim kryesohej nga familja e Scipioneve që ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturor të Romës dhe pjesërisht në zhvillimin e letërsisë romake. Kontradiktat në gjirin e klasës sunduese kishin lidhje edhe me çështjet e politikës së brendshme. Grupëzimi i Scipioneve mbronte pronarët e vegjël italikë, baza ekonomike e të cilëve kishin filluar të tronditej nga konkurrenca e punës së skllavërve. Dhe pronarët e vegjël, mbarë fshatarësia italike ishte mbështetja shoqërore e republikës romake dhe bazë e fuqisë së saj ushtarake. Prandaj rënia ekonomike e këtyre shtresave shoqërore i shqetësonte disa rrethe aristokratike. Kontradiktat e shoqërisë skllavopronare, që kishin shkaktërruar dikur sistemin e polisit në Greqi, filluan të ndiheshin mjaft edhe në Romë.

Ndryshime nisën të vihen re edhe në lëmin e kulturës. Shkak i këtyre ndryshimeve gjer në një farë mase u bë pushtimi i Kampanjës, që i vuri romakët në kontakt të drejtpërdrejtë me grekët e Italisë së Jugut. Kështu filloi helenizimi i kulturës romake. Helenizimi u shtri edhe në anët e ndryshme të jetës. Në jetën e përditshme u fut kultura materiale greke, zakonet, emrat greke. Njohja e gjuhës dhe e kulturës greke u bë si modë për përfaqësuesit e shtresave të pasura. Faktorë të tjerë që ndihmuan në helenizimin e kulturës romake ishin dhe këta: në fund të shekullit III para erës së re në Romë jetonte një numër i madh grekësh të ardhur nga Italia e Jugut, krahas tyre kishte dhe një mori skllëvërish grekë, të grumbulluar në Romë nga viset e ndryshme. Shpesh skllëvërit grekë punonte si mësues në familjet aristokrate. Edhe feja filloi të helenizohet. Në të vërtetë romakët njiheshin me mitologjinë greke qysh më parë, në sajë të artit të etruskëve dhe të kulteve që ata kishin marrë nga grekët.

Si përçues i rëndësishëm i kulturës dhe i ideologjisë greke u bë në atë kohë letërsia.

Një shkrimtar shumë i lashtë romak, që i përket periudhës kur letërsia romake ende nuk kishte marrë trajtën e mirëfilltë artistike ishte APPIUS KLAUDI. Ka jetuar nga fundi i shekullit IV dhe fillimi i shekullit III. Ka qenë burrë shteti dhe përparimtar. Megjithëse ishte patric, ai luftoi kundër konservatorizmit dhe privilegjeve të patricëve. APPIUS KLAUDI që i pari në Romë që e çmoi rëndësinë e letërsisë si fuqi ideologjike. Ai vetë shkroi një përmbledhje me sentenca, nga të cilat kanë mbetur vetëm tri. Sentenca "çdo njeri është farkëtar i fatit të vet" është bërë tani më e njohur.

Poetët e parë romakë zakonisht kanë qenë njerëz me pozitë jo të lartë shoqërore dhe shpesh jo edhe qytetarë romakë, por të ardhur nga krahinat e tjera të Italisë ose skllëvër të liruar.

Në fillimet e saj letërsia romake pati karakter të theksuar imitimi. Shkrimtarët riprodhuan modelet greke në formë përkthimi ose përpunimi. Natyrisht ata u përpoqën të zgjidhnin nga letërsia greke ato vepra që u përshtateshin kërkesave ideologjike të shoqërisë së tyre dhe nivelit kulturor të popullit. Për këto arsye u drejtuan krye-

sisht nga gjinitë e lashta letrare, karakteristike për periudhën e polisit, nga eposi, tragjedia dhe komedia. Me pak të përshtatshme për këtë periudhë të zhvillimit shoqëror në Romë ishin rrymat moderne letrare të helenizmit.

### 3. POETËT E PARË ROMAKË

#### LIV ANDRONIKU

Një nga poetët e parë romakë ka qenë Liv Androniku grek me origjinë, i zënë rob dhe më vonë i liruar. Ai përktheu në gjuhën latine "Odisenë" e Homerit. E bëri këtë që ta fuste si libër leximi në shkollë, sipas sistemit të shkollës greke ku arsimit fillor niste me leximin dhe shpjegimin e poemave homerike. Arsyja që Liv Androniku përktheu "Odisenë" dhe jo "Iliadën" mund të merret me mend. Përveç faktit që "Odisea" kishte karakter më të theksuar moral-pedagogjik, arsyeja kryesore ishte se figura e Odisesë dhe aventurat e tij ishin të lokalizuara në Sicili dhe Itali, gjë që paraqiste interes lokal për romakët.

"Odisea" latine mbeti për dy shekuj me radhë tekst bazë në shkollën romake dhe në të njëjtën kohë u bë monumenti i parë i letërsisë latine. Puna e Livit ka qenë një gjë e re dhe e pashembullt; ky ishte përkthimi i parë artistik në letërsinë evropiane. Livi bëri mjaft ndryshime në "Odisenë" e tij. Nga ato fragmente, që kanë mbetur shihet qartë se ai është sjellë me shumë liri ndaj origjinalit, shpesh ritregon me fjalët e tij, thjeshtëson episodet, ndryshon figurat, perënditë i emëron sipas mënyrës latine.

Edhe përkthyesit e mëvonshëm romakë, duke u nisur nga ideja për t'iu përshtatur nevojave kulturore të Romës, për përkthimet nga gjuhët e huaja ndoqën parimet e përkthimit të lirë, që krijoi në kohën e tij Liv Androniku. Përkthime të tilla mbaheshin si krijime origjinale letrare.

Nga viti 240 para erës së re Liv Andronikun e shohim të merret me dramaturgji : përpunonin tragjeditë dhe komeditë greke për skenën romake. Tragjeditë e përpunuara në gjuhën latine kishin tematikë mitologjike greke. Livit i pëlqenin sidomos subjektet e ciklit mitologjik grek që lidheshin me Romën. Edhe në komeditë u ruajtën subjektet dhe personazhet greke.

Komeditë e para në Romë u quajtën "komedi e mantelit"

(comoedia palliata), palium ishte manteli grek. Aktorët visheshin me kostum grek. Ndërsa komedia me personazhe romake që u quajt "komedi e togës" (comoedia togata) erdhi më vonë në Romë. "Komedia e mantelit" u mbështet kryesisht në pjesët e komedisë së mesme dhe të komedisë së re antike. Komedia e lashtë e shekullit V me prirjet e saj të forta politike nuk zgjonte interes për skenën romake;

Liv Androniku shkroi dhe himne korale me rastin e ngjarjeve të shënuara sipas porosisë së qeverisë romake. Livi hodhi bazat e gjinive të ndryshme në letërsinë romake. Prandaj dhe liria që iu dha këtij ish-skllavi grek nuk ish tjetër veç njohja zyrtare e meritave të tij.

Poeti i dytë romak, që e filloi veprimtarinë e tij letrare para vitit 240 ka qenë dhe GNEJ NEVI.

### GNEJ NEVI (274-201 P.e.r)

Ky ishte nga krahina e

Kampanjës dhe kishte marrë pjesë në luftën e parë Punike. Nevi u përpoq ta aktualizonte letërsinë, ta pasuronte me tematikë romake. Në komeditë e tij ai kritikoi me guxim burrat e shtetit romak madje duke përmendur dhe emrat e tyre. Midis aristokratëve të kritikuar ishte dhe familja e Meteleve. Por për kushtet politike dhe shoqërore të Romës kjo liri ishte tepër e guximshme, ndaj si dënim e zbuar nga Roma. Autorët e mëvonshëm të komedive nuk guxuan të sulmojnë autoritetet e shtetit romak dhe në përgjithësi i mënjanuan temat politike aktuale.

Nevi hartoi tragjedi origjinale me subjekt romak. Këto tragjedi u quajtën "pretekstate", (fabula praerextata), sepse personazhet visheshin me pretekstin, që ishte toga e magjistrave dhe e priftërinjve romakë, e zbukuruar me një vilar të purpurt.

Tragjeditë e Nevit nuk patën sukses. Ai la gjurmë në letërsinë romake me epopenë e tij historike "Lufta Punike". Në themel të kësaj vepre poetike qëndron një ngjarje historike jo e largët : lufta e parë punike. Por faktet historike janë vendosur në një kohë të hershme mitologjike, ku marrin pjesë, ashtu si në poemat greke, edhe hyjnitë.

Poema epike e Gnej Nevit fillon me shkatërrimin e Trojës, me ardhjen e Aeneas në Itali. Ashtu si në "Iliadë" edhe në këtë vepër subjekti shtjellohet krahas me planin tokësor



edhe në planin olimpik: nëna e Eneas, Venera, mbron të birin para Jupiterit. Ky episod u shfrytëzua më vonë nga Virgjili në veprën e tij "Eneida". Në poemën e Nevit përmendet edhe mbretëresha Didona, themeluesja e Kartagjenës. Në "Eneidën" e Virgjilit do të tregohet se si Enea, pas shumë shtegtimesh plot rreziqe dhe fatkeqësi, bie në Kartagjenë dhe ay dashurohet me Didonën, të cilën ai më vonë e braktis për të vazhduar udhëtimin drejt Italisë. Te Virgjili Didona mallkon Enean dhe romakët, dhe kështu sipas gojëdhënës, nisi armiqësia midis Kartagjenës dhe Romës, që sipas legjendës u themelua nga nipërit e Eneas trojan.

Nuk dihet në se edhe tek Nevi subjekti ka pasur thurje të tillë. Po të ishte kështu, atëherë dashuria e braktisur e Didonës duhej të kishte shërbyer si argument mitologjik i armiqësisë midis kartagjenasve dhe romakëve, që gjeti shprehjen e saj në luftën punike, e cila paraqitet hollësisht në pjesën e dytë të poemës.

### KUINT ENNI

(239 -169 para erës së re)

Kuint Enni, poet i njohur romak, lindi në një qytet të Kalabrisë, ku krahas gjuhës latine ishte mjaft e njohur edhe

gjuha greke. Enni, ka të ngjarë, të ketë marrë pjesë në luftën e dytë punike kundër Kartagjenës. Ai u njoh me Katonin Plak, i cili e solli atë në Romë. Këtu hyri në rrethin e Scipionëve. Ky ishte rreth i aristokracisë romake që luftonte për njohjen e thellë me kulturën, filozofinë, oratorinë dhe letërsinë greke. Enni, me origjinë plebease, u bë ashtu sikurse Terenci, ideolog i këtij rrethi. Ai përpunoi për teatrin romak tragjedinë dhe komedinë greke, përktheu poema filozofike.

Në frymën e tendencave liberale iluministe të rrethit të Scipionëve Enni shkroi një poemë me titullin "Epiharmi", që nuk ka arritur deri tek ne. Në këtë vepër ai u bëntë njohur romakëve natyrfilozofinë greke dhe fenë mitologjike e shpjegon në mënyrë racionaliste. Enni përktheu "Shënimet e shenjta" të Evgemerit, i cili argumentoi se perënditë e mitologjisë nuk janë veç njerëz të hyjnizuar. Enni shkroi dhe "Satura", vepër me tematikë të larmishme në vargje.

LIBRARI E MUSEUT  
45331

Por vepra kryesore e tij është "Analet" poemë historike e përbërë nga 18 libra, nga të cilat janë ruajtur rreth 600 vargje. Poeti këndon në vargje historinë e Romës që nga themelimi i saj deri te luftërat që bëri ajo në Lindje. Tendenca e poemës është t'i thurë lavde pushtimeve ekspansioniste romake si dhe prijësve ushtarake të dalë nga aristokracia. Ennin më vonë e quajtn "Homeai latin". Poema është shkruar me vargun e lashtë saturnian dhe në heksametrin daktilik të Homerit, i cili që nga ajo kohë hodhi rrënjë në eposin romak. Enni i dha një zhvillim të ri gjuhës poetike latine dhe ndikoi në eposin e Lukrecit e të Virgjilit. Enni e himnizoi veten në epitafin që iu shkrua mbi varr :

Këtu ju shihni, o qytetarë, Ennin, poetik plak;  
 Bëmat e lavdishme të etërve tuaj këndoi ai.  
 E pse të qani mbi varrin tim? Përse të derdhni lot?  
 I gjallë jam unë në vargun e madhërishëm :  
 varg që jeton në gojën e të gjithëve.

#### 4. KOMEDIA ROMAKE

##### PLAUTI

Autori i shquar romak Pla-

(254-184 para erës së re)

auti, me origjinë nga Umbria, krahinë në verilindje të Laciumit, e zhvilloi veprimtarinë e tij letrare nga gjysma e dytë e shekullit III dhe fillimi i shekullit II para erës së re. Vdiq rreth vitit 184.

Si dramaturg ai ishte shumë prodhimtar. La një sasi të madhe komedish, me të cilat më vonë u përziën dhe pjesë jo të tija, por që u vunë hë skenë me emrin e tij. Më vonë fillofogët romakë përcaktuan si trashëgim i padiskutueshëm i Plautit, 21 vepra.

Plauti punoi në lëmin e komedisë paliate, domethënë të komedisë me subjekt grek. Ai ndryshoi dhe përpunoi për skenën romake pjesët e komediografëve grekë, kryesisht të përfaqësuesve të komedisë së re antike Menandrit, Filemonit dhe Difilit.

Plauti u përpoq t'ua përshtatë komeditë e tij shijeve



të publikut romak, botëkuptimit dhe nivelit kulturor dhe estetik të tij. Dhe publiku romak që në atë kohë përbëhej kryesisht nga plebejtë e qytetit të Romës, parapëlqente më shumë mundjet me grushte se sa lojën e aktorëve. Në këto kushte Plauti u detyrua ta dobësojë anën serioze të komedive greke, tek të cilat u mbështet, e të futë në to elementet e bufonadës dhe të farses, e t'u japë kështu komedive të tij karakter të theksuar komiciteti.

Në kushtet e zhvillimit të skllavopronarisë, të ekonomisë pekuniare dhe të fillimit të degjenerimit të familjes patriarkale romake, figurat e personazheve dhe subjektet e komedisë familjare greke u bënë mjaft aktuale në Romë, dhe Plauti, ashtu si dramaturgët e tjerë të shekujve III-II, duke filluar me Liv Andronikun e përpunoi dhe u përshtati shijeve dhe skenës romake komedinë "e re greke" të Filemonit, Difilit dhe pjesërisht të Menandrit. Gjithsesi shekujt III dhe II për Romën nuk ishin, siç ishin në Greqi, epoka e rënies; kjo ishte periudha e rritjes së vrullshme dhe e zhvillimit të jetës politike shoqërore, periudha e forcimit të shtresave plebease. Fryma e epokës u pasqyrua në zgjidhjen e subjekteve të komedisë, në dinamikën e zhvillimit të veprimtarisë në optimizmin, që karakterizon komeditë e Plautit. Në këtë vështrim komedia e tij është mjaft demokratike dhe shpreh psikologjinë shoqërore të plegut romak.

Komizimi i Plautit është në lidhje të ngushtë me bufonadën popullore të atellanës italice. Për të kënaqur shijet dhe interesat e plebejve Plauti ndonjëherë largohet nga ndikimi i komedisë së re greke dhe futet në jetën e Romës duke përdorur terminologji romake, sidomos atë juridike.

Një nga komeditë e Plautit, me elemente të theksuara te bufonadës është "Pseudoli". Me këtë emër greko-latin që do të thotë "gënjeshtër", "dinakeri" është emëruar protagonisti. Subjekti i komedisë është çlirimi i një vajze nga thonjtë e një kodoshi.

Pseudoli nuk është një mashtrues dhe dinak i zakonshëm; ky është një mjeshtër i talentuar i shpikjeve të tij. Figurën e skllavit dinak, siç është në këtë rast Pseudoli, Plautie jep me dashuri dhe e bën figurë qendrore të shumë komedive të tij.

Veprimi zhvillohet në Athinë përpara dy shtëpive; njera

nga këto është e Simonit, athinjtë i pasur, dhe tjetra e kodoshit Balion. Djali i Simonit, Kalidori, kishte marrë letër nga mikja e tij Fenikja e cila ë lajmëronte se posa i ishte shitur një ushtari maqedonas nga padroni i saj Balioni. Kalidori i kërkon ndihmë Pseudolit, i cili ku me të tallur e ku seriozisht, në sajë të shkathtësisë së tij, arrin ta çlirojë Feniken dhe t'ia kthejë përsëri të dashurit të saj Kalidorit.

Kjo komedi nga ana kompozicionale ka mjaft zbrazëtira. Në të janë futur motive dhe situata të cilat mbeten pa u zhvilluar. Shumë skena mbeten në vend e nuk shkojnë përpara. Kjo ndodh nga qe Plauti nuk u jep rëndësi këtyre gjërave. Ai më tepër u kushton vëmendje efektit dhe fuqisë komike të një skenë apo të një motivi të caktuar, sesa vendit që zënë ato në tërësinë kompozicionale. Plauti shpesh komeditë e tij i thur shumë lirisht, pa i ngushtuar mundësitë e tij krijuese nga kërkesat e kompozicionit.

Për një kompozicion të lirë dhe arbitrar, që bashkon skena pa ndonjë lidhje midis tyre, dëshmon dhe komedia "Stihu". Dy motra janë martuar me dy vëllezër. Ka kohë që burrat e tyre janë larguar nga shtëpia për të rregulluar disa punë dhe nuk japin asnjë lajm për veten. Gratë besnike e presin me padurim kthimin e tyre, në kundërshtim me të jatën, që kërkon t'i martojë përsëri. Për plakun në martesë ka rëndësi vetëm ana monetare. Të dy motrat e martuara në komedi bëhen flamurtare të pikëpamjeve të reja mbi martesën. Ato e quajnë martesën si diçka personale, jashtë çdo interesi ekonomik.

Burrat më në fund kthehen, duke sjellë pasuri të mëdha. Por në skenat që zhvillohen tani rreth këtyre ngjarjeve ata nuk marrin fare pjesë. Vepra duhej të mbaronte me një festë familjare, ndërsa akti i fundit paraqet një festë tjetër paralele; banketin e shturur të skllëvërve, me emrin e njerit prej të cilëve është quajtur dhe pjesa. Komedia nuk ka një intrigë të lidhur. Kjo paraqet një varg skenash, të bashkuara rreth motivit të kthimit të burave në shtëpitë e tyre.

Bashkimi mekanik i dy intrigave shihet dhe në komedinë "Ushtari mburracak", një nga veprat më të njohura të Plautit. Portreti fizik i ushtarit jepet që në skenën e parë. Ai është i veshur me rrobe të bukura; armatimi i

tij shkëlqen si dielli : mbi krye mban një perkrenare me pendë, një mburojë të ndritshme e një shpate të madhe. Ky është ushtari mburracak, Pirgopoliniku, që greqisht do të tnotë fitues kështjellash dhe qytetesh. Pirgopoliniku është njeri sa pa vlerë, aq edhe mendjemadh e krenar. I kënaqur, fryhet si një gjel, kur dëgjon lavdërimet për meritat e tij të paqena që i bën paraziti Artotrog. Por ajo që i pëlqen më shumë është të dëgjojë se ç'përshtypje të pashlyera le ai te gratë. Me këtë vetëdije të fryrë donkisnoteske Pirgopoliniku arrin në përfundimin se është fat i keq të jesh i bukur. Figura e këtij ushtari mburravec hyri në letërsinë botërore dhe ka frymëzuar shpesh shkrimtarë të ndryshëm.

Subjekti i komedisë përmes intrigave dhe situatave komike plot të papritura vërtitet rreth çlirimit të Filokomasies, dashnores së djaloshit athinas Pleusiklit, nga thonjtë e Pirgopolinikut, tek i cili ajo kishte rënë si skllave:

Pjesa e parë e veprimit komik mbështetet në motivin e vrmës së fshehtë, që lidh shtëpinë e Pirgopolinikut me shtëpinë e fqinjit ku banon Pleusikli, që dashuron Filokomasien. Hyrja përmes një vrime të fshehtë është një motiv që e ndeshim shpesh në përralla. Ky motiv në komedi lidhet me një motiv tjetër, me atë të kipsit të imagjinuar, me trillimin se në shtëpinë fqinje gjoja banoka motra e heroinës, që i ngjet krejt kësaj. Kështu që Filokomasja kalon nga shtëpia e padronit të saj, Pirgopolinikut, përmes vrimës së fshehtë në shtëpinë fqinje ku banon i dashuri i saj. Trillimi gënjen edhe skllavin e Pirgopolinikut që është vënë ta ruajë Filokomasjen, të cilën kur e sheh në oborrin e fqinjit e kujton se është motra e saj.

Pjesa e dytë e komedisë tregon se si me ndihmën e heterave dinake e bindin Pirgopolinikun të besojë se gjoja atë e dashuronte marrëzisht gruaja e bukur e fqinjit të tij, e cila ishte gati të ndahej prej "burrit" të saj. Pirgopoliniku për të mos e pasur pengesë në shtëpinë e tij e le të lirë Filokomasien, duke luajtur në çastin e ndarjes prej saj rolin e dashnorit të pikëlluar. Pastaj ushtari mburravec, Pirgopoliniku, nisat për në shtëpinë e fqinjit të takohet me dashnoren e imagjinuar, por kthehet që andej i dërmuar nga të rrahurit. Sipas zakoneve



te vjetra burri i fyer, në këtë rast Pleusikli, kishte të drejtë të ndëshkonte edhe më rreptë atë që e fyente, por Pirgopoliniku, ky kapiten "trim" shpëtoi me aq në sajë të përlules së tij prej servili e frikacaku.

Me një stil më serioz madje herë-herë edhe me frymë moralizuese është shtjelluar motivi i çlirimit të vajzës dhe i turpërimit të kodoshit në komedinë "Ballamari" (li-tar i trashë).

Veprumi i komedisë është vendosur në një koloni greke në Afrikën e Veriut. Këtu rron një plak aristokrat i mërguar nga Athina. Një ditë stuhia nxjerr në breg të detit dy vajza, të cilat kërkojnë mbrojtje, sepse një matrapaz donte t'i shiste si skllave. Në mbrojtje të tyre ngrihet dhe një djalosh, i cili bie në dashuri me njerën prej vajzave. Në këto e sipër një skllav nxjerr nga deti një valixhe, ku gjendeshin shenja dalluese të kësaj vajze. Tani ndizet grindja rreth se drejtës kujt i takon valixhja, gjë që na kujton një skenë analoge me komedinë "Arbitrazhi" të Meneandrit. Plaku emigrant i thirrur si gjyqtar njeh sendet që përmbante valixhja dhe nga ato zbulon se vajza, se cilës i përkitnin ato ishte bija e tij e grabitur dikur. Nga fundi ajo martohet me djaloshin që dashuronte.

Një komedi e bukur, me interes të veçantë sidomos për vendin tonë, sepse veprimi i saj zhvillohet në qytetin e lashtë Dyrrakium (Durrës), është "Menehmet". Edhe në këtë komedi, ashtu si në "Ushtarin mburracak" është shfrytëzuar me mjeshtëri motivi i kipsit, i ngjashmërisë së plotë midis dy personazheve. Dy vëllezër binjakë jo vetëm që ngjajnë si dy pika uji me njeri-tjetrin, por te dy quhen me të njëjtin emër, Menehm.

Veprimi i komedisë "Menehmët" zhvillohet atë ditë kur pas shumë aventurash Menehmi i dytë arrin në qytetin Dyrrakium ku kërkon vëllanë e tij të humbur, Menehmin e parë. Me motivin e ngjashmërisë së çuditshme midis dy Menehmeve që krijon situata të papritura e tërë ngatërresa, ndërthuhet dhe tipat e zakonshëm të komedisë buffe, si : hetera, paraziti, skllavi, kuzhinieri etj. Pas shumë ndodhjeve të ndërlikuara Menehmët takojnë njeri-tjetrin dhe kështu bëhet njohja.

Subjektin e komedisë "Menehmët" e përpunoi dhe Shekspiri në "Komedinë e gabimeve".

Komedia "Amfitron" me subjekt mitologjik përmes situata-ve komike trajton një dramë familjare që ka më në fund një mbarim të bukur. Që në prologun e saj kjo pjesë karakterizohet si tragjedi - komedi. Në fakt skenat komike pasurohen nga skena serioze, patetike. Në këtë komedi njerëzit gënjejnë nga perënditë. Viktimë e tyre është Alkmena, grua shumë e mirë dhe e dashur. Sipas mitit, Zeusi iu paraqit Alkmenes duke marrë krejt fytyrën e burrit të saj, Amfitrionit. Nga ky bashkim lindi Herakli. E fyer dhe e ndjekur nga dyshimet e të shoqit Alkmena duron me qetësi, duke shprehur se e drejta për pafajësinë e saj do të dalë në shesh.

Drama familjare zgjidhet atëherë kur Jupiteri (Zeusi) që është kyçi i krejt intrigës shfaqet, ashtu si në një tragjedi, në madhësinë e tij hyjnore dhe shpjegon gjendjen e vërtetë të gjërave. Pas kësaj vendoset përsëri harmonia midis Amfitrionit dhe Alkmenes.

Në komedinë "Kutia" trajtohet tema e fëmijës së braktisur dhe të gjetur.

Në komedinë "Robërit", ku mungon elementi i dashurisë, forca levizëse është ndjenja atërore, shoqëria, vetë-mohimi. Plaku i pasur Hegion, i cili dikur kishte humbur djalin e vogël, është tepër i shqetësuar për fatin e djalit të madh, që kishte rënë rob në duart e armikut. Ai blen vazhdimisht robër armiq, duke shpresuar të gjente një rob të tillë që ta bënte bir në shpirt. Më në fund i qëllon të blejë një djalosh aristokrat, me emrin Filokrat, së bashku me skllavin e tij Tindar. Spektatorët ndërkaq që në prologun e komedisë e kanë marrë vesh se Tindari është djali i humbur i Hegionit Hegioni sillet mirë me këta robër, duke menduar të dërgonte ndonjë në atdheun e tij që të bënte marrëveshje me njerëzit e atjeshëm për t'i liruar djalin. Por dy të rinjtë mundën të ndërrojnë rolet dhe nuk leshohet Tindari, por Filokrati. Për shkak të ngathtësisë së njerit prej skllavërve zbulohet gënjeshtria. Plaku Hegion, duke menduar për fatin e keq të bijve të tij të humbur, e shpie Tindarin, që e kishte djalë dhe nuk e dinte, në punë të rënda në gurorë. Filokrati nuk e harroi skllavin e tij Tindarin, i cili bëri kaq sakrificë për të. Ai u kthye duke sjellë me vete jo vetëm djalin e Hegionit, që kishte rënë rob, por edhe njeriun,

i cili i kishte shitur babait të tij Tindarin e rrëmbyer. Hegioni fatkeq dhe i lumtur me ne fund i gjeti fëmijët e tij.

Komedia "Qypi", ka problematikë me të mprehtë shoqërore. Ideja folkloristike mbi dëmin që mund t'i shkaktojë njeriut pasuria që i vjen papritur është në themel të figurës kryesore të personazhit. Plaku i varfër dhe i ndershëm, Euklioni gjen në një qoshe të shtëpisë së tij një qyp me flori, që e kishte fshehur i gjyshi. Ky thesar ia prishi qetësinë shpirtërore plakut të gjorë. Tani atij i duket sikur çdo njeri që i del përpara do t'i rrëmbejë qypin dhe nga frika nuk fle tërë natën, ditën nuk largohet nga shtëpia. Nuk guxon të bëjë as shpenzimin më të vogël që të tjerët të mos kujtojnë se është bërë i pasur.

Vajzën e re të Euklionit do ta marrë për grua Megadori i pasur, meso burrë, që është fqinj me të. Ky i ka frikë kapriçiot dhe mashtimet e grave me prikë të madhe, dhe filozofon, në frymën e utopistëve të vjetër, se martesat midis të pasurve dhe vajzave të varfëra janë të dobishme, mbasi forcojnë familjen dhe zbutin kontradiktat shoqërore.

Në përgatitjen e dasmës do të marrin pjesë njerëz të huaj dhe Euklioni shpejton ta fshehtë qypin me flori në oborrin e shtëpisë. Por, rastërisht, atë e shikon skllavi i Likonidit, që është nip i Megadorit, dhe ia vjedh qypin. Plaku Euklioni nuk e di se e bija është shtatzënë. Gjatë festave që organizoheshin natën në natyrë atë e kishte dhunuar një i ri i panjohur. Dhe ky ishte pikërisht Likonidi. Ai e njeht viktimën e tij dhe është i shqetësuar që po bëhet kjo dasmë. Që nga ky çast në komedi krijohet një situatë e ndërlikuar dhe plot komicitet në kohën kur Euklioni si i çmendur endet nëpër skenë duke kërkuar qypin, e tij, vjen tek ai Likonidi, i cili e njeht veten fajtor. Fillon midis tyre një dialog komik, që shkakton të qeshur për përkimin që ndodh nga ana e formës në këtë bisedim : shqetësimet e Euklionit Likonidi i interpreton si pasojë e krimit të tij (sepse i pati dhunuar vajzën), ndërsa Euklioni sqarimet e Likonidit i merr si praninë të vjedhjes së qypit me flori :

Euklini : Ti veç e dije se ajo nuk ishte jotja, prandaj dhe nuk duhej ta prekje...

Likonidi: Pasi e kam prekur njëherë është më mirë të më libet mua...

Fundi i komedisë nuk është ruajtur në dorëshkrim. Kjo pritet në skenën ku Likonidi shikon skllavin me qypin e tij. Ajo që mungon në tekst plotësohet nga një ritregim i autorëve antikë: Likonidi martohet me vajzën e Euklionit dhe plaku ia fal qypin se bijës si peshqesh. "Unë nuk kam gjetur qetësi as ditë, as natë, - thuhet në një fragment, - tani do të fle rehat". Ky i fundit i përgjigjet plotësisht frymës së veprës : duke u çliruar nga pesha e arit njeriu gjen qetësinë e tij të mëparshme.

Kështu, në këtë komedi kopracia nuk është paraqitur si veti e pandryshueshme e karakterit të personazhit, por si diçka kalimtare.

Komedia "Qypi" ka frymëzuar shumë autorë, midis tyre edhe Molierin për komedinë e njohur "Kopraci".

Plauti, përpunoi subjekte të komedisë së re atike duke u kufizuar kryesisht në ato tema që e mënjanonin problematikën sociale-politike. Po për të mos rënë në kundërshtim me idetë morale dhe sidomos me idetë fetare të spektatorëve romakë ai u është shmangur problemeve të mprehta.

Komeditë e Plautit në përgjithësi priren nga komiciteti, nga karikaturizmi, nga bufonada dhe farsa. Qëllimi i tij ishte të shkaktonte me çdo skenë, fraze ose gjest të qeshurën, ilaritetin. Duke lënë mënjanë anën prekëse, patetike, dhe tendencat humaniste të komedisë së re atike, maskat tipike të heterave dhe skllavëve Plauti i trajtoi në mënyrë të tillë që me ndihmën e tyre të krijonte një intrigë tërheqëse dhe situata të këndshme për shijet e publikut romak. Skllavi nuk ishte vetëm faktor intrige, por edhe epiqendër e elementit të bufonadës. Ai i bënte të qeshnin spektatorët me shaka dhe me parodi të stilit "të lartë", duke filozofuar" dhe duke bërë be e rrufe, duke vrapuar nëpër skenë e duke bërë lëvizje të papritura. Duke u nisur nga kërkesa më rigorozë estetike, kritika e mëvonshme romake e veçanërisht Horaci e kanë kritikuar Plautin për anën karikatureske dhe të papërmbajtur të figurave.

Komedia e Plautit ndryshon mjaft nga mënyra neoatike e përdorimit të dialogut. Dialogu i Plautit ka karakter

bufonade; ky është i mbushur me sarkazëm me hiperbola dhe shpesh me shprehje trashanike. Një veçori tjetër e stilit të Plautit është aftësia të krijonte lodra fjalësh, me të cilat arrinte të ndërthurte situata të ndërlikuara dhe t'i vinte personazhet në pozita komike.

Gjuha e Plautit është e pasur në shprehje dhe fjalë. Në të gjejmë një pasuri të madhe leksikore, duke filluar nga formulat solemne arkaike të riteve e duke mbaruar në shprehjet dhe fjalët e profesioneve të ndryshme e në zhangonet. Një dijetar romak ka thënë : "Po të dëshironin muzat të flisnin latinisht, ato do të flisnin në gjuhën e Plautit".

Gjuha e Plautit i përshtatej karakterit të komedive të tij, duke përfshirë në të elementë popullorë: proverba, fjalë të urta, aliteracione, asonanca, ndonjëherë lodra fjalësh, të vëna këto në gojën e sklevërve dhe të personazheve të tjerë demokratikë.

Me gjallërinë dhe virtuoizizmin e gjuhës harmonizohet dhe metrika e komedive, e cila dallohet për një larmi më të madhe, në krahasim me komedinë e re greke, të masave të vargjeve, sidomos në "kantikat" (në pjesët vokale të komedive).

Komedia e Plautit nuk ka karakter politik, Aluzionet politike në to janë shumë të rralla. Kjo ka ndodhur për arsye se kushtet politike dhe shoqërore në Romë nuk e lejonin një gjë të tillë. Kur Plauti paraqiste diçka që ishte e guximshme për realitetin romak, ai nxitonte të justifikohet duke thënë se gjëra të tilla ndodhnin, në vende të tjera e jo në Romë. Por nën pamjen e jetesës së vendeve të huaja, ai trajtoi tema me karakter aktual, që kishin nisur të lindnin nga ndryshimet sociale të bëra në Romë. Çështje, si luks i tepruar, prika që marrin gratë me vete, etja për grumbullim etj., të gjitha këto ishin shumë aktuale për Romën. Dhe Plauti i trajtoi këto probleme në komedinë e tij. Këtu qëndron dhe rëndësia e Plautit si iluminist. Komedia e tij u shfrytëzua në mënyrë krijuese nga dramaturgjia evropiane, veçanërisht nga Moliëri dhe Shekspiri.

## TERENCI

(190-159 para erës së re)

Komediografi i dytë  
i shquar i Romës, Publ  
Terenci, e zhvilloi kriji-  
mtarinë e tij letrare në  
kushte të reja po-

litike dhe sociale. Me mbarimin e luftës së dytë punike  
Roma u rrit si fuqi e madhe në pellgun e Mesdheut, Shti-  
mi i shpejtë i pronësisë së madhe e ndërroi në mënyrë të  
theksuar tablonë e raporteve ekonomike dhe shoqërore në  
Itali. Kultura greke nisi në këtë kohë të përhapet shu-  
më në Romë. Kjo nderi një luftë të ashpër në mes të heleno-  
fileve dhe partizanëve të lashtësisë romake, që donin të  
ruanin të paprekura nga ndikimi i huaj traditat kulturore.  
Në këto kushte të koklavitura letërsia filloi të luajë  
rol të ri.

Deri atëherë letërsia romake ishte zhvilluar në mënyrë  
të vetvetishme. Tani kjo filloi të çmohej si mjet i fuqi-  
shëm që ndikonte në ideologji dhe në propagandë.

Kjo etapë e re në letërsinë romake nisi me veprimtari-  
në e shumanshme të poetit Kuint Enni.

Enni krijoi shkollë poetike dhe një nga ndjekësit e  
tij ishte dhe Terenci.

Publius Terenci kishte ardhur në Romë si rob karta-  
gjenas dhe për një kohë shërbeu pranë senatorit Terenc  
Lukani. Padroni u interesua për këtë skllav me talent, i  
dha shkollë dhe e la të lirë. Terenci morri pjesë në rre-  
thin e aristokracisë romake dhe ishte mik i Scipionit të  
ri, pushtuesit të ardhshëm të Kartagjenës.

Veprimtaria letrare e Terencit ishte e shkurtër. Nga  
viti 166 deri në 160 para erës së re ai shkroi gjashtë ko-  
medi. Këto janë të gjitha të plota. Në vitin 159 u nis  
për një udhëtim në Greqi gjatë të cilit vdiq.

Ashtu si Kuint Enni, edhe Terenci bënte pjesë në gru-  
pëzimin politik të Scipioneve. Në vitet 60 të shekullit  
të dytë ky grupëzim kishte influencë të madhe. Ky lufton-  
te kundër tendencave agresive të kapitalit tregtaro-uzu-  
rar në politikën e jashtme, ngulte këmbë për ndihmat e  
vogla që duhej t'u jepeshin fshatarëve romakë, mundahej  
të menjanonte ashpërsimin e kontradiktave shoqërore bre-  
nda Italisë. Në fushën ideologjike ky grupëzim përkrahte  
ato doktrina greke që predikonin paqen shoqërore, harmoni-  
në e ndërsjellë, mbështetur në një sjellje njerëzore kun-

drejt njeri-tjetrit, në heqjen dorë nga mendimet egoiste etj. Kjo prirje përparimtare ngrihej mbi një platformë të një humanizmi të përgjithshëm mbiklasor dhe synonte nga ana tjetër të ruante bazat e shoqërisë romake. Në këtë kohë tendenca humane e komedisë së re antike u bë shumë aktuale dhe Terenci u bë flamurtari i saj në Romë.

Komedia e Terencit i përket gjinisë së paliatës romake, siç janë edhe veprat e Plautit, domethënë ishte një përpunim romak i komedive greke. Vlera letrare e Terencit ndryshon shumë nga ajo e Plautit në pikëpamje ideologjike dhe stilistike. Terenci zgjodhi ato komedi që i jepnin dorë për të shprehur mendimet e tij shoqërore dhe morale me një stil që ishte karakteristik për të.

Duke përpunuar pjesët greke, Terenci u përpoq të ruante ndërtimin arkitektonik dhe tonin serioz të origjinalit.

Komedia "Vjehrra" është një pjesë që ilustron më mirë se të tjerat veçoritë stilistike të komedisë së Terencit. Kjo i përket tipit të komedisë prekse. Veprimi, si zakonisht, zhvillohet në Athinë, midis dy shtëpive, asaj të Lahetit dhe asaj të Fidipit. Pranë tyre jeton hetera Bakide.

Djali i Lahetit, Pamfili, dashuron me zjarr heteran Bakide, se cilës i betohet për besnikëri. Me këmbënguljen e të atit ai martohet me Filumenen, vajzën e fqinjit Fidip. Por kjo martesë në fillim bëhet sa për sy e faqe, sepse Pamfili vazhdon ta vizitojë mikën e mëparshme duke shprehura se Filumena do të mërzhitet dhe do të iki vetë nga shtëpia. Por, ndërsa Filumena e duron në heshtje sjelljen e Pamfilit, Bakida fillon e sillet keq me të. Tani ndjenjat e këtij ndryshojnë : ky ftohet nga hetera dhe fillon të dashurojë gruan e tij. Pamfili largohet për disa ditë nga Athina; në mungesën e tij, Filumena, nuk dihet sepse fillon ta urrejë vjehrrën, Sostraten, të mos i dalë në sy, gjersa më në fund kthehet në shtëpinë e saj.

Spektatori, ndofta, mund ta interpretojë largimin e Filumenes si pasojë e karakterit të vështirë të vjehrrës, po skenat që vijnë menjëherë e bindin atë se Sostrata është një grua e mirë, e detyruar të durojë pa pushim sharjet e pamerituara të burrit të saj. Ajo përpiqet ta bindë të shoqin se nuk i ka ndonjë faj nuses, por më kot :

u është mbushur mendja top  
se të gjitha fajet i kanë vjehrrat...

Ë fshehta merret vesh nga monologu i Pamfilit, që është kthyer në shtëpi. I shqetësuar nga grindja në mes të gruas dhe nënës së tij, ai shkon me të shpejtë në shtëpinë e Fidipit dhe aty gjen Filumenen duke lindur. Ç'kishte ndodhur? Gruan e Pamfilit, Filumenen, e kishte përdhunuar dikush para se të martohesh. Nëna e saj Mirrina i lutet Pamfilit të mos e burgëzojë Filumenen fatkeqe edhe në qoftë se nuk do ta marrë përsëri. Që nga dita e martesës kanë kaluar shtatë muaj, dhe ata që nuk e dinë historinë e kësaj martese nuk parashohin asgjë të keqe. Pëmija sigurisht do të braktiset, ne se do i ati. Pamfili e sheh të domosdoshme ta prishë martesën dhe ta mbyjë ndjenjën e dashurisë Për Filumenen.

Vjehrra e Filumenes, Sostrata e mirë, duke kujtuar se grindja filloi për shkak të saj, është gati të largohet me të shoqin në fshat, që të mos i rëndohet nuses. Mbasi nuk e dinë si qëndron puna në të vërtetë, pleqtë Laheti dhe Fidipi kujtojnë se sjellja e Pamfilit përcaktohet nga dashuria që ai ka për heteren Bakide, kështu që dërgojnë njerëz për të biseduar me të. Kjo heterë në komediparaqitet si mishërim i altruizmit dhe i fisnikërisë. Ajo është gati të ndihmojë me kënaqësi për lumturinë familjare të mikut të saj të dikurshëm dhe niset që të lajmërojë gruan e Pamfilit dhe vjehrrën e tij se ajo i ka prerë marrëdhëniet e saj me kohë me Pamfilin.

Për zgjidhjen e tërë këtij lëmshi shërben një send i vogël. Përdhunuesi i panjohuri i kishte hequr nga gishti Filumenes unazën që ia kishte falur e ëma. Në aktin e fundit të komedisë paraqitet Bakida, në gishtin e së cilës duket po kjo unazë. Këtë unazë posa e pa e njohu Mirrina, nëna e Filumenes. Kështu që vizita e heteres Bakide, që kishte për qëllim të sqaronte çështjen e marrëdhënieve të saj me Pamfilin, shpuri pa dashur në zgjidhjen e vërtetë të lëmshit.

Pasi largohet nga shtëpia e Fidipit, Bakida dërgon menjëherë një skllav me emrin Parmenon që të lajmërojë Pamfilin se unazën që ia kishte dhënë ai asaj ia kishte njohur Mirrina, nëna e Filumenes. Kjo ishte unaza që kishte pasur dhe Filumena. Ç'kishte ndodhur? Një mbrëmje Pamfili i dehur



kishte shkuar te Bakida me unazën që ia kishte marrë vajzës që kishte përdhunuar. Kështu u bë e qartë se ai ishte babai i fëmijës që i kishte lindur Filumenes.

Kjo komedi është përpunuar sipas një pjese të komedio-grafit grek Apolodorit i cili nga ana e tij pati si model komedinë "Arbitrazhi" të Menandrit.

Në skenën e fundit Pamfili, i dehur nga lumturia, bisedon me përzëmërsi dhe me fjalë të zgjedhura me shpetimtarin e tij Bakiden. Por e fshehta e përdhunimit të Filumenes nga Pamfili, të cilët u bënë më vonë burrë e grua nuk merret vesh nga të gjithë. Pleqtë pandehnin se tërë këto ngatërresa u fashitën atëherë kur Bakida u përemtoi se nuk do të shkonte më me Pamfilin. Vetëm skllavi Parmenon, i përvëlur nga kureshtja vazhdon gjithnjë të çuditet përse e kishte gëzuar kaq shumë Pamfilin lajmi i tij.

Nga prologu i komedisë "Vjehrra" ne marrim vesh se kjo pjesë kishte dështuar dy herë. Në shaqjen e parë dhe të dytë spektatorët ishin larguar për të parë lojën e cirkut dhe mundjet e gladiatorëve. Vetëm në përpunimin e tretë pjesa mori rrugë dhe u pëlqye. Sigurisht spektatorët kërkonin nga komeditë përshtypje të forta komike ose figura të zakonshme qesharake. Ndërsa të Plauti skenat janë të mbushura plot efekte komike : skenat e pakta, ku marrin pjesë skllëverit, janë momente humori të lehtë, pa kaluar kurrë në bufonade. Një pjesë si "Vjehrra" ka përqëllim të zgjojë keqardhjen e spektatorëve ndaj njerëzve të zakonshëm që ndodhen në situata të vështira. "Vjehrra" qëndron më afër dramës se sa komedisë.

Komedia "Adriana" (Vajza nga Androsi) është ndërtuar mbi një dyluftim veprimesh që zhvillohet midis dy personazheve: nga njera anë vepron një baba plak, që kërkon ta martojë djalin e tij me vajzën e fqinjit të pasur, nga ana tjetër vepron skllavi i djalit, i cili ndihmon zotin e tij të martohet me një vajzë të varfër që dashuron. Konflikti midis të dy palëve zgjidhet me momentin e "njohjes": del më në fund se vajza, me të cilën djaloshi kish rënë në dashuri ishte bija e humbur e po atij fqinji të pasur. Edhe vajza tjetër e fqinjit, me të cilën kërkonte ta martonte i ati, nuk mbetet pa burrë. Një djalë i ri që e dashuronte gjith kohën kishte ndjekur me interesim si do të zhvillohej intriga, dhe gjithë kohën kishte ëndërruar të martohej me atë

që dashuronte.

Një nga temat më të përhapura të komedisë së re është konflikti midis baballarëve dhe fëmijëve. Këtë temë ka trajtuar dhe Terenci në komedinë e tij "Ndëshkuesi i vetvetes", ku tregohet një baba, i cili e mundon veten rëndë, sepse me sjelljen e tij të ashpër e bëri të birin të largohet nga shtëpia.

Problemin e edukimit të fëmijëve Terenci e ka trajtuar gjerësisht në komedinë e tij "Vëllezërit".

Demej, athinas i rreptë dhe kursimtar i madh, që e kalon jetën duke punuar pa pushim në pronën e tij në fshat, ka dy djem, Eskinin dhe Ktesifonin. Djaline madh Eskinin e merr si bir në shpirt vëllai i Demejit, Mikioni, që është beqar, admirues i jetës së qytetit dhe i komoditeteve të saj. Si pasojë e shijeve dhe e karaktereve të ndryshme të Demejit dhe të Mikionit, të rinjtë marrin edukatë të ndryshme. Demej ndjek parimet e vjetra të edukimit me frikë, ndërsa Mikioni, partizan i edukimit humanist, përpigjet të zhvillojë tek djali që e ka bërë bir në shpirt ndjenjën e dinjitetit të brendshëm. Midis tij dhe Eskinit krijohet një atmosferë sinqeriteti dhe besimi të ndërsjellë Mikioni i kupton dëshirat dhe hovet e rinisë. Djali i adoptuar i tij Eskini ka rënë në dashuri me një vajzë, me të cilën kërkon të martohet. Edhe vëllai i tij Ktesifoni ka rënë në dashuri me një kitariste, e cila ndodhet në duart e një kodoshi, që kërkon të nxjerrë përfitime prej saj. Ktesifoni, duke e pasur frikë të jatin, nuk i thotë asgjë për hallin e tij. Ai i kërkon ndihmë të vëllait, Eskinit, i cili e ndihmon duke rrëmbyer nga duart e kodoshit kitaristen. Skandali publik që u bë me këtë rast tronditi gjithë të afërmit. U trondit dhe familja e nuses së Eskinit, por ai që u tërbua më shumë është Demej, i cili sheh në këtë skandal pasojat e edukatës së butë me të cilën Mikioni ka rritur Eskinin. Por Demej pikëllohet edhe më shumë kur merr vesh se kitaristja ishte grabitur për djalin e vogël, të cilin ai e kishte edukuar vetë në bazë të parimeve rigorozë. Me parimet e edukatës së tij Mikioni ndihmon që i biri i adoptuar të martohet me atë që dashuron, edhe pse është e varfër e nuk ka prikë. Në këtë mënyrë sistemi i Mikionit, që udhëhiqet nga parimet e filozodisë helenike, shpie në lumturinë e përgjithshme, kurse sistemi edukativ i Demejit falimenton.

Komedi të tjera të Terencit janë "Eunuku" dhe "Formioni".

Terenci përdori një metodë të veten për të përpunuar origjinalitetet greke, ndryshe nga ajo e Plautit, madje në kohën e tij atë e kritikuan për shmangie nga origjinalet dhe për përdorimin e lirë të tyre. Rëndësi të veçantë në komeditë e Terencit kanë prologët, me të cilat ai polemizonte me kundërshtarët e tij mbi probleme të ndryshme letrare. Ato përbëjnë një nga dokumentet më të lashta të kritikës letrare romake.

Ana muzikore e komedive të Terencit është thjeshtësuar mjaft në krahasim me pararendësit e tij. Tek Terenci nuk i vërejmë më ato pjesë të koklavitura lirike që i pëlqenin Plautit. Në këtë anë ai iu afrua më shumë Menandrit. Sipas shembullit të tij ai përdori stilin e bisedës së zakonshme. Gjuha e Terencit ishte gjuha e qarqeve të kulturuara të shoqërisë romake, që u bë normë e të "folurit të kulluar latin".

Nga ana e ndërtimit të komedisë vlen të shënohet një veçori e dramaturgjisë së Terencit. Siç dihet, komedia antike nuk përbante ndonjë të fshehtë për spektatorin. Ajo që personazhet e merrnin vesh vetëm pas "njohjes" së fundit, publikut i komunikoheshin që më parë, që në prolog, dhe komedia hartoheshin në mënyrë të tillë që spektatorin ta dëfrenin rrugët e gabuara që ndiqnin personazhet. Largimin nga kjo traditë dramaturgjike ne e shohim për herë të parë te Terenci. Të gjitha pjesët e tija, me përjashtim të komedisë "Vëllezërit", përbajnë momentin e "njohjes", por kjo nuk jepet në prolog. Ai e le spektatorin në heshtje dhe në pritje të asaj ç'do të ngjase, duke mbajtur kështu gjallë interesin e tij deri në fund. Gjendja e vërtetë sqarohet vetëm gradualisht. Në pjesë të tilla, siç është "Vjehrra" spektatori deri në çastin e fundit nuk ka asnjë të dhënë që të mund të marrë me mend si do të përfundojë pjesa. Nga kjo anë Terenci i afrohet teknikës së dramës së re evropiane.

Komeditë e qeta dhe serioze të Terencit nuk patën sukses të madh në skenën romake. Atë e quanin si paralele romake të Menandrit. Çezari, për shembull, thoshte se Terenci i mungon fuqia e duhur dhe e quante atë "gjysmë Menander".

Terencin e çmuan kryesisht si stilist, për finesën dhe pastërtinë e gjuhës. Interesi që tregoi shkolla romake për

veçoritë stilistike të Terencit bëri të ruhen jo vetëm veprat e tij, por dhe komentaret e shënimet kritike lidhur me to.

Terenci, ashtu si Kuint Enni, shkroi në formën e shijeve të rrethit të Scipionëve, ku ai bënte pjesë. Komeditë e tij nuk kishin atë gjallëri veprimi që karakterizonte komeditë e Plautit, dhe qëndronin më pranë modeleve greke. Shumica e komedive të Terencit janë të tipit të përzier, gjysmë dinamike e gjysmë statike.

Komeditë e Terencit u bënë shumë të njohura në Evropë, madje dhe në kohën e mesme. Në epokën e Rilindjes humanistët i tërhoqi shumë latinishtja e tij elegante. Vepra e tij ndikoi mjaft në zhvillimin e dramaturgjisë evropiane.

Për të shkruar "Dredhitë e Skapenit" Moliერი u ndikua nga "Formioni", ndërsa për komedinë "Shkolla e burrave" nga "Vëllezërit". Rol të veçantë Terenci luajti në shekullin XVIII, në periudhën e formimit të dramës borgjeze.

Shekullit II para erës së re i takon dhe vepra letrare e Pakuvit që përpunoi kryesisht tragjeditë e Euripidit. Nga 12 tragjeditë e tij janë ruajtur vetëm fragmente. Në tragjeditë e tij Pakuvi, anëtar i rrethit të Scipionit dhe nxënës i Kuint Ennit, solli ide liberale, iluministe. Në një nga fragmentet e tragjedive të tij të përpunuara autori nuk e pranonte idenë e fatit dhe e zëvendësonte atë me rastin; në një fragment tjetër, hyjni ai quan eterin e shpërndarë në natyrë, ndërsa në një fragment të tretë ai vë në lojë auguret, që luanin rol shumë të madh në shtetin romak.

## 5. ZHVILLIMI I PROZËS

### KATONI

Një nga prozatorët e parë romakë ka qenë Katoni, udhëheqës i grupit të konservatorëve. Mark Katoni ka jetuar midis viteve 234 deri më 149 para erës së re. Rridhte nga një familje joaristokrate, por hyri në radhët e aristokracisë romake në sajë të pasurive të tij. Katoni ka qenë personalitet kontradiktor: nga njera anë mbronte rregullin e lashtë romak të jetës, mbështetej sociale e të cilit ishin pronarët e vegjël të lirë, nga ana tjetër vetë ishte skllavo-

pronar i madh. Ai luftoi kundër luksit, kundër helenizimit të kulturës dhe të mënyrës së jetesës. Në vitin 184, kur ishte censor nxori shumë persona nga kasta e senatorëve për mënyrën e jetesës joromake.

Megjithëse luftoi kundër përhapjes së kulturës greke në Romë, Katoni në pleqëri pranoi se njohja e kulturës greke, "jo shumë e thellë", është e dobishme. Si njeri me përvojë të gjatë dhe praktik Katoni e kuptonte se sistemi i lashtë arsimor romak, që kufizohej në të mësuarit e këndimit dhe të shkrimit dhe në njohjen e formulave sakrale dhe juridike, nuk u përgjigjej me nevojave ekonomike dhe politike. Por në vend që t'i drejtohej shkencës greke, ai rekomandon sistemin e tij të diturisë. Duke u nisur nga këto ai përpiloi një sërë udhëzimesh për degët e ndryshme të veprimtarisë praktike. Ekonomia fshatare, mjekësia, oratoria, strategjia, jurisprudenca, të gjitha këto janë përfshirë në veprat e Katonit. Ai shkroi traktatin "Birit tim Markut", që ishte një lloj enciklopedie me këshilla e njohuri të ndryshme nga jeta, të paracaktuara për të birin. Janë ruajtur një sërë aforizmash nga ky traktat, shumë prej të cilave hynë si krijime anonime në thesarin e urtësisë njerëzore: Pertacia është nëna e të gjitha veseve, Mos ble atë që është e nevojshme, por atë pa të cilën nuk mund të rrosh, sepse ajo është gjithnjë një santim më e shtrenjtë, - Zotëroje lëndën se fjalët vinë vetë etj.

Sipas thënieve të Katonit të grekët fjalët dalin nga goja, kurse të romakët nga zemra.

Katoni shkroi dhe një traktat " Mbi bujqësinë ", e vetmja vepër e plotë e tij që na ka arritur. Ky është një dokument klasik i ekonomisë fshatare në shoqërinë skllavopronare.

Veçoritë stilistike të Katonit shihen më mirë në fjalimet e tij, që ai ruajti dhe i përpunoi në pleqëri. Ato pak fragmente që kanë mbetur dëshmojnë për një gjuhë të fuqishme, të rrjedhshme dhe të pasur. Vepra historike e Katonit është " Fillimet " (Origines) që ka rëndësi të veçantë, sepse u shkrua në gjuhën latine, ndryshe nga veprat e historianëve të parë romakë, që u shkruan në gjuhën greke. Është e vërtetë se dhe Kuint Enni, para Katonit, veprën e tij poetike "Analet", ku parashtron në vargje historinë e Romës, e shkroi në gjuhën latine, por Katoni prirjen e Ennit për të hymnizuar burrat e ndryshëm të shtetit romak e shikon me antipati. Në veprën e tij Katoni i vuri si detyrë vetes të përshkruajë dhe t'u thurë lavde zakoneve të lashta dhe mënyrës së jetesës së të parëve.

Vepra historike e Katonit karakterizohet nga dy momente kryesore. Së pari, autori nuk është kufizuar të tregojë vetëm historinë e Romës; ai ka përshkruar zanafillën e komuneve të ndryshme italike, prandaj edhe veprën e tij e quajti "Fillimet". Së dyti, ai u përpoq të mos i përmendë emrat e burrave të ndryshëm të shtetit, por t'i zëvendësonte ato me titujt "konsull", "tribun" etj. Parashtrimi i historisë së komuneve italike vjen deri në ditët kur jeton autori. Për veprën e tij historike Ka-

toni ka qenë i detyruar të përdorte burimet greke, për  
saktësinë e të cilave kishte besim të madh.

## Kreu II

### LETËRSIA E SHEKULLIT TË FUNDIT TË REPUBLIKËS.

Letërsia romake gjatë periudhës së republikës dhe më vonë mori zhvillim të madh. Ajo nisi të marrë tipare të forta politike dhe shoqërore në përputhje me kushtet e reja historike, që u krijuan në Romë gjatë kësaj kohe. Në gjysmën e dytë të shekullit II para erës së re Roma hyri në rrugën e një lufte të ashpër shoqërore. Në tridhjetë vjetet e fundit të shekullit II nisi kryengritja e madhe e skllevërve; nga viti 133 më 121 shohim lëvizjen e udhëhequr nga vëllezërit Grake, që synonin të ndanin tokat e shtetit për të rimëkëmbur dhe forcuar pronën e vogël e cila sipas tyre konsolidonte themelet e shtetit Romak.

Nga fillimi i shekullit I gjer në vitet 40 para erës së re zhvillohet një luftë e ashpër civile, e cila shoqërohet shpesh me turbullira dhe kryengritje skllevërish, siç ishte ajo e udhëhequr nga Spartaku nga vitet 73 deri më 71. Lufta civile në Romë u karakterizua nga tendenca të hapura për t'i dhënë fund republikës dhe për të vendosur diktaturën, siç ishte ajo e Siles ( vitet 82-79). Për një gjë të tillë dëshmon dhe aleanca e tre burrave të shtetit ( triumvirati), që u vendos midis Pompeut, Cezarit dhe Krasit. Lufta civile për vendosjen e diktaturës reale vazhdoi dhe më vonë në mes të Cezarit dhe Pompeut, që u kurovëzua me vendosjen e diktaturës së Cezarit ( nga vitet 49 deri në 44). Pas vrasjes së Cezarit lufta civile vazhdoi në mes të pasardhësve të tij, Antonit dhe Oktavianit. Këto janë momentet me të rëndësishëm të luftës shoqërore që shpënë në shkatërrimin e sistemit republikan në Romë dhe në themelimin e Perandorisë Romake ( rreth vitit - 30 para erës së re).

Meritjen e fuqisë ekonomike dhe politike të Romës for-



ma e polisit nuk u përgjigjen me nevojave të një shteti të madh skllavopronar, siç ishte Roma. Në atë kohë filloi një diferencim i madh social brendapërbrenda radhëve të qytetarëve të lirë romakë, të cilët u ndanë nga një greminë e thellë klasore. Shtimi i ekonomisë së madhe private pati si pasojë pronësimin e fshatarësisë së vogël, që nuk mund t'i bënte dot ballë konkurrencës së latifondeve të skllavopronarëve të pasur. Deshtimi i projekteve për ndarjen e tokës shtetërore, propozuar nga vëllezërit Grake, me qëllim që të rimekembey pronësia e fshatarëve të vegjël, shënoi disfatën e koncepteve të vjetra mbi pronësinë e vogël si bazë e polisit. Këndeji mund të kuptohet lehtë sesa e ashpër ishte lufta klasore që u zhvillua midis latifondistëve të mëdhenj dhe pronarëve të vegjël të tokës. Kasta me e lartë e pronarëve të skllavëve, shtresa e senatorëve, ishte një oligarki tipike. Kjo kishte monopolizuar zyrat udhëheqëse politike, që jepnin mundësi të mëdha për përvetësimin e fitimeve të luftës dhe për grabitjen e provincave. Edhe vetë senatorët e pasur skllavopronarë e latifondistë kishin kontradiktat në mes të tyre. Kjo kaste e lartë shoqërore ishte e përçarë në një radhë klikash dhe grupesh kundërshtarë me njëra-tjetrën. Por të gjitha këto klika dhe grupe bashkoheshin kur interesat e tyre jetike kërcënoheshin. Ata gjithashtu solidarizoheshin kur ishte puna për t'u prerë rrugën "njerëzve të rinj", të pasuruar, por që nuk ishin aristokratë, e që synonin edhe ata të ngjiteshin në postet e senatorëve. Këta njerëz të rinj, që formonin cenzusin e dytë të "kalorësve" ishin në opozitë me aristokracinë e senatit. Detyra e opozitës kundër senatit ishte të dobësonte rendësinë e senatit dhe të zhvendoste qendrën e jetës politike në kuvendin popullor. Kështu u krijuan dy parti: partia e senatit (optimatet) dhe partia popullore (popullaret). Opozita që iu vu përballë senatit kishte pa dyshim karakter përparimtar, sepse synonte të tërhiqte në jetën politike të vendit shtresat e gjera të pronarëve të vegjël të lirë romakë.

Në polin tjetër të klasës skllavopronare gjendej i ashtuquajtur i "proletariat", domethënë shtresat e shpronësuar që nuk prodhonin, që rronin me kockat që u hidhnin aristokratët, të cilët ishin të interesuar t'i mbanin për të fituar vota kur bëheshin zgjedhjet dhe për t'i përdorur si ushtarë mercenarë për qëllimet e tyre grabitqare.

" Proletariatit " romak ishte një lumpenproletariat, ishte një masë e madhe njerëzish të deklasuar, që, siç thotë Marks, duke cituar fjalët e Sismondit " ... rronte në kurriz të shoqërisë, ndërsa shoqëria e sotme rron në kurriz të proletariatit ". Këto masa të deklasura kërkonin një pjesë qoftë dhe të vogël dhe të ardhurat që nxirreshin nga shfrytëzimi i skllëvërve dhe i popujve të provincave.

Sipas fjalëve të Marksit, "... në Romën e lashtë lufta e klasave është zhvilluar vetëm brenda një pakice të privilegjuar, në mes të të pasurve të lirë dhe të varfërve të lirë, ndërsa shumica dërmuese produktive e popullit skllëvërit, shërbente si pedestal pasiv i këtyre luftërave. Dhe pozita e shoqërisë romake ndërlikohej aq me shumë sa më shumë lëkundej ky " pedestal "... "

Për të pasuruar gjithnjë e më tepër klasat e larta dhe për të mbajtur me bukë popullsinë joproduktive nevojiteshin pushtime të reja. Dhe Roma në të vërtetë ishte luftërave për këto pushtime, kështu që dhe dekompozimi i republikës romake u bë në sfondin e ekspansionit dhe të pushtimeve. Ushtritë romake derdhen në shtetet helenistike të Azisë së afërme, pushtojnë Galinë, Gjermaninë etj. Me zgjerimin e ekspansionit, ushtria e vjetër e fshatarëve nuk mund t'u përgjigjej më si dikur nevojave të luftës, kështu që ajo u zëvendësua me një ushtri profesioniste. Këta ushtarë merce-narë mund të bëheshin lehtë vegla në duart e komandanteve të ndryshëm. Por edhe këta i shpërblenin ushtarët e tyre duke u dhënë një pjesë nga plaçka e luftës, para dhe tokë. Komandantët e ushtrive duke pasur si mbështetje këta ushtarë profesioniste sunduan si të plotfuqishëm dhe të pavarur nga qendra për një rradhë vitesh. Vetë sistemi republikan vazhdoi edhe për ca kohë në sajë të rivalitetit në mes të komandantëve, gjersa me në fund u detyrua t'ia lërë vendin diktaturës ushtarake.

Ndryshimet e thella social-ekonomike që pasuan shndërrimin e Romës në një fuqi të madhe mesdhetare, jo vetëm shkaktuan pakënaqësinë e sistemit të vjetër politik, por edhe ushtruan ndikim të madh mbi jetën ideologjike të shoqërisë romake. Në fund të shekullit III dhe në fillim të shekullit I para erës së re u duk qartë kriza e ideologjisë së vjetër romake. Kjo krizë, e cila që rezultoi para së gjithash i zhvillimit të brendshëm të Romës, ishte lidhur pa dyshim me daljen e Romës në arenën ndërkombëtare.

dhe me depërtimin gjithnjë më të fortë të ndikimeve helenistike në Romë ( sidomos që nga koha e luftërave në Gadishullin Ballkanik dhe në Azinë e Vogël).

Gjuha greke u përhap gjerësisht në rrethet e larta të shoqërisë romake. Bashkë me gjuhën, në Romë depërtoi arsimi grek; greku mësuës u bë diçka e domosdoshme në familjet pasanike romake, njohja e letërsisë greke u bë shenjë që tregonte erudicionin e njerëzve, dolën shkollat ku mësohej retorika, të organizuara nga retorët grekë. Ndikim gjithnjë e më të madh ushtruan zakonet helenistike mbi jetën në përgjithësi dhe në veçanti. Shumë personalitete politike të rëndësishëm të Romës filluan ta quajnë veten haptas filohele-në, si p.sh. Flaminini, Scipioni etj.

Zakonet greke u futën dhe në jetë. Këdhtu p.sh. , zakoni i hartimit të mbishkrimeve në vargje mbi gurët e varreve ishte zakoni i marrë nga Greqia. Të rruarit e mjekrës, zakoni për t'u ulur rreth sofrës gjatë ngrënies etj. qenë sjellë, gjithashtu, nga Greqia prej grekëve. Imitimi i qdo gjëje greke u bë modë që përhapej kryesisht në radhët e qarqeve aristokratike romake.

Por depërtimi i këtyre ndikimeve të huaja në Romë nuk u bë pa luftë dhe pa kundërshtime. Qarqet e gjera të shoqërisë romake i shikonin me një ndjenjë kundërshtimi këto zakone të huazuara tek të tjerët dhe u bënë qendresë të fortë. Nga kjo pikëpamje është karakteristike veprimtaria e censorit të përmendur romak Katon Plakut, i cili si pikë kryesore të programit të vet paraqiste parullën e luftës kundër " veseve të reja " dhe kërkonte rivendosjen e zakonave të lashta dhe të " dokeve të baballarëve".

Këto ndikime u dukën edhe në filozofi. Në shek. II-I para erës së re rrymat e ndryshme të filozofisë helenistike u bënë të njohura jo vetëm në rrethet e larta të shoqërisë romake, por edhe në rrethet më të gjera të saj. Një punë veçanërisht të madhe për popullarizimin e filozofisë bëri Ciceroni, i cili ia paraqitruar në një varg shkrimesh në mënyrë jo shumë të thellë e të saktë, por mjaft të kuptueshme, bazat e sistemeve filozofike të ndryshme dhe ka përpunuar terminologjinë filozofike latine. Shumë u përhap në Romë doktrina e stoikëve përmes historianit të njohur rrek Plibit dhe filozofit grek Panetit. Kjo filozofi ndihmonte interesat e klasave shtypëse e shfrytëzuese. Edhe nga filozofia materialiste e filozofit grek Epikurit, hym-

nizuar në vargje nga poeti i madh romak Lukreci, shoqëria romake nuk mori veg anën etike të saj, të cilën qarqet sunduese e përpunuan sipas interesave të tyre klasore.

Ashtu si në filozofi, ndikimi grek u ndie në një farë mase edhe në shkencën romake. Çelsi, në një vepër mjekësore përgjithësoi realizimet e mjekësisë helenistike; astronomi Sosigen nga Egjipti, bëri kalkulimet për reformën e kalendarit romak (i ashtuquajtura kalendarit Julian), reformë që u zbatua nga Cezari. Por në të njëjtën kohë u bënë përpjekje për të zhvilluar një shkencë thjesht romake, si domos në ato fusha ku ishte më lehtë t'u shpëtoje ndikimeve. Përfaqësuesi më i shquar i saj qe Marks Terenc Varroni (116-28 para erës së re), i cili hartoi një enciklopedi të shkencave dhe shkroi studime të gjera për zakonet antike dhe ritet e lashta të romakëve, për teatrin romak, për gjuhën latine, për astronominë dhe shumë fusha të tjera. Veg kësaj, Varroni u bë i njohur për satirat e veta, në të cilat ai tallte zakonet e kohës. Varroni e quajti triumviratit e parë "përbindësh me tri kokë", shprehje kjo që aso kohe u përhap shumë.

Si rrjedhim i luftës së ashpër politike, zhvillim të madh mori dhe arti oratorik retorika, e cila pati përfaqësues të shkëlqyer, midis të cilëve u shqua Ciceroni. Fjalimet e avokatëve të njohur shumëfishoheshin dhe lexoheshin nga publiku i gjerë. Meqenëse proceset civile, në të cilat ishin të implikuar personalitete të njohur, merrnin rëndësi politike, fjalipet e mbajtura në gjyq u bënë shkollë e një përvoje të pasur për oratorët, të cilët më vonë dilnin dhe mbanin fjalime në senat ose në kuvendin e popullit. Lufta që ziente aty u bë nxitje e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të gojëtarisë.

Jeta politike shoqërore e Romës gjeti pasqyrimin e saj edhe në disa forma të letërsisë popullore, shumë e përhapur dhe e dashur për publikun e gjerë romak. Këto ishin farsa dhe mime, që e kishin zanafillën në lodrat e lashta popullore. Në to merrnin pjesë personazhe zbavitës, grykës, batakçinj, sylleshë, harbutë, dhe personazhe të tjera, që e pësonin prej të parëve. Ary nga fundi i republikës një popullaritet të veçantë gëzonin mimet e Sirit, skllav i liruar, nga të cilët më vonë u nxorën dhe u mblodhën fjalët e urta dhe shakatë e holla e me kripë. Disa prej tyre pasqyronin qëndrimin e popullit ndaj ngjarjeve të përditshme. Tështa e rëndë e shtypjes dhe e shfrytëzimit u pasqy-

rua në maksimumin e përhapur shumë në atë kohë. " Është në mirë të vdesësh se sa të rrosh në një skllavëri të turpshme. Për urtësinë popullore me interes janë maksimumet " Borxhi është një skllavëri e rëndë", " Duke pranuar bamirësinë, shet lirinë", Nuk mund të nxjerrësh fitim, pa dëmtuar tjetrin", " Rehat rrojnë ata që zhdukin nocionin " imi", " yti", " Edhe nga një kasolle mund të dalë një njeri i madh " etj.

Në këto rrethane politike dhe shoqërore letërsia romake mori tipare thellësisht aktuale. Vetë burrat e shtetit jepën pas shkrimeve, duke parë se letërsia luan rol të madh propagandistik në shoqëri. Kështu lindi dhe u zhvillua mjaft publicistika dhe historiografia. Në dy shekujt e parë të republikës, nga të cilët janë ruajtur pak deshmi të sakta, merr një farë zhvillimi tregimi, i cili përveç trillimeve dhe zbukurimeve, paraqet dhe aspekte nga realiteti i gjallë. Aktualizimi, afrimi me jetën e Romës shihet edhe në lemin e poezisë.

Më pak nga të gjitha u prek nga këto ndryshime tragjedia, që ruajti tematikën e saj tradicionale. Klasiku i fundit i tragjedisë romake në këtë periudhë ishte AKCI (vitet 170-90). Dramat e tij shquhen për patetikën dhe begatinë stilistike. Ai merr si bazë subjektet e tragjedisë greke dhe i përpunon në mënyrë të pavarur. Edhe te Akci degjohet pulsi i fortë i jetër politike romake. Shpesh në tragjeditë e tij paraqiten tiranë, që ndëshkohen për veprimet e tyre. Shumë e njohur ka qenë thënia në një nga tragjeditë e tij, për tiranët " Le të urrejnë, mjafton që të kenë frikë". Në këtë frymë shkroi ai tragjedinë " Brutii", ku ka paraqitur mërgimin e mbetetit të fundit të Romës Tarquin Superbit. Dhe ky mërgim " do të kthehet në lumturi për popullin", shkruan ai.

Kritiku dhe retorik romak i shekullit I para erës së re, Kuintiliani ka vërejtur se Akci dhe Pakuvi, më shumë se të tjerët, dallohen për mendime të larta, elegancë shprehjeje, dhe shton se "Akci i kanë atribuar më shumë forcë, ndërsa Pakuvin e kanë mbajtur më shumë erudit".

Interesi i veçantë për jetë, politike dhe shoqërore në Romë dhe futja e tematikës romake në komedi sollën mjaft ndryshime në këtë gjini. Komedia "pallat" u zëvendësua me komedinë " togata", në të cilën nuk marrin pjesë personazhe greke, por romake, me kostume dhe amra latine. Vepe-

rimi i këtyre komedive zhvillohet në Itali, por me shpesh jo në Romë, por në rrugët e qyteteve të vogla italice, para dyqaneve ("tabernave") të zejtarëve latine. Prandaj këto komedi i quajtur dhe "comedia tabernaria". Përveç ndryshimeve të tjera një element i ri është futja në një masë më të gjerë e figurës së gruas në komedinë romake, e cila nuk bënte një jetë aq të mbyllur sa gruaja greke. Nga vetë titujt e komedive "Tnjeshtra", "Kunata", "Tezet", "Vajza e lindur pas vdekjes së babait", etj.) shihet se personazheve femra u është kushtuar më shumë vend në komedinë togate, dhe në shumicën e rasteve jo heteres, por qytetares së zakonshme, me hallët dhe konfliktet e saj familjare dhe jetësore. Tema më e zakonshme është ajo e dashurisë, që triumfon zakonisht pas pengesave dhe vështirësive që hasin të rinjtë në rrugën e tyre. Pabarazia shoqërore e të rinjve të dashuruar dyshimet e kota në marrëdhëniet familjare, kundërshtimi i prindërve për të frenuar ndjenjat e lira të bijve dhe të bijave të tyre, të gjitha këto janë si tuatat e zakonshme nëpër të cilat shtjellohet subjekti i komedisë togate, që vazhdon rrugën e komedisë prekëse të Terancit. Filozofi dhe shkrimtari romak Seneka thoshte se komedia togate shquhej për seriozitetin e saj dhe zinte një vend në mes të tragjedisë dhe komedisë. Me sa duket ajo i afrohej më shumë asaj që në kohët e reja u quajt "dramë familjare". Nga ato pak fragmente që na kanë mbetur nuk duken jehona ngjarjesh të mëdha politike.

Nga autorët e komedisë togate me i njohuri ka qenë Afrani, që ka jetuar nga fundi i shekullit II. Koha e lulëzimit të togatës ka qenë fundi i shekullit II dhe fillimi i shekullit I, periudha e vëllezërve Grake dhe e diktaturës së Siles.

Një lloj tjetër komedie është dhe atelane, e cila ishte shumë e njohur në Romë qysh në kohën e Plautit. Kjo ishte komedi popullore italice, e cila mori trajtë artistike në kushte të veçanta të zhvillimit shoqëror, u quajt "atelana" nga emri i qytetit Atela në krahinën e Kampanjës. Ky lloj letrat vinte në lojë jetën provinciale dhe dallohej për maskat (personazhet) e përhershme të budallait (Makku), të grykësit (Bukkoni), të plakut koprac (Pappi) dhe të filozofit fjalaman (Dosseni).

Deri në ditët tona kanë arritur vargje të veçanta të atelanës letrare të Pomponit dhe të Novit.

rua në maksimumin e përhapur shumë në atë kohë. " Është në mirë të vdesësh se sa të rrosh në një skllavëri të turpshme. Për urtësinë popullore me interes janë maksimumet " Borxhi është një skllavëri e rëndë", " Duke pranuar bamirësinë, shet lirinë", Nuk mund të nxjerrësh fitim, pa dëmtuar tjetrin", " Rehat rrojnë ata që zhdukin nocionin " imi", " yti", " Edhe nga një kasolle mund të dalë një njeri i madh " etj.

Në këto rrethane politike dhe shoqërore letërsia romake mori tipare thellësisht aktuale. Vetë buzzat e shtetit jepën pas shkrimeve, duke parë se letërsia luan rol të madh propagandistik në shoqëri. Kështu lindi dhe u zhvillua mjaft publicistika dhe historiografia. Ne dy shekujt e parë të republikës, nga të cilët janë ruajtur pak dëshmi të sakta, merr një farë zhvillimi tregimi, i cili përveç trillimeve dhe zbukurimeve, paraqet dhe aspekte nga realiteti i gjallë. Aktualizimi, afrimi me jetën e Romës shihet edhe në lemin e poezisë.

Më pak nga të gjitha u prek nga këto ndryshime tragjedia, që ruajti tematikën e saj tradicionale. Klasiku i fundit i tragjedisë romake në këtë periudhë ishte AKCI (vitet 170-90). Dramat e tij shquhen për patetikën dhe begatinë stilistike. Ai merr si bazë subjektet e tragjedive greke dhe i përpunon në mënyrë të pavarur. Edhe te Akci degjohet pulsi i fortë i jetër politike romake. Shpesh në tragjeditë e tij paraqiten tiranë, që ndëshkohen për veprimet e tyre. Shumë e njohur ka qenë thënia në një nga tragjeditë e tij, për tiranët " Le të urrejnë, mjafton që të kenë frikë". Në këtë frymë shkroi ai tragjedinë " Bruti", ku ka paraqitur mërgimin e mbtetit të fundit të Romës Tarquin Superbit. Dhe ky mërgim " do të kthehet në lumturi për popullin", shkruan ai.

Kritiku dhe retorikë romak i shekullit I para erës së re, Kuintiliani ka vërejtur se Akci dhe Pakuvi, më shumë se të tjerët, dallohen për mendime të larta, elegancë shprehjeje, dhe shton se "Akci i kanë atribuar më shumë forcë, ndërsa Pakuvin e kanë mbajtur më shumë erudit".

Interesi i veçantë për jetë, politike dhe shoqërore në Romë dhe futja e tematikës romake në komedi sollën mjaft ndryshime në këtë gjini. Komedia "pallat" u zëvendësua me komedinë " togata", në të cilën nuk marrin pjesë personazhe greke, por romake, me kostume dhe emra latine. Vep-

rimi i këtyre komedive zhvillohet në Itali, por me shpesh jo në Romë, por në rrugët e qyteteve të vogla italice, para dyqaneve ("tabernave") të zejtarëve lätine. Prandaj këto komedi i quajmë dhe "comedia tabernaria". Përveç ndryshimeve të tjera një element i ri është futja në një masë më të gjerë e figurës së gruas në komedinë romake, e cila nuk bënte një jetë aq të mbyllur sa gruaja greke. Nga vetë titujt e komedive "Injeshtra", "Kunata", "Tezet", "Vajza e lindur pas vdekjes së babait", etj.) shihet se personazheve femra u është kushtuar më shumë vend në komedinë togate, dhe në shumicën e rasteve jo heteres, por qytetares së zakonshme, me hallët dhe konfliktet e saj familjare dhe jetësore. Tema më e zakonshme është ajo e dashurisë, që triumfon zakonisht pas pengesave dhe vështirësive që hasin të rinjtë në rrugën e tyre. Pabarazia shoqërore e të rinjve të dashuruar dyshimet e kota në marrëdhëniet familjare, kundërshtimi i prindërve për të frenuar ndjenjat e lira të bijve dhe të bijave të tyre, të gjitha këto janë si tuatat e zakonshme nëpër të cilat shtjellohet subjekti i komedisë togate, që vazhdon rrugën e komedisë prekëse të Terancit. Filozofi dhe shkrimtari romak Seneka thoshte se komedia togate shquhej për seriozitetin e saj dhe zinte një vend në mes të tragjedisë dhe komedisë. Me sa duket ajo i afrohej më shumë asaj që në kohët e reja u quajt "dramë familjare". Nga ato pak fragmente që na kanë mbetur nuk duken jehona ngjarjesh të mëdha politike.

Nga autorët e komedisë togate me i njohuri ka qenë Afrani, që ka jetuar nga fundi i shekullit II. Koha e lulëzimit të togatës ka qenë fundi i shekullit II dhe fillimi i shekullit I, periudha e vëllezërve Grake dhe e diktaturës së Siles.

Një lloj tjetër komedie është dhe atelane, e cila ishte shumë e njohur në Romë qysh në kohën e Plautit. Kjo ishte komedi popullore italice, e cila mori trajtë artistike në kushte të veçanta të zhvillimit shoqëror, u quajt "atelana" nga emri i qytetit Atela në krahinën e Kampanjës. Ky lloj letrat vinte në lojë jetën provinciale dhe dallohej për maskat (personazhet) e përhershme të budallait (Maku), të grykësit (Bukkoni), të plakut koprac (Pappi) dhe të filozofit fjalaman (Dosseni).

Deri në ditët tona kanë arritur vargje të veçanta të atelanes letrare të Pomponit dhe të Novit.



Aty nga fundi i shekullit II u zhvillua mjaft satira, që me shumë se komedia, u bëri jehonë problemeve politike dhe shoqërore.

### GAJ LUCILI (148 - 103)

Lindi në Suesa Aurunka. Megjithëse rridhte nga aristokracia e madhe skllavopronare dhe ishte shumë i pasur, me prona të mëdha toke në Italinë Jugore dhe në Sicili, u mundua t'u shmanget detyrave të larta shtetërore, që i hapnin rrugën për në senat. Ai dëshironte, siç thoshte vetë " të mbetet Lucil" dhe nuk pranonte ta ndëronte pavarësinë e tij me çfarëdo lloj thesari. Ai jetoi në periudhën e trazuar të Grakëve dhe ishte mik e bashkëpunëtor i Scipionëve. Kjo ka qenë koha e dobësimit të pushtetit të senatit, anëtarët e të cilit e kishin njollosur veten me lloj-lloj veprash të ulëta dhe kishin tradhtuar interesat e popullit.

Gaj Lucili, autor i njohur i satirave, goditi me guxim e temperament veset e aristokracisë së senatit si dhe plagët e shoqërisë romake. Për këtë ai shfrytëzoi dhe i dha formë të përkryer artistike atij lloji letrar, që huazoi tek Enni, pra shkroi satira, ku përfshiu një tematikë të gjerë e të larmishme në vargje. Një pjesë e madhe e satirave kanë temë morale. Autori jep gjykime mbi shoqërinë, mbi kënaqësinë, ambicien, mbi luksin, mashtrimin, hipokrizinë, virtytin etj. Degjenerimi moral i aristokracisë i dha Lucilit material të pasur për të ilustruar tezat e tij etike me shembuj nga jeta e përditshme romake. Satira e tij arrin mprehtësinë më të madhe kur polemizon me armiqtë e tij politikë.

Në satiret e tij Lucili godet me ashpërsi zvetënimin moral të senatorëve, pasojat e degjenerimit të komunës romake.

Duke u orientuar drejt filozofisë helenistike, ai gjithsesi ideal kryesor quan virtytin ( virtus) e lashtë romak. Duke kritikuar ashpër persona të veçantë, armiq politikë të tij, ai nuk ngurron të satirizojë edhe prirjet e grekomanisë. Lucili u hoqi maskën, ose siç është shprehur Horaci, " u hoqi lëkurën" armiqtë të tij. Satirat e tij herë marrin formën e parodisë, të pamfletit e herë atë të mesazhit, të fejttonit. Lucili në veprën e tij përpiqet t'i mënjanohet stilit të lartë dhe t'i afrohet gjuhës së za-

konshme. Satirat janë shkruar me heksametër ( varg gjashtë-këmbësh), i cili qysh atëherë u bë forma e palëvizur e satirës romake në vargje ( Horaci, Persi, Juvenali).

Deri në ditët tona kanë arritur rreth 1000 vargje, por edhe këto të grimcuara; vargje të shkëputur, gjysma vargjesh fjalë të veçanta etj.

Për Lucilin edhe ato pak gjëra, i dimë nga të tjerë dhe jo nga ai vetë. Kujdes të veçantë i kushtoi atij Horaci, të cilin për nga talenti e vuri mbi veten, por edhe e kritikoi për pakujdesi stili. Thuhej se Lucili diktonte brenda një ore dyqind vargje, madje duke qëndruar në një këmbë.

Edhe pse thënie të tilla kanë frymë anekdotike, dihet se Lucili kishte lehtësi shumë të madhe në të shkruar.

Për mprehtësinë tematike të satirave të tij Lucilin e çmuan edhe në kohën kur u shemb republika dhe u vendos perandoria. Problemet e moralit dhe të jetës shoqërore të Romës, të trajtuara në satirat e Lucilit, tërhoqën vëmendjen e lexuesve të epokës së Augustit, kur kishte shumë syresh që parapëlqenin ndaj Horacit, këtë autor satirash. Edhe Kuintiliani ( shek. I era e re) e vinte Lucilin mbi Horacin. Ai që e ka çmuar më shumë ka qenë gramatikani Nonni, i cili na ka përcjellë pjesën më të madhe të citateve nga Lucili.

## CICERONI

( 106 - 43)

Tematika e mprehtë aktuale politike, që ushqeu satirën e Lucilit gjeti shprehjen e saj të plotë artistike para erës së re në oratorinë romake. Zhvillimin e vrullshëm të kësaj gjinie e përcaktoi jeta e gjallë politike, lufta e klasava para vendosjes së perandorisë. Oratorët më të mëdhenj të fundit të shekullit II ishtin vëllezërit Grak, sidomos më i riu, Gaj Graku.

<sup>i</sup> Por Oratori më i madh i Romës është Mark Tul Ciceroni, që ka jetuar midis viteve 106 dhe 43 para erës së re. Lindi në afërsi të Arpinit, në Laciun. Ciceroni, ideologu i fundit i rëndësishëm i sistemit republikan romak ka qenë jo vetëm mjeshtër i madh i oratorisë, por edhe shkrimtar i shkëlqyer, avokat dhe njeri politik. Me veprimtarinë e tij letrare Ciceroni hodhi bazat e krejt zhvillimit të mëtejshëm të prozës latine. Nga ai kanë arritur 56 fjalime, një radhë traktesh mbi retorikën dhe filozofinë, 800 letra etj.

Udhëheqësi i ardhshëm i partisë së senatit ish një "njeri i ri" për aristokracinë romake.

Marku, së bashku me vëllanë e tij Kuintin morën shkollën në Römë të mësuesit grek. Këtu ata fituan njoftime të mira për letërsinë klasike greke, për Homerin, dramën dhe oratorinë. Ciceroni si çdo i ri që përgatitet për karrierë politike ose avokatore, sipas zakonit romak, ndoqi mësimet praktike në forum domethënë dëgjoi oratorët më të mirë. Udhëheqëri i Ciceronit në këtë fushë ka qenë Scevola plak, një nga anëtarët më të rinj të rrethit të Scipionëve. Pas vdekjes së tij Ciceroni pati si mësues Scevolan tjetër, që ishte nip i të parit dhe jurist i njohur.

Vepri i parë i tij si avokat Ciceroni e filloi nga fundi i vitit 80 para erës së re, në kohën e diktaturës së Silës. Në vitet para luftës civile ishin vrarë oratorët të njohur, kështu që në forumin romak si me i njohuri tani kishte mbetur oratori Hortens, nga një familje aristokrate. Ciceroni në ato vite ishte rival dhe kundërshtar politik i Hortensit. Diktatura e aristokracisë cenonte interesat dhe dëmtonte influencën politike të "kalorsisë", me të cilën ishte lidhur ngushtë Ciceroni, kështu ai gjendej në një farë opozite me aristokracinë dhe ishte i prirur të flironte me partinë demokratike. Që në ligjeratën e parë që na ka arritur, mbajtur në një proces civil rreth një pasurie në shohim sulme kundër aristokracisë që abuzon me pushtetin dhe privilegjet e saj. Sukses të madh Ciceroni korri me ligjeratën në mbrojtje të një qytetari të pasur romak, të cilit të afërmit e tij kërkonin t'i rrembenin pasurinë. Meqenëse në këtë punë grabitjeje kishin gisht edhe njerëz me influencë, asnjë nga oratorët e njohur nuk pati guximin të marrë mbi vete mbrojtjen e këtij qytetari të pasur romak, të cilin e akuzonin si atvrasës me qëllim që t'i merrnin pasurinë që kish trashëguar nga i ati. Ky ishte rast i mirë për të riun Mark Ciceron, që të fitonte famë si avokat. Në procesin, i cili atë kohë zgjoi interes shumë të madh. Ciceroni demaskoi makinacionet dhe prapaskenat e errëta të kurdisura nga njerëz që kërkonin të nxirrin fitime duke ngritur padije kriminale. Në të njëjtën kohë oratori bëri dhe një kritikë të përmbajtur, por tepër shprehëse kundër regjimit të Silës, sigurisht pa e prekur atë drejtpërsëdrejti. Procesi i dha Ciceronit emër të madh. I akuzuari doli i pafajshëm.

Pas kësaj mbrojtjeje të guximshme të qytetarit romak Rosci, qendrimi i Ciceronit në Romë paraqiste një farë rreziku. Në vit më vonë ai u nis së bashku me vëllanë Kuintin për një udhëtim të gjatë nëpër Greqi dhe Azi të vogël, me qëllim që të plotësonte në këto vende kulturën e tij retorike dhe filozofike. Rëndësi të madhe për formimin e Ciceronit pati qëndrimi i tij në Rodos, ku mori mësim nga një mësues i njohur në retorikë, nga Apolon Moloni, me të cilin oratori romak ishte njohur që në Romë. "Pas dy vjetësh", shkruan ai më vonë në një nga traktatet e tij, unë u ktheva jo vetëm me i shkathet, por gati krejt i ndryshuar."

Veprimtaria avokatore pas kthimit në Romë e bëri emrin e Ciceronit të famshëm. Kur mbushi moshën mamdhore të parashikuar nga ligji atë e zgjodhën në detyra të ndryshme, si kuestor (në sektorin e financës) në vitin 75. Një vit më vonë e shohim me një detyrë të rëndësishme po në financë në provincën e Sicilisë, ku la përshtypje dhe kujtime të bukura me sjelljen e tij korrekte. Kur nga fundi i vitit 71 sicilianët deshën ta hidhnin në gjyq regjentin romak, Verres, që kishte plaçkitur provincën e tyre, iu drejtuan Ciceronit duke iu lutur që ta merrte ai në dorë akuzën. Ky ishte edhe një rast tjetër i mirë për Ciceronin të shtjellonte një kritikë të ashpër kundër abuzimeve me ofiqet shtetërore dhe vjedhjeve, që ishin bërë aq të zakonshme në periudhën e renies së republikës. "egjithëse mbrojtës i Verresit ishte Hortensi, materiali paditës i mbledhur nga Ciceroni ishte aq i qartë dhe i rëndësishëm, sa që Verresi, pas sesionit të parë të gjyqit papapëlqeu të mos priste përfundimet e procesit duke përdorur të drejtën e qytetarit romak të mërgimit vullnetar."

Edhe në provincën e Kilikisë (në Azinë e vogël), ku Ciceroni ishte emëruar prokonsull në vitin 51 fitoi simpatinë e banorëve dhe të ushtarëve romakë të atjeshëm. Ciceroni u kthye në Itali nga fundi i vitit 50, në pragun e përçarjes në mes Çezarit dhe Pompeut, në pragun e luftës civile. Te dy rivalet donin ta tërhiqnin Ciceronin në anën e tyre. Por ky për disa kohë mbeti në një pozitë asnjënjëse dhe pastaj, pas përpjekjesh të pafrytshme që bëri për t'i pajtuar të dy palët, u bashkua me optimatet dhe shkoi në Greqi tek Pompeu, megjithëse nuk kishte shumë besim tek ai. Disfata e Pompeut në Farsale në vitin 48 e shtyu

Ciceronin të heqë dorë nga lufta dhe të kthehet përsëri në Itali. Cezari u pajtua shpejt me Ciceronin, por në vitet e diktaturës së tij ai e ndaloi atë të merrej me veprimtari politike. Në këtë periudhë Ciceroni dha një prodhim të madh në fushën e letërsisë. Ai shkroi traktetet "Bruti" ku tregohet historia e oratorisë romake, dhe "Oratori", ku fli-tet mbi përsosjen e stilit. "Tahas kësaj, ai shkroi dhe një radhë veprash me karakter filozofik mbi çështje të ndryshme të teorisë së njohjes, mbi metafizikën dhe etikën, që i bënin të njohura publikut romak rrymat me të rëndësishme të filozofisë greke.

Pas vrasjes së Jul Cezarit, në mars të vitit 44 para erës së re, për Ciceronin u hap përsëri një periudhë e re veprimtarie politike. Duke dalë në krye të partisë së senatit, ai bëri një luftë aktive kundër Antonit, që kishte tradhëuar republikën dhe e mbante veten pasardhës të Cezarit dhe përkrahu nipin e Cezarit Oktavianin. Nga kjo kohë kemi fjalime të fuqishme kundër Antonit, që Ciceroni i quajti "Filipike", sipas fjalimeve të famshme të oratorit Demosten kundër Filipit. Këto janë rreth 14 ligjëratat e fuqishme të shkruara me pasion të madh që përbëjnë dokumentin e fundit të rëndësishëm të republikanizmit romak. Kur u pajtua Oktavianin me Antonin dhe bëri aleancë me të ( triumvirati i dytë), sipas kërkesës kategorike të Antonit, Ciceroni u vu në listën e parë të proskripcioneve ( të personave që nxirreshin jashtë ligjit). Kështu në dhjetor të vitit 43, agjentët e Antonit e vranë Ciceronin. Antoni urdhëroi që koka e Ciceronit të vijej në tribunën oratorike të forumit romak, nga ku oratori i madh kishte shkëlqyer me elokuencën e tij.

Ciceroni ka qenë një nga njerëzit më me kulturë të kohës së tij. Ai dha një kontribut të shuar në shumë fusha të krijimtarisë letrare e filozofike, megjithëse nuk ishte ndjekës konsekuent i ndonjë sistemi filozofik. As ai vetë nuk e mbante veten si mendimtar dhe filozof origjinal. Ciceroni ishte filozof eklektik.

Në traktetet filozofike ai del si mbrojtës i rregullave të lashta qytetare romake, ngrihet kundër epikurizmit, duke predikuar etikën e shkollës "neoakademike" greke, e afërt me stoicizmin. "randaj Marksii thotë se duhet lexuar Ciceroni për t'u bindur se " filozofitë e epikurit, e stoikëve ose e skeptikëve ishin fetë e romakëve të mësuar në momentin kur Roma arriti kulmin e fuqisë së saj".

Si teoricien i oratorisë Ciceroni nuk kënaqej me rregullat skolastike të retorikës. Në dialogun " Mbi oratorin" ai flet për një kuptim shumë më të gjerë të detyrave të oratorisë. Këtë bisedë mbi të folurit bukur e çoi aty nga viti 91, domethënë në kohën fare pak para fillimit të luftërave qytetare. Sipas tij këto ishin ditët e fundit të mira të republikës. Personazhe në këtë dialog ishin udhëheqësit e partisë së senatit, të mbledhur për të gjykuar gjendjen politike duke parashikuar " fatkeqësitë e ardhshme të shtetit". Kjo lidhje e oratorisë me politikën në këtë dialog nuk ishte e rastit, sepse, siç e ka thënë edhe vetë autori", në çdo popull të lirën në shtetet e qeta dhe paqësore kurdoherë ka lulëzuar dhe ka sunduar oratoria". Për Ciceronin oratori është, pikë së pari, burrë shteti dhe jo një ngatërrestat gjyqi ose deklamues shkolle. Prandaj në programin e përgatitjes së oratorit, përveç retorikës shkollore, hyjnë të gjitha ato dijeni që janë të domosdoshme për veprimtarinë politike.

Në traktatet " Bruti" dhe " Oratori", kushtuar ardit të të folurit, Ciceroni del ndjekës i rregullave të fiksuara të retorikës. Sipas mendimit të tij tipi i ligjeratës varej nga rrethanat, në të cilat mbehej ajo. Prandaj oratori në fjalën e tij duhet të përdorë nuanca. Ciceroni shpreh mendimin se oratorit i paraqiten tri detyra: a) të tregojë pozitën e tij; b) të kënaqë degjuesit, 3) të ndikojë në vullnetin e tyre. Secilës nga këto detyra i përgjigjet njeri nga të tri " stilet" " stili i qetë", " i ulët", që është i përshtatshëm për të bindur, stili " i mesëm", i krijuar nga oratoria sofistike, që shquhet për një finesë të madhe e figura të zgjedhura dhe, së fundi, stili "solemn, i lartë i cili me fuqinë e tij patetike e tërheq dhe e tronditi lexuesin . Takti oratorik kërkon përdorimin sipas nevojës së të tri stileve, por cilësia e çmueshme, sipas Ciceronit, ishte zotërimi i stilit " të lartë". Në argumentimet e tij Ciceroni sillte si shembull oratorin e madh grek Demostenin, mjeshtë i fjalimit prekës dhe " të fuqishëm". Duke krahasuar Ciceronin me Demostenin, shkrimtari i njohur romak i shekullit I era e re, Kuintiliani, thotë se tek i pari " nuk mund të heqësh asgjë" dhe tek i dyti "nuk mund të shtosh asgjë".

Megjithëse zotëronte në mënyrë të përsosur të gjitha " stilet", talenti oratorik i Ciceronit u shqua në mënyrë

të veçantë në stilin "solemn", prekës. Këtë e pranonin dhe bashkëkohësit e tij. Kur Ciceroni merrte pjesë në procese së bashku me mbrojtës të tjerë, rolet zakonisht ndaneshin në mënyrë që atij t'i takonte pjesa mbyllëse, patetike. Thirrjet, lutjet, të shoqëruara me gjeste të gjalla plot temperament, referimet dhe apostrofet drejtuar hyjnive, fjalimet e përfytyruara të vëna në gojën e personazheve alegorike, tërë këtë arsenal të patetikës oratorike antike Ciceroni e zotëronte në mënyrë të përsosur dhe e shprehte këtë në një formë të bukur.

Por arti i tij nuk u kufizua vetëm në këtë sferë. Në një fjalim të vetëm ai ndërronte disa herë tone, duke kombinuar thekset prekëse të ligjeratës së tij me një farë humori e komiciteti, pasionin me thjeshtësinë dhe qetësinë. Në fjalimet e tij gjejmë tablo dramatike, përshkrime, karakteristika. Ciceroni provoi të shkruajë dhe vjersha, që dëshmojnë më shumë për zotërimin e vargut e jo për dëll poetik. Ciceroni si shkrimtar dhe orator ndikoi shumë jo vetëm në letërsinë romake, por dhe në atë evropiane.

Kritika antike e ka çmuar shumë rolin e Ciceronit për krijimin e stilit të prozës latine. Në penden e Ciceronit kjo mori jo vetëm shprehje të fuqishme artistike, por edhe elasticitet dhe shkathtësi për të shprehur nuancat e ndryshme të mendimeve të ndërlikuara. Gjuha e Ciceronit u bë normë për të ashtuquajturën latinishtë klasike. Atë e çmuan shumë jo vetëm kritika romake, por dhe ajo greke, e cila zakonisht e injoronte letërsinë romake. Këtë rëndësi Ciceroni e ruajti edhe më vonë; prandaj dhe një pjesë e mirë e veprës së tij brez pas brezi ka arritur deri tek ne. Interes i veçantë për veprën e oratorit romak u tregua në kohën e Rilindjes evropiane, kur shpërtheu lufta për emancipimin e personalitetit të njeriut, kundër skolastikes dhe obskuranizmit të mesjetës. Më vonë, në periudhën e revolucioneve borgjeze, kur oratoria u bë armë e fortë e propagandës, vlera e Ciceronit ndikoi me forcë të re në ligjeratat e oratorëve revolucionarë borgjezë.

## 1. ZHVILLIMI I HISTORIOGRAFISË ROMAKE.

### JUL CEZARI

Një stilist i shquar në prozën latine, ka qenë dhe Jul Cezari, që ka jetuar nga viti 100 deri në vitin 44 para erës së re. Qysh i ri ai u dallua si gojëtar, i zoti. Kulturën oratorike Cezari e mori në fillim në Romë dhe pastaj në Rodos, te mjeshtëri i retorikës Apolon Moloni. Nga ekspeditat ushtarake dhe nga përvoja si burrë shteti ai shkroi dy vepra me karakter historik, që kanë rëndësi edhe nga pikëpamja letrare për stilin dhe gjuhën e tyre të bukur. Veprimtaria e tij e parë "Komentaret mbi luftën e Galisë" flet për operacionet ushtarake të autorit në Gali, të cilën ai e nënshtroi, si dhe për ekspeditat e tij në Gjermani dhe në Britani. Komentaret në përgjithësi përfshijnë vitet 58-52 para erës së re. Parashtrimi historik shquhet nga thjeshtësia e jashtëzakonshme, që, në vështrimin e parë, duket si nuk ka art; por kjo është bërë në mënyrë të vetëdijshme. Vepra ka karakter apologjetik. Veprimtaria e Cezarit në Gali u kishte dhënë rast shumë kritikave, dhe kundërshtarët politikë të tij i shfrytëzonin këto që të ngrinin kundër tij opinionin publik. Vepra "Komentaret mbi luftën e Galisë" duhej të justifikonte veprimet e autorit. Nga parashtrimi i menduar thellë e i bërë me një stil të qetë e sugjektiv lexuesi bindet se lufta në Gali ka qenë bërë vetëm e vetëm për të mbrojtur interesat legjitime të Romës dhe të fiseve aleate të saj. Cezari, me arsyetimet e thjeshta e të qarta orvatet të justifikojë operacionet ushtarake. Por atëherë kur has në fakte të pakundërshtueshme, për të mënjeluar gënjeshtërinë e hapur, ai përdor shpesh metodën e heshtjes. Në "Komentaret" personaliteti i Cezarit paraqitet i mbështjellë me veti magjepsese: si komandant i shkëlqyer, energjik, burrë shteti që orientohet shpejt në situatat më të ndërlikuara, i kujdesshëm për vartësit e tij, njeri i dashur e i sjellshëm me të gjithë.

Autori përdor tonin e matur dhe të qetë me qëllim që ta bindë lexuesin për objektivitetin e parashtrimit të tij historik. Prandaj ka zgjedhur dhe formën letrare të "komentareve". Në këtë term, quheshin, ato vepra që nuk kishin pretendime artistike; në to materiali shtjellohej pa zbulime dhe hollësira stilistike. Pikërisht në këtë thjeshtësi qëndron dhe bukuria e veprës. Historia ka arritur që.



me një stil tepër konciz, me pak vija të tregojë karaktere - ristikat keyesore të çdo situatë.

Interes të veçantë nga pikëpamja historike paraqesin tabloë e rëndit shoqëror të galëve dhe të gjermanëve. Në veprën e tij "Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit" Engelsi ka përdorur mjaft materiale nga përshkrimet e Cezarit mbi këta popuj për të karakterizuar shoqërinë e fisit.

Edhe në veprën tjetër historike "Komentaret mbi luftën civile" Cezari është nisur nga qëllime vetëmbrojtëse. Autori mundohet ta bindë lexuesin se lufta civile u shkaktua vetëm e vetëm nga kundërshtarët e tij dhe se gjatë gjithë kohës ai ka pasur qëllime paqësore dhe se ka mbrojtur vetëm "të drejtat e shkelura" të republikës dhe të popullit. Për këtë veprë Cezari punoi vitin e fundit të jetës së tij dhe nuk arriti ta mbarojë.

Vepra historike e Cezarit, përveç rëndësisë së saj si monumenti më i lashtë letrar për historinë e këtyre tri vendeve, Gjermani, Francë dhe Angli ka shërbyer dhe shërben dhe sot e kësaj dite si tekst shkollor për mësimet e latinishtes, në sajë të thjeshtësisë dhe të pastërtisë së gjuhës.

### SALUST KRISPI

Një tjetër historian i shquar romak ka qenë dhe Salust Krispi. Koha kur jetoi dhe vdiq Salusti (nga viti 86 deri në 35 para erës së re) ishte mbushur me ngjarje të rëndësishme; është periudha e luftës së ashpër civile, periudha e rënies së plotë të republikës. Në veprën e tij historike ai u bëri jehonë këtyre ngjarjeve të mëdha. Njeri i panjohur dhe jo i pasur, Salusti u ngrit dhe u bë një figurë e shquar politike. Si kundërshtar i aristokracisë së senatit në pamfletin "Mesazh Cezari" ai e fton atë të udhëheqë luftën kundër "klikës së fisnikërisë" për çlirimin e popullit të thjeshtë romak nga skllavëria e rëndë dhe paraqet një projekt reformash për rregullimin shtetëror të Romës.

Salusti u përpoq që senati të ngrihej mbi një bazë të gjerë shoqërore, duke tërhequr në të shtresat e mesme dhe në njerëzit me të talentuar. Nga ana tjetër, ai i kish-te frikë masat e gjëra të shpronësuarra dhe kërkonte neutra-

lizimin e proletariatit të Romës dhe largimin e tij nga lufta politike. Shpresat për realizimin e këtij programi Salusti i kishte mbështetur te Cezari. Por Cezari e deziluzionoi Salustin, sepse ai nuk ishte i prirur të mbështetej në ato shtresa të mesme, që e shqetësonin Salustin, i cili në pikëpamjet e tij politike mbeti republikan dhe i shikon-te me mosbesim tendencat monarkiste të Cezarit.

I zhgënjyer në mundësitë e ruajtjes së idealeve republikane, Salusti më vonë u tërhoq nga jeta shtetërore dhe iu kushtua punës si historian. Në monografinë e tij "Perbetimi i Katilines" ai e paraqet Katilinen në sfondin e dekompozimit të shoqërisë romake dhe si produkt i këtij dekompozimi. Flet me entuziazëm për rregullin ideal të Romës së lashtë, që nisi të degjenerojë pas fitores mbi Kartagjenen, për shkak të ambicjeve dhe etjes për karriere. Shkalla e fundit e degjenerimit është shfaqja e tiraneve nga gjiri i fisnikërisë së degjeneruar, që nga ka dalë dhe Katilina.

Ambicjen dhe interesin, arbitraritetin dhe korrupsionin e aristokracisë romake Salusti mundohet ta shikojë qysh në luftën midis Romës dhe mbretit të Midisë Jugurtes, në monografinë "Lufta e Jugurtes".

Vepra e fundit e Salustit është "Historia" ku bëhet një parashtrim sistematik i historisë së Romës në një periudhë të caktuar. Autori e fillon parashtrimin e tij nga viti 78, viti kur vdes Sila dhe e mbaron në vitin 67 para erës së re. Historinë e Romës Salusti e shikon si vazhde përçarjesh pa fund në mes plebejve dhe aristokracisë, të cilët qetësohen dhe pajtohen vetëm në të rrallë, në çastet e ndonjë rreziku nga jashtë. Luftën e ashpër klasore të kohës së tij Salusti e sheh si pasojë të cilësiye të këqija të natyrës njerëzore. Për atë e keqja është e rrenjosur në shpirtin e njeriut, të cilin historiani e sheh me një pesimizem gjithnjë e më të madh. Një interpretim i tillë idealist i luftes së klasave e ka çuar Salustin në vlerime subjektive të zhvillimit historik të shoqërisë romake. Vepra e tij sidoqoftë ze vend të rendësishëm në historiografinë antike për vlerën e saj njohëse, për kërkimet e autorit që t'u japë kuptim të saktë ngjarjeve dhe për të mbetur një historian i pavarur. Për stilin dhe gjuhën e tij të bukur kritika e njohu Salustin si një nga klasiket e prozës latine.

## KORNEL NEPOTI

Kornel Nepoti është një historian shumë me popullor se të tjerët.

Ka jetuar kryesisht në shekullin

I deri në vitin 32 para erës së re. Nepoti na ka dhënë një parashtrim të shkurtër të historisë së përgjithshme, aq sa njihej prej dijetarëve antike. Në veprën e tij "Mbi burrat e shquar" autori na ka dhënë një sere biografish komandantesh të huaj dhe dy biografi burrash shteti romake, atë të Katonit dhe të financistit të njohur Atikut.

Parashtrimi i materialit në këto biografi të shkurtra është i thjeshtë, plot anekdota, që karakterizojnë personin, për të cilin flitet. Në to duket prirja e autorit për të moralizuar.

Kornel Nepoti shkroi me gjuhë të lehtë e të rrjedhshme, orandaj dhe vepra e tij më vonë shërbeu si tekst shkolle për fillimet e mësimit të gjuhës latine.

## LUKRECI

Poeti i shquar romak Tit Lukreci, (98-55 para erës së re) përjetësoi në vargje filozofinë e mendimtarit

të madh të antikitetit Epikurit. Poema e tij e përmendur "Mbi natyrën e sendeve" ose "Mbi natyrën", siç është përkythyer shqip, nuk është thjesht një traktat filozofik, por është një veper artistike e mirëfillte, e mbushur me frymëzim dhe patos poetik, që hapi një faqe të re në letërsinë antike. Lukreci nuk ishte teoricien i ftohtë, që parashtron një doktrinë filozofike të caktuar, por një iluminist, i pasionuar kundër fesë dhe bestytnive. Qëllimi i poemës së Lukrecit është të çliroje njeriun nga frika e vdekjes dhe e hyjnive, nga zgjedha e paragjykimeve që rëndojnë mbi të.

Të dhënat biografike për Lukrecin janë të pasakta. Jetoi në epokën e trazuar nga luftërat civile, të shekullit I para erës së re. Rritja e individualizmit si pasojë e rënies së Komunitetit romak, përpjekja për të ngritur dhe për të zgjidhur në mënyrë të re problemet e etikës, të moralit dhe të fesë, për të njohur bazat e krijimit të botës, të gjitha këto zgjuan në Romë interes për sistemet filozofike greke. Popullariteti të madh nisi të gëzojë filozofia materialiste e filozofit grek Epikurit (shek. IV-III para erës së re).

Të befason dashuria e Lukrecit për jetën reale, ndje-

sia e gjallë e tij për natyrën, besimi te njeriù, në arsye-  
en e tij. Edhe pse shumë shpjegime të Lukresit janë naive,  
sepse bazohen në materializimin e lashtë mekanik, rëndësi  
ka fakti se ai e pranon realitetin objektiv të botës, dhe  
se në themel të të gjitha koncepteve të tij qëndron parimi  
shkencor i ruajtjes së materies në transformimin e saj të  
përhershëm.

Lukreci ishte një epikurian që nuk e izolonte veten  
nga shoqëria ai ishte luftëtar politik iluminist. Si poet  
ai ndoqi linjën e poemave didaktike filozofike të Empe-  
doklit dhe të Parmenidit.

Poema " Mbi natyrën e sendeve" trajton çështje të ma-  
terializmit epikurian në fushën e dukurive të natyrës. Di-  
het se filozofia iluministe e Epikurit materialiste në  
interpretimin e botës, ishte thellësisht idealiste në lidh-  
je me dukuritë shoqërore. Burimin e se keqes shoqërore  
Lukreci e sheh në konceptet e gabuara të njerëzve, një prej  
të cilave është dhe frika nga vdekja që rrjedh nga idetë  
fetare mbi jetën e përtejme.

Lukreci në veprën e tij nuk i përmend asnjëherë ngjar-  
jet politike të kohës së tij; ai parapëlqen më tepër te  
kujtojtë të kaluarën. Për kohën e tij flet në mënyrë të për-  
gjithshme, pa shprehur asnjë qëndrim të qartë ndaj luftës  
politike aktuale.

Poema " Mbi natyrën" është shkruar në varg heksameter.  
Përbëhet nga gjashtë libra, secili prej tyre fillon me një  
parathënie të posaçme.

Në tre librat e parë parashtrohet fizika e Epikurit.  
Kjo është doktrina mbi atomet, në të cilën ai shtjelloi  
doktrinën e Demokritit; në librin e katërt shtjellohet teo-  
ria e njohjes, në të pestin ( astronomia, gjeologjia dhe  
historia e kulturës njerëzore në librin e gjashtë flitet  
për dukuri të ndryshme të natyrës.

Duke ruajtur traditat e lashta poeti nuk mund të mos  
u drejtohej hyjnive në fillim të poemës së tij. Në pamjen  
e parë kjo duket kontradiktore, por Lukreci i vuri si që-  
llim vetes të shkatërrojë konceptet që pohonin se bota  
drejtohet nga fuqitë hyjnore. Nga të gjitha hyjnitë, si mbro-  
jtëse të poemës së tij ai zgjodhi Veneren, hyjneshën e buku-  
risë dhe të dashurisë, fuqinë jetëdhënëse të botës. Menjë-  
herë pas këtij evokimi poetik autori tregon qëndrimin e tij

antifetar. Si një pe i kuq e përshkon poemën mendimi se feja nuk është vetëm burimi i gabimeve, por dhe i të gjitha krimeve. Kjo është errësirë e shpirtit, që duhet të çlirohet me anën e një bote të ndriçuar nga doktrina e Epikurit.

Në librin I poeti tregon se si frika dhe padija e shpien njeriun në besime të kota:

Pra i gjithë njerëzimi  
kur sheh në tokë e gjithashtu në qiell  
shumë fenomene që s'e di nga vijnë,  
kujton se rrjedhin prej fuqisë hyjnore,  
asht vetëm frika që e shpie n'gabim.<sup>1)</sup>

Me qëllim iluministe e për të larguar këtë frikë të përjetshme nga mendja e njerëzve poeti parashtron parimin kryesor të doktrinës materialiste të Epikurit:

... asgjë nuk del prej hiçit, as nuk kthehet  
në hiç.<sup>2)</sup>

Lënda, materia është e përjetshme dhe e paprishshme. Në lëvizjen e saj të përjetshme natyra me ligjet e saja dhe pa ndërhyrjen e hyjnive disa sende i shndërroi në sende të tjera:

Pra kur një send mund të mbarojë në hiç,  
por se çdo gjë prap kthehet siç ka qenë,  
n'formën e parë me anë të shkatërrimit.<sup>3)</sup>

Natyra, sipas Lukrecit, është e mbushur me një mori të pafund trupash të vegjël e të padukshëm, me atome dhe me hapësira të shkreta, që s'kanë mbarim.

1) "Epi natyrën" - Tiranë, 1961.

2) Po aty.

3) Po aty.

Në librin II poeti në fillim i thur lëvdata jetës së qetë të dijetarit, i cili larg jetës publike, ka mundësi t'i kushtohet shkencës. Pastaj me imtësi shpjegon teorinë e atomeve. Flitet se si nga lëvizja e përjetshme e trupave parësorë, nga atomet, lindin trupa të tjerë në borë, që shuhen dhe perterihen pa pushim. Çdo gjë që ne e perceptojmë dhe e kuptojmë është kombinim atomesh të ndryshme, por këto kombinime nuk janë të përjetshme, të përjetshme janë vetëm trupat parësorë, atomet, që përbëhen prej një lënde të përrshkueshme, që janë të plote e solidë e nuk kanë zbrazë-tirë. Atomet janë pambarim në numër dhe meqë janë burimi i trupave të tjerë, ka mundësi të ekzistojnë shumë botë, që rrojnë me shekuj e shekuj e më në fund mbarojnë. Një botë midis botëve të tjera të panumërta është edhe bota jonë, e cila shkon drejt plakjes dhe shkatërrimit të saj. Këto shënja të pleqërisë dhe të prishjes poeti na i ka dhënë me një përshkrim të bukur:

Dhe bujku plak, duke tundur kokën psherëtin  
 Tek shikon çdo ditë shterpësinë e punës së tij të  
 rëndë,  
 dhe po që se krahason të tanishmen me të kaluarën,  
 lavdëron gjithnjë fatin e prindërve të tij.  
 Edhe vreshtari duke parë hardhinë e sëmure  
 shan e shfryn kundër shakullit të tij  
 dhe ëndërron për të kaluarën, kur njerëzit  
 e kalonin jetën mirë dhe nuk shikonin se çdo gjë  
 po mplaket e po fishket dalëngadalë....

Në një vend të librit II poeti flet edhe për kënaqësinë që gjen njeriu në gjirin e natyrës, larg luksit dhe lakmë-së:

Mund t'ulesh n'bar të njomë pranë ndonjë gurre  
 në hijen e një rrapit degëgjane  
 e aty mund të kënaqesh sa të duash  
 pa pase nevojë për gjithë at'madhështi,  
 veçanërisht at-herë kur qeshet stina,  
 stina që na i qendris fushat me lule.<sup>1)</sup>

1) "Mbi natyrën" - Tiranë, 1961.

Në librin III Lukreci parashtron doktrinën mbi shpirtin dhe frymën (mendjen). Ai bën një dallim në mes të asaj që latinisht e quan "anima" (shpirt) dhe asaj që e quan "animus" (frymë, mendje). "Anima" (shpirti) gjendet i përhapur në tërë trupin dhe është lendor. Edhe "animus" (fryma, mendja) është lendore dhe përbëhet prej atomeve jashtëzakonisht të imëta dhe të shpejta, vetëm kështu mund të shpjegohet shpejtësia e mendjes, sipas poetit. Shpirti është qendra e jetës, kurse fryma është vendi ku qëndron ndërgjegjja, vetëdija. Ato kanë lidhje të ngushtë midis tyre. Tërëkëto demonstrome Lukreci i bën për të arritur në pikën më të rëndësishme të doktrinës: të luftojë idetë fetare rreth jetës përtej varrit. Kur vdes trupi, shpirti dhe fryma zberthehen shkatërrohen në atome prej të cilave ishin përbërë. Qëllimi i Lukrecit është ta çlirojë njeriun nga frika e vdekjes; nëse vdes shpirti së bashku me trupin dhe kështu nuk ka asnjë farë ekzistence pas vdekjes, vdekja në këtë mënyrë nuk ka asnjë lidhje me ne. Deri sa jemi gjallë nuk ka vdekje, kur vjen vdekja atëherë ne s'jemi më. Përse pra të na frikësojë. Frika nga vdekja është shkaktuar nga besytënitë trashanike, nga moskuptimi i ligjeve të natyrës. Janë poetet ata që e kanë mbushur Ferriën me shpirtira që vuajnë.

Libri IV shtjellon teorinë mbi ndjesitë, shqisat dhe perceptimet Libri hapet me mendimin se poeti po shkel në shtigje të parrahura:

Gjithnjë jam tue vazhdue ket' udhën time  
nder viset vetmitare....  
ku kambe njeriu s'ka shkelun asnjë here.

Më tutje poeti shpreson për lavdinë që do të korrë:

ta rrethoj' ket' balle me një kunore  
të mrekullueshme, me nj' aso kunore  
që Zanat deri sot s'ja vunë në krye  
kerkujt tjetër në bote, pse ma se pari  
mësimet që unë jap kanë vlerë të madhe  
e unë gjithnjë synoj ta liroj shpirtin 1)  
nga prangat e shtrengueta t'bestytisë...

1) "Mbi natyrën", Tiranë; 1961.

Pastaj poeti hyn në temë dhe flet për shembellesat ("simulacra"), të cilat s'janë gjë tjetër veç thembija shumë të imëta, që lëshojnë trupat. Janë cipa fare të holla, që ende në çdo drejtim, ngacmojnë shqisat tona dhe kështu përftojnë ndjesinë. Shembellesat përcaktojnë edhe dukurinë e të parit. Edhe tingulli është lendor, sepse vetëm trupat mund të ushtrjnë ose mund të pësojnë një veprim. Atomet e ashpra japin tinguj të ashpër, atomet e lëmuara e të buta japin tinguj të embel. Shembellesat që prodhojnë tingullin janë më të fuqishme se sa ato që prodhojnë të parit; provë është fakti se tingulli përshkon murin, kurse me të parit nuk ndodh kështu. Edhe shija e nihatja varen nga forma e atomeve.

Pasi parashtron teorikisht mendimet e tij rreth këtyre gjerave, poeti hidhet me tutje e na tregon ç'ndodh në praktike, në jetën e gjallë me ndijimet. Lidhur me këto përpjeket të shpjegojë çështë dashuria, të shkoqitë natyrën e saj materiale etj.

Si epikurian, për të ruajtur lumturinë dhe qetësinë e shpirtit, që është qëllimi final i doktrinës së Epikurit, Lukreci tërheq vemendjen se duhet të ruhem nga pasionet e vrullshme që krijojnë parafytyrime genjeshtare rreth objektit të dashurisë:

Kush di sa ka në botë tupa të tillë  
të cilët, të Verbuen kërjt prej pasioni,  
u mveshin dashnorëve merita  
që s'i kanë fare.

Në librin V flitet për origjinën dhe krijimin e botës, për kozmogoninë. Poeti këtu polemizon me finalizmin, me teorinë sipas të cilave bota qenkerka krijuar me qëllim. Ai e përjashton ndërhyrjen e perendive në krijimin e botës dhe thotë se ajo është krijuar vetë, në mënyrë të natyrshme. Së pari u formua kaosi ( peshtilli i errët), pastaj toka, dete dhe vonë bimët, kafshët e në fund njeriu. Duke folur për procesin e gjatë të qënieve të gjalla, Lukreci mendon se kjo u bë në saje të pasurisë së embrioneve jetike në tokën e re. Toka krijoi lloje ( specie) të shumta qeniesh të gjalla, por jo të gjitha kanë qenë të afta t'i përshtaten jetës dhe vazhdimit të tyre.



Përbindështa të këtillë mjaft qiti dheu,  
por kot, sepse natyra nuk i rriti,  
s'i la t'arrinin lulen e rinisë....

. . . . .

Sepse, sikurse e shohim dhe na vete  
duhen një tok rrethanash të përshtatshme  
që farat t'këne se si t'përhapen mirë...

Më tutje poeti flet për qenie mitologjike me të cilat ishte mbushur fantazia e njerëzve të lashtë e thotë:

Përsa u takon Kentaurve, duhet dihte  
se ata s'kanë ekzistue askurre në bote  
edhe për asnjë çast s'mund t'ekzistojnë  
qenie me dy natyrë e me dy trupa; 1)  
t'formueme me gjymtyra heterogjene.

Mjaft interesante është edhe ajo pjesë e librit V në të cilën poeti flet për zhvillimin e qytetërimit njerëzor. Në fillim njeriu jetoi nëpër pyje, në luftë me të gjitha rreziqet që i vinin nga natyra dhe nga kafshët e egra. "Njerëzit atëherë as dinin të përdornin zjarrin për gjelle, as dinin të mbulonin - shtatin e tyre me lëkurë kafshësh; po rrinin nëpër lande e shpella malesh....".<sup>2)</sup>

Me vonë njerëzit kaluan në kasolle; filluan të lidhin miqësi me njeri-tjetrin, të rrojnë së bashku, të punojnë dhe të mbrohen së bashku nga fuqitë e egra të natyrës dhe nga fiset e tjera. Njerëzit në fillim merreshin vesh me njeri-tjetrin vetëm me shenja. Vete natyra i shtyu ata të shqyrtojnë tinguj dhe emra për të shënuar objektet e ndryshme. Kjo ndodhi atëherë kur njerëzit filluan të jetojnë në shoqëri.

Më tutje Lukreci, flet për zhvillimin e kulturës materiale, për zhvillimin e insitucioneve të ndryshme shoqërore: të familjes, të komunitetit, të pronës, të ligjeve etj.

1) "Mbi natyrën" - Tiranë, 1961,

2) "Mbi natyrën" - Tiranë, 1961,

Në fillim njerëzit që u dalluan për zotësi e guxim arritën të sundojnë mbi të tjerët dhe, sipas qejfit të tyre, u ndanë te tjerëve tokë, duke mbajtur pjesët me të mëdha e më të mira për vete. Pabarazia midis njerëzve erdhi duke u shtuar gjithmonë e më shumë.

Qëndrimi i epikurianeve ndaj kulturës është i dyanshëm. Lukreci në kulturën nuk sheh vetëm përparim, por edhe pasione të ulëta, ambicje, lufte për sundim e pasuri. Në qoftë se njerëzit e parë primitivë vdisnin shpesh nga mungesa e ushqimit, tani ata vdesin nga halle të tjerë. Tani:

Njerëzimi jep e merr e vuen se koti,  
edhe e humb kohën nder kujdese boshe;  
kjo ndodh sepse nuk di t'u gjeje <sup>1)</sup> cak  
dëshirave te veta për pushtim...

Këtu sigurisht kemi një interpretim idealist rreth procesit të zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore, sepse poeti shkakun e së keqes e sheh në faktorë me karakter subjektiv. Si pasojë e mosfrenimit të dëshirave, njerëzit arritën sa të shkojnë:

... buze humneres, nga shpërthyen  
me vrull edhe për tmerr stuhitë e luftës. <sup>2)</sup>

Poeti ngre zerin e tij kundër luftës, që bën kredinë. Njerëzit dikur binin viktima te bishave të egra dhe të urisë;

Tani lufta vetëm në një ditë vret me mijëra  
e mijëra njerëz nën flamure....

Vend të veçantë në këtë liber Lukreci i kushton arsyes pse lindi feja, përse u përhap "ideja e perendisë dhe na i moushi qytetet me altare, e për me tepër, krijoi ceremonitë aq madhështore". Njerëzit, duke mos njohur shkaqet e dukurive, u atribuonin gjithçka fuqive të mbinatyrshme,

1) "Mbi natyrën" - Tiranë, 1961.

2) Po aty,

perëndive, prandaj gjithnjë kanë bërë çmos që t'i merrnin' hyjnitë më të mirëe t'i pajtonin me lutje e flijime.

Në librin VI Lukreci kërkon të shpjegojë mbi baza shkencore natyrore dukuritë e ndryshme të natyrës. Ai flet për vetetimat, bubullimat, retë. Këto përplasen me njeratjetrën dhe shkaktajnë rrufetë. Me tutje poeti flet për vullkanet, për vërshimet e lumenjve, për sëmundjet e njeriut etj. Me një fuqi të madhe patetike poeti përshkruan murtajën që ra në Athinë. Lukreci tregon se murtaja shkaktohet prej atomeve vdekjeprurëse, që e prishin ajrin dhe e përhapin pak nga pak këtë lëngatë në të katër anët. Murtaja:

si doli prej Egjiptit, ku zu'fill,  
kaloi, nëpërmjet t'ajrit, përmbi det  
e n'fund shkoi e u përplas mu përmbi popull... 1)

Si një mjek i spërvuar autori përshkruan simptomat e sëmundjes, vuajtjet e tmerrshme të atyre që ishin prekur nga sëmundja. Përpara kësaj gjendjeje:

.... arti mjeksor  
rrinte i hutuem në heshtje plot me frikë,  
sa here që i murtajosuni ia hidhte  
t'dy sytë e zgurdulluem e të zhuritun  
prej ethesh dhe të rreshkun krejt për gjumë. 2)

Me përshkrimin e murtajës, që shkatërroi krejt qytetin e Athinës, merr fund libri VI dhe krejt vepra.

Në poemën e tij filozofike "mbi natyrën" Lukreci na ka parashtruar doktrinën materialiste të Epikurit, i cili nga ana e tij u mbështet shumë në materializmin mekanik të Demokritit. Kështu Lukreci u bë vetëm himnizues dhe partizan i flaktë i Epikurit. Prandaj "marksi" e ka quajtur Lukrecin glorifikues të denje të iluministit të madh grek Epikurit.

Poema e Lukrecit ka rëndësi jo vetëm si vepër e shquar

1) Po aty.

2) "mbi natyrën", Tiranë, 1961.

arti, por dhe pse ajo është permendorja me e vjetër dhe me madhështore e shkencës në Romë. Rebdësia e poemës bëhet edhe me e madhe po të kemi parasysh se nga doktrina materialiste e Demokritit dhe nga ajo e Epikurit kanë arritur fare pak gjera dhe se ato u ruajtën me te plota në veprën e Lukrecit. Ajo zuri vend të dukshëm në luftën midis materializmit antik dhe idealizmit në Romë.

Lukreci nuk është vetëm filozof, por dhe poet i madh e i fuqishëm. Ai u ndesh përpara vështirësish që i kapërceu me guxim. Tema shkencore filozofike në vetvete ishte diçka e thatë dhe e zorshme që kërkonte stil rigoroz dhe të saktë, figura të bukura e të fuqishme, që te mund ta rrembenin lexuesin dhe ta ngrinin argumentimin shkencor në sferën e lartë të artit. Lukreci ia arriti qëllimit; subjektin që zgjodhi e ndjeu, sepse ai kishte bindje të thellë në fitoren e arsyes mbi bestytnitë dhe kjo e frymëzoi atë të shkruajë një kryevepër poetike. Këtu poeti pasionin shkencor e ktheu në poezi. Poema "mbi natyrën" shquhet për përshkrimet e bukura, për tablote e këndshme e piktoreske të natyrës, për ndjenjat e thella e plot temperament. Të gjitha këto e ndihmojnë poetin të veshe me petkun e poezisë dhe faktin me të thjeshtë, të embëlsojë buzët e asaj kupe, që përmban një pije mjaft të hidhur, të vështirë për t'u gëlltitur.

Si poet Lukreci eci në gjurmët e poetëve të lashtë romakë dhe qendroi larg rrymave të reja të poezisë romake. Shpesh ai përdori arkaizma, shkruajti me fraza të gjata, përdori epitete dhe krahasime në frymën homerike. Mënyra stilistike dhe gjuha e arkaizuar i jepnin poemës së tij një farë karakteri solemn. Parashtrimi poetik i fizikës epikuriane nuk ishte puna e lehtë dhe Lukreci shpesh qabej për "verfërinë e gjuhës amtare", e cila nuk ishte në gjendje të shprehte si duhet mendimin e grekeve (te Demokritit, Epikurit etj.). Për të shprehur sa me qartë dhe saktë mendimin, ai detyrohej të krijonte vete termat që i duheshin ose të merrte hua në gjuhën greke.

Duke trashëguar nga Demokriti mënyrën e argumentimit përmes analogjive artistike, Lukreci e poetizoi materialin filozofik në mënyrë të përsosur. Përmes figurave dhe analogjive konkrete të cilat formojnë tablo të gjalla dhe të plota poetike, ai arriti të zbulojë pozicionet filozofike epikuriane. Për të bindur lexuesin, Lukreci, në argumentet

ë tij përdor një gjuhë oratorike sugjestive, gjë që e bën atë përsërisht të Virgjilit. Gjuha e poemës së tij është plot neologjizma dhe arkaizma.

Vepra e Lukrecit "Mbi natyrën" u çmua shumë gjatë shekujve. Një adhurues i flaktë i Lukrecit ka qenë Ciceroni, i cili, edhe pse ka qenë kundërshtar i doktrinës së Epikurit, ndikoi shumë për botimin e veprës së Lukrecit. Poeti i shquar romak, Ovidi, me prirje epikuriane, ka shkruar: "Poezia e të madhërishmit Lukreci do të vdesë vetëm atëherë kur e tërë bota do të vdesë në një ditë".

Në mesjetën e vonët Lukreci u harrua dhe u zbulua përsëri në kohën e Rilindjes. Më vonë interesi për veprën e Lukrecit u shtua edhe më tepër. Në shek. XVIII ai u bë një nga poetët më të dashur të antikitetit.

## KATULI

Pas Lukrecit në Romë për një kohë të gjatë nuk dolën poetë të shquar. Republikanizmi konservator

mbronte dhe përkrahte stile dhe lloje të vjetra poetike, si tragjedia në vargje dhe epopene historike, të cilave tanime u kishte ikur koha dhe nuk mund të jepnin fryte të rëndësishme. Nga ana tjetër zhvillimi i filozofisë dhe i retorikës bene që për një kohë të zotëroje proza.

Më rënien dhe degjenerimin e republikës, me ndryshimet që u bene në botëkuptimin romak, shohim të zhvillohet një kulturë dhe një letërsi, që priren gjithnjë e më tepër drejt kulturës dhe formave stilistike të letërsisë helenistike. Apolitizmi, motivet e jetes private dhe të ndjenjave personale, kulti dhe forma etj. - të gjitha këto karakteristika të poezisë greke aleksandrine-gjejnë tani në Romë përkrahës të flaktë. Fillojnë të shkruhen në gjuhën latine epigrame dashurie, idile, poema kulte mitologjike etj. Ky lloj aleksandrizmi romak lulëzoi nga gjysma e shekullit I para erës së re. Ciceroni përfaqësuesit e kësaj rryme letëre i quajti: "poetë të rinj" (greqisht "neoterot").

Poetët e rinj ose, siç u quajtën me termin greqisht "neoteriket", hoqën dorë nga format e mëdha, nga epopeja dhe tragjedia dhe lëruan gjinitë e vogla, epigramen, elegjinë etj.

Një nga përfaqësuesit më të shquar të kësaj rryme të re poetike në Romë është Gaj Valer Katuli. (87 - 34 para erës

së re). Duke qenë bir i një qytetari të pasur nga Verona, Katuli mundi të hyjë në rrethin e rinisë aristokratike të Romës. Jetën këtu ai e kaloi në mes defrimesh e qejfesh, duke qëndruar larg problemeve politike dhe shoqërore të kohës. Një ngjarje me rëndësi në jetën e Katulit ka qenë dashuria plot vuajtje për një grua, e cila në poezitë e tij njihet me emrin e trilluar Lesbia.

Poezia lirike e Katulit shquhet për ngjyra të theksuara subjektive. Motivët e vjershave të tij autori i gjen në sferën e jetës së përditshme, ngandonjëherë me karakter biografik, real ose fiktiv. Për poetin rëndësi të veçantë kanë dridhmat, vibracionet e gjalla të ndjenjave, gëzimi që ndien ai për jetën dhe mirëqënien fizike që i jep ajo. Duke u kthyer nga Azia e Vogël Bitinia poeti në vjershën që shkroi me këtë rast në vend që të na japë përshtypjen e udhëtimit, na flet për mbresat dhe ndjenjat që provoi para nisjes dhe si u kthye në Romë :

Ja, ndjehet përsëri ngrohtësia e pranverës..  
Ej, Katul! Leri fushat frigjiane,  
Leri kullotat e Nikies jugore!  
Po fluturojmë nga kryeqytetet e lavdishme të Azisë!  
Oh, si zien zemra e djegur për shtegtim,  
Si rrahin çapet në udhën e gëzimit!

Pasi kthehet poeti i drejtohet vendlindjes :

Sa i lumtur, sa i gëzuar jam, që të shoh,  
Pasi lashë shkretirat bitine e frigjiane,  
Tani merr frymë lirisht në botën tënde.  
Sa ëmbël më duket tani, si braktisa e harrova  
Halle e munde, të preh trupin e lodhur  
Nga endjet pa mbarim, e të dremitem qetë  
Ne shtrojet e dashura të shtëpisë...

Një nga temat më të rëndësishme për Katulin është ajo e dashurisë. Në radhë të parë këtu hyjnë poezitë e dashurisë për Lesbien. Ky pseudonim që Katuli zgjodhi për të dashurën e tij na kujton poeteshën e madhe greke Safon, që ishte nga ishulli i Lesbos. Dhe në të vërtetë duket sikur ky cikël

vjershash hapet me një përkthim të një vjershe të njohur të Safos, ku paraqiten simptomat e marrëzisë nga dashuria. Atë moment poetik, me të cilin i drejtohej Safoja shoqes që po martohej, poeti romak e fut në jetën dhe ndjenjat e tij për Lesbien. Vjersha mbaron me një lloj sentence racionale:

Zbrazësia, o mik Katul, është helm për ty,  
Ajo zgjon shqetësim në ndjenjat e tua,  
Zbrazësia shumë mbreter ka bërë të humbasin  
E shumë frone të lumtur...

Në një vjershë tjetër Katuli na flet si ka hequr dorë përfundimisht nga dashuria, e cila:

Le të shoqërohet me langojt e saj,  
Nga treqind të përqafojë njeherësh,  
Pa dashur asnjë me zemer, veç duke i ngrene  
mëlqinë secilit.

Vetëm mua te me lere te qete!  
Për shkak të saj me është tharë zemra,  
Si një lule që venitet, kur i shkon  
plugu pranë.

Këto dy vjersha duken sikur e thyejnë tematikën e ciklit. Midis tyre zenë vend vjershat që flasin për mundimet e dashurisë. Cikle të tilla kushtuar së dashures i takojmë shpesh dhe në poezinë helenistike, por Katuli na i jep në të tjera rrethana jetësore e me tjetër ndjenje. Në kushtet greke e dashura e poetit ishte në rastin me të mirë një hetere gjysmeprofesioniste, një grua "jashtë shoqërisë zyrtare". Në Romë pozita e femres ka qenë gjithmonë më e lirë, por kjo liri, më vonë, kur u tunden themelet e familjes, me rënien dhe degjenerimin e vete republikes nisi të degjenerohej. Një gjë e tillë u vu re te pakten në shoqërinë e lartë.

Katul u dashurua me një grua aristokrate, e martuar e pastaj vejushe. Dashuria e tij përpiqet të ngrihet mbi ndjenjen e zakonshme sensuale, por për këtë ndjenje, që ishte digjka e re për njeriun e shoqërisë antike, poeti nuk gjen fjale dhe figura të përshtatshme për ta shprehur. Ai flet

për një " bashkim të përjetshëm miqësie", thotë se e ka dashuruar Lesbien " jo si harbuti shoqen e tij, por si babai dashuron fëmijën e tij ..."

Është karakteristike se figura e Lesbies paraqitet vetëm me disa vija, pa formuar një portret të plotë.

Me një alternacion të shpejtë të sentimentalizmit dhe të arsyes, të simpatisë dhe të vrullit plot nota patetike Katuli ka hartuar dhe poezite mbi trumcakun e dashur, mbi vdekjen e trumcakut, mbi etjen e të puthurave të panumërta etj. Këto janë ato vepra poetike që kanë gëzuar emër dhe famë të veçanta në antikitetet dhe në kohët e reja, që janë imituar kaq shumë dhe përpunuar në poezinë e Rilindjes evropiane dhe të kohëve më të vona.

Më vonë, tonet e heshtura dhe plot ngjyra shakaje zëvendësohen me tone shumë më të zymëta dhe motiv kryesor bëhet lufta e ndjenjave, urrejtja për atë që nuk diti t'i përgjigjet në mënyrë të denjë dashurisë së thelle. Dhe, si rrjedhim, poeti tregon se me gjithë këto, është i paaftë të shtypë pasionin që e përvëlonte gjithnjë e më shumë:

Mik nuk të bëhem më, edhe sikur të bëhesh e thjeshtë siç ishe  
Veç mos të të dashuroj nuk mundem...

Poeti kërkon më kot në vetvete fuqi shpirtërore për ta mposhtur këtë luftë, që e lodh atë edhe fizikisht. Ai me forma arkaike të lutjes u drejtohet hyjnive që të kenë mëshirë për të dhe si shpërblim të ndjenjave të tij të pas-tra t'i japin mundësi " të shërohet".

Një temë tjetër e rëndësishme në liriken e Katulit është përqeshja, tallja e mprehtë dhe e pamëshirshme, drejtuar kundër personave të ndryshëm, sipas mënyrës së jambografeve të lashtë. Poezitë e tij përqeshëse i quan jambe. Në shenjë të sulmeve të tij ai vinte gjithnjë vjedhjen, degjenerimin moral etj. Me jambet e tij ai goditi edhe Cezarin, e sidomos njerin prej egjenteve të tij, Mamurren, Me gjithë karakterin hiperbolik të mjeteve shprehëse këto sulme të Katulit nuk ishin pa një bazë reale. Sipas dëshmiave të historianit Svetoni, Cezari e pranonte vetë se "atij i qe vënë një njollë për jetë me vargjet e Valter Katulit për Mamurren".

Mjaft vjersha të këtij lloji drejtohen kundër poetëve



të rrymës arkaike. Në këtë drejtim Katuli ka krijuar s'peshherë situata të këndshme; kështu një vajzë, e cila i kishte prishur marrëdhëniet me të dashurin e saj, kishte dhënë fjalën se po të ndreqej me të, do t'i bënte fli Venerës vargjet " e poetit më të keq" ( siç duket të vetë Katulit). Ajo u ndreq me të dashurin dhe dërgoi në zjarr për të flijuar "Analet" e një fare Voluzit.

Si neoterik Katuli i kushtoi vëmendje të madhe formës. Vargu i tij është dinamik, mendimi tepër i ngjeshur, idetë e tij lidhen si padashur me asociacione të papritura, që të krijojnë përshtypjen e një të shprehurë të lirë, të natyrshëm, e një shfryrëjeje të vrullshme ndjenjash.

Por as virtuoizizmi i formës e freskia e ndjenjës nuk mund të mbulojnë faktin se lirika subjektive e Katulit ishte shprehje e një rënieje të plotë në botëkuptimin e kohës së tij. Duke mos pasur ndonjë simpati për vlerat ideologjike të së kaluarës, Katuli nuk njeht as edhe në kohën e tij ndonjë pikë mbështetjeje. Prandaj lirika subjektive e Katulit nuk shpërthen në sulme kundër anëve tipike të shoqërisë së korruptuar, por ndryshet në vetvete, në një botë të vockël, introspektive. Poeti kapet me shumë pas ndjenjës së miqësisë, si një mbështetje e rëndësishme në jetë. Dhimbja personale, zhgënjimi; vdekja e të vëllait, dashurua pa fat, tradhtia e miqve, të gjitha këto e bëjnë poetin të vuajë thellë e të bjerë në pesimizëm.

Përveç vjershave të vogla në strofa satike dhe në "polimetra" ( vjersha me vargje madhësish të ndryshme) Katuli shkroi dhe vepra poetike më të mëdha, sipas stilit të poezisë aleksandrine. " Dasma e Peleut dhe e Tetides" është një poemë kulte erudite e mbështetur në burimet helenistike. Katuli përktheu, gjithashtu, edhe ekegjinë e Kalimahut " Gërsheta e Berenikes".

Një farë interesi kanë dhe epitalamet ( këngët e dasmës) në të cilat gjejmë të gërshetuar stilin e ngritur, erudit me format e këngës folklorike. Një nga këto epitalame, e shkruar me rastin e një dasme reale, është një këngë e vërtetë lirike, që përcjell ceremonitë e dasmës romake në të gjitha momentet e saj. Një tjetër epitalam është ndërtuar mbi motivin e " garës" në mes dy koreve, korit të vajzave, që mbrojnë nusen dhe korit të djemve, që mbrojnë dhëndrin. Fitorja, kuptohet, qëndron në anën e të rinjve. ( Këngë të tilla na kujtojnë ato të dasmës gjirokastrite, ku njerëzit

e nuses i këndojnë kësaj duke vënë në dukje kaq e kaq cilësi pozitive morale e fizike të saj, e duke shpotitur dhëndrin i cili nuk e ka hak të marrë një nuse të tillë. Edhe njerëzit e dhëndrit përgjigjen duke kënduar e duke vënë në dukje meritat e këtij.

Krijimtaria poetike e Katulit dhe e gjithë rrethit të neoterikëve qëndron në kufijtë midis poezisë arkaike dhe "shekullit të artë" të kohës së Augustit. Poetët e rinj apo neoterikët, e pasuruan botën e ndjenjave dhe arriten të bëjnë shumë përsa i takon formës poetike, dhe të gjitha këto u pranuan dhe u përvetësuan nga letërsia "klasike" romake. Por vetë fryma e poezisë së neoterikeve, midis tyre dhe ajo e Katulit, nuk i përgjigjej periudhës augustiane prandaj letërsia zyrtare e kësaj periudhe nuk i çmoi si duhet.

Në shekullin I dhe II të grës së re vjershat e Katulit u pëlqyen. Në antikitetin e vonë, me përhapjen e kristianizimit ato nuk zgjuan interes.

Vetëm në kohët e reja lirika e Katulit, e këtij poeti të shquar, u bë objekt i një interesi të veçantë dhe hyri në thesarin e poezisë botërore.

### KREU III

#### LETËRSIA ROMAKE NË EPOKËN E AUGUSTIT

##### 1. SHOQËRIA DHE KULTURA ROMAKE

Pas luftërave të gjata civile dhe politikës që u bënë në Romë për pushtet, republika u shkatërrua plotësisht dhe vendin e saj e zuri perandoria, e themeluar nga Oktavian Augusti, që i vuri vetes si qëllim forcimin e shoqërisë skllavopronare në bazë të diktaturës ushtarake. Diktatura drejtohej jo vetëm kundër skllerverve dhe shtresave të ulëta të popullsisë romake, por dhe kundër tendencave të shtresave të larta për t'u shkëputur nga qendra.

Oktaviani fillimisht e pati vështirë të gjente ekuilibrin në mes klasave të ndryshme të shoqërisë romake për të siguruar pushtetin e tij. Ai erdhi në fuqi me anën e plebsit, i cili duhej shpërblyer për këtë ndihmë në kurriz të konfiškimit të pasurisë të një pjese aristokratësh dhe të shpronësimit të tokave të një pjese të konsiderueshme të pronarëve të vegjel dhe të mesëm. Kur e konsolidoi pushtetin, Oktaviani u afrua me shtresat e larta, me të cilat e bashkonin interesat me qëllim që të neutralizonte politikisht "proletariatën" romake por duke e ruajtur këtë kundër opozitës aristokratike. Ai arriti ta bashkojë rreth vetes krejt Italinë në luftë kundër provincave helenistike që i qeveriste rivali i tij Antoni. Në vitin 27 para erës së re Oktaviani hoqi dorë nga diktatura e hapët dhe vendosi formalisht "republikën", duke mbajtur vete komandën supreme të ushtrisë dhe qeverisjen e provincave kufitare. Organet republikane, senati, konsujt dhe të gjitha funksionet e tjera të vjetra u ruajtën formalisht dhe Oktaviani konsiderohej vetëm "princeps" domethene qytetar i parë në shtet. Por aty

nga viti 23 para erës së re u bënë reforma të reja, që i jepnin atij mundësi të ushtronte pushtetin e tij të plotë. Kështu " republika " mbeti vetëm sa për formë.

Karakter të tillë të dyfishtë kishte dhe ideologjia e rendit të ri. Tendenca për të ruajtur format e jashtme republikane kërkonte një politike demagogjike dhe Oktavia- ni doli me parulla konservatore, për të krijuar përshtypjen në publik se mbronte institucionet e vjetra republikane. Por asnjë makinacion dhe demagogji nuk mundi ta fshinte faktin se rendi politik kishte ndryshuar rrenjesisht. sado që teoricienet e regjimit të ri u përpoqën ta largonin vëmendjen nga gështjet e ndertimit shtetëror, duke nxjerrë në plan të parë domosdoshmërinë e reformave morale. Problemit moral i dhanë rendësi jo me pak të madhe se problemit legjislativ qysh me përpara Paneti dhe pas tij dhe Ciceroni. "E ç'na duhen ligjet e kota, në qoftë se s'kemi zakone të mira" - thotë në këtë kohë Horaci. Nën parullën e restaurimit fetar dhe moral dhe të rivendosjes " së zakoneve te te pareve" u futën shumë gjëra të reja. Gjunjézimi përpara se kaluarës politike dhe fetare të Romës, rivendosja e kulteve dhe e festave të vjetra, të harruara prej kohësh, - te gjitha këto ishin shenja karakteristike të politikës ideologjike të Augustit. Qarqet konservatore e përkrahnin këtë idealizem të së kaluarës, por përsa i takonte së tashmes ata ishin shumë pesimiste. Po kjo ideologji zyrtare e shikonte sundimin e Augustit si një lloj " shekulli i arte" që u dha fund luftërave civile, që solli " paqen" dhe "begatinë" në bote, por që në të njëjtën kohë kërkonte nga qytetaret " devocion " Ashtu si sundimtarët e shteteve helenistike, edhe Augusti e pranoi me kënaqësi ( megjithëse zyrtarisht e refuzoi) hyjnizimin e personit të tij si "shpëtimtar", Apolon i ri, fitimtar kundër errësirës dhe se keqes, si një Merkuri i ri, sjellës i mirësisë dhe i kulturës. Jul Cezari në kohën e tij u vu në radhën e hyjnive. Edhe Augusti, që e mbante veten si pasardhës të tij, ndoqi në shumë ane shembullin e Cezarit.

Parullat konservatore dhe demagogjike, me të cilat Augusti donte të ruante sa për sy e faqe format e jashtme republikane nuk gjetën kudo përkrahje të sinqerte. Sidoqoftë, kushtet objektive e favorizuan atë. Klasa e skllavopronarëve në fund të fundit u pajtua me perandorinë, tek e cila ajo shikonte të vetmen rrugë për të dalë nga qorrso-

kaku i luftërave civile, por ky proces pajtimi ishte i ndërlikuar dhe i gjatë. Perandorit për një kohë iu desh të luftonte kundër opozitës që formohej nga shtresat e ndryshme të popullsisë. E forte ishte opozita sidomos në fillim të sundimit të Augustit, kur maja e aristokracisë ende nuk i kishte humbur shpresat për të kthyer influencën politike të dikurshme; kurse pronaret e mesëm dhe të vegjel të tokave ishin acaruar shumë nga konfiskimi i tokave për t'ua ndarë ushtarëve, që përkrahen dhe sollën në fuqi Augustin. Megjithëkëtë, shtresat e gjera të popullsisë, së Italisë, të lodhura nga luftërat e gjata civile, kërkonin një fare qetësie dhe nuk shikonin rruge dalje tjetër veç pajtimit me situatën e krijuar. Nga ana tjetër, regjimin e Augustit e favorizuan dhe disa rrethana, siç ishte pushtimi i Egjiptit, që derdhi në Romë pasuri kolosale, të cilat u shpenzuan për të kënaqur pretendimet e ushtrisë, masat që u morën për rregullimin administrativ dhe ekonomik të Italisë dhe të provincave, sukseset ushtarake dhe shkëlqimi i jashtëm i qeverisjes. Të gjitha këto i siguruan rendit të ri një fare ekuilibri shoqëror.

Në periudhën e perandorisë u vu re shturje e madhe morale. "Me qëllim që të frenonte këtë shturje dhe të ruante," pastërtinë e gjakut romak i cili, nga marrëdhëniet e lira midis qytetarëve të lirë romakë dhe skllëvërve e të huajve mund të përzihej, u detyrua të marrë një serë masash kundër dekadencës së familjes në shtresat e censorëve të shoqërisë romake. Ai u tregua shumë i shtrënguar në dhënien e të drejtave qytetare romake të huajve dhe e kufizoi tepër dhënien e lirisë skllëvërve, por nuk u kufizua me kaq. Ai shpalli një serë ligjesh, me të cilat vendoseshin privilegje ekonomike dhe administrative për të martuarit, sidomos për ata me shumë fëmijë dhe kufizime për beqaret. Adulteri (tradhtia e gruas ndaj burrit ose e burrit ndaj gruas) dënohej me konfiskimin e një pjese të pasurisë ose me internim. Jo vetëm kaq, por ligji kërcënonte dhe atë burrë, i cili duke ditur tradhtinë e gruas, nuk ngrinte padi ligjore kundër saj. Ky burrë dënohej për përhapjen e adulterit.

Politika e Augustit në lëmin e familjes dhe të martesës, ndërhyrja brutale në jetën private, të bëra këto në parullën e rivendosjes së pastërtisë së dikurshme të zakoneve, shkakton pakënaqësi dhe ndeshen në një kundërshtim të ashpër. Shumë nga reformat dhe projektligjet Augusti u detyrua

t'i realizojë gradualisht, duke i zburur ato ose duke shtyrë afatin e zbatimit, sipas kundërshtimit që gjente në popull.

Ai u detyrua të pranoje edhe martesat e kaloresve me skllavet e liruar, që kishte ndër mend në fillim t'i ndalonte. Rezistenca kundër ligjeve që shpalli Augusti në lëmin e martesës gjeti pasqyrimin e saj edhe në letersinë e kohës.

Oktavian Augusti e vendosi dhe e frocoi pushtetin e tij në etapa. Në vitin 43 para erës së re ai dhe goditjen e tij të parë, duke i vene themelet sundimit të tij në Itali. Pas betejës së Akciumit, në vitin 31 mundi ta bashkoje krejt shtetin romak, por vetëm pas vitit 19 para erës së re mundi të quhet i vendosur përfundimisht rend i ri. Augusti jetoi deri në vitin 14 të erës së re. Në këtë kohë perandoria kishte hedhur rrënje të thella dhe asnjëri nuk mendonte më të kthehej në rendin republikan.

Arti i kësaj periudhe kalimtare dallohet nga prirja për monumentalitet. Ndërtimet në shkallë të gjerë, që bëri, i dhanë mundësi atij të thotë nga fundi i jetës së tij se ai e kishte gjetur Romen të ndërtuar me argjil kur erdhi në pushtet dhe se po e linte prej guri.

Tempujt, pallatet, ndërtesat, publike, që ngrinte Augusti dhe bashkëpunëtorët e tij, kishin për qëllim të rritin madhësinë e Romës dhe të sundimitarit të saj. Në të gjitha këto ndërtime mbizotëronte stili klasik i artit atik grek të shekullit V. Një gjë e tillë u vu re edhe në skulpturë, e cila shpesh kopjoi permendoret e periudhës klasike madje dhe arkaike të Greqisë. Sidoqoftë skulptura romake u përqop për një individualizim më të madh të portretit, për një përmbajtje dhe shprehje artistike që t'u përgjigjeshin sa më mirë ideve të kohës. Fryma konservatore, tendenca, për të ringjalur të kaluaren e lashtë të Romës beri që të ngrihen një sërë permendoresh, që paraqitnin personalitetet e historisë së Romës.

Kjo ndodhi kryesisht në periudhën e kalimit nga republika në perandori. Stili klasik në të vërtetë nuk pati jetë të gjatë; qysh në periudhën kur u vendos përfundimisht perandoria u vu re një fare prirjeje nga pompoziteti, nga artifizialiteti, nga fantazia. Me këto karakteristika do të zhvillohej këndej e tutje arti i perandorisë.

Periudha e mëvonshme augustiane do ta sterhollonte edhe më tepër stilin për të paraqitur me vija me të thek-

suara boten sensuale, boten e interesave të vogla individualiste. Mjaft kuptimplote janë poçet, ku paraqiten skelete me mbishkrime të tilla: " fito dhe shfrytëzo" ose " gëzoje jetën gjersa jeton, e nesërmja nuk i dihet".

Një proces i ngjashëm me këtë u vu re dhe në letërsi. Periudha kalimtare ( afërsisht koha nga viti 40 deri në vitin 15 para erës së re) shënoi një lulëzim të madh të poezisë romake. U gjallërua shumë jeta letrare. Për të njohur publikun me të rejtat e letërsisë u sistemuan salla të veçanta dhe u organizuan rrethe letrare. Por duke filluar nga gjysma e dytë e sundimit të Augustit nisen të duken qartë simptomat e dekadences.

Letërsia romake në periudhën e lulëzimit të saj doli me një program të qartë lufte kundër poezisë së mëparshme të kohës së Katulit, e cila u quajt tani poezi pa përmbajtje. Ajo luftoi për ta ngritur përmbajtjen ideore, për t'u kthyer në stilin klasik dhe në formen harmonike. Stili i ri i poezisë romake u formua në këtë kohë duke shfrytëzuar artin e hollë e plot nuanca, qendësor si në filigrane, të helenizimit, me format e fuqishme, të pastra e kristaline të modeleve klasike të letërsisë greke. Letërsia romake, duke paraqitur botën e mendimeve dhe të ndjenjave të periudhës perandorake, nuk arriti të ngreje, ashtu si letërsia klasike e polisit grek, sidomos drama atike e shekullit V, probleme aq të mprehta e të thella politike, sociale e filozofike, prandaj nuk pati dhe karakter aq popullor sa letërsia greke. Sidoqoftë letërsia romake e kësaj periudhe, për përshkrimin e botës së brendshme të ndjenjave njerëzore, për vlerat e saj artistike, është një nga shfaqjet më të shënuara në tërë letërsinë antike pas periudhës së polisit. Shija për artin dhe letërsinë klasike, që u zhvillua në kohën e perandorisë ndikoi edhe në letërsinë greke. Në poezinë greke të asaj periudhe filloi një farë reagimi kundër stilit " kult" aleksandrin, ndërsa në proze zuri vend të mirë stili klasik "atikizmi".

Prirja për t'i dhënë rëndësi idesë në përmbajtjen e letërsisë u mbështet, u përkrah edhe zyrtarisht. Augusti dhe rrethi i tij ishin të interesuar që letërsia të kthehej në një armë që të propagandonte bazat ideologjike të rendit të ri. Miku i Augustit, Mecenati, për këtë qëllim, mbledhi rreth vetes poetet dhe u përpoq ta kanalizonte krijimtarinë e tyre në interesat e Augustit. Dhe në këtë anë arriti mjaft suksese, megjithëse disa dëshira të perandorit mbeten të pa-

plotësuar, kështu asnjë nga poetet me të shquar nuk pranoi te merrte përsipër të shkruante epopene, që do t'i thurte lavde veprës " së lavdishme " te Augustit.

Rrethi i Mecenatit ishte qëndra më e rëndësishme e lëvizjes së re poetike në Romë; ne të bënin pjesë poetet më të shquar të epokës, Virgjili dhe Horaci.

Kishte edhe rrethe të tjera, me të pavarura nga rendi në fuqi, si ai i oratorit Mesala, i oratorit dhe historianit Asin Polionit, mikut të Antonit.

Në këtë kohë, interesi për letërsinë u rrit tepër. Sipas shprehjes së Virgjilit perandoria krijoi " kohën e lirë " dhe letërsia, e sidomos poezia u bë një nga gjerat me të parapëlqyera të aristokracisë romake, që ishte hequr menjëherë nga veprimtaria politike. Aty nga viti 15 para erës së re, Horaci, do të ironizonte lidhur me këtë diletantizem poetik: " Ne të gjithë, te ditur dhe të paditur, në kohën e lire shkruajmë vjersha "; Poezia, ndaj së cilës me parë mbanin qendrim mospërfillës, tani shihej si mbartese e kulturës, si burim lavdie për poetin dhe atdheun e tij. Me shumë se 50 emra poetesh njiheshin ne periudhën augustiane. Të gjitha ata që mbronin letërsinë duke filluar nga vete perandori e quanin si detyrë të ushtroheshin në artin poetik. Në ato kohë u duken edhe poetesha. Me tërë këtë mori poetesh nuk është e vështirë të mendohet se të gjitha format poetike të letërsisë antike gjetën pasqyrimin e tyre në letërsinë romake të kësaj periudhe. Një gjallësi të madhe mori jeta letrare dhe përmes " recitimevez ", leximit publik të veprave të pabotuara. Lidhur me këto u rrit edhe më interesi për problemet e kritikës letrare. Shumica dërmuese e poetëve të vegjël u harrua që me brezat që erdhën menjëherë, kurse figurat më të shquara shpejt u afrimuan si klasike të poezisë romake dhe vepra e tyre erdhi gjer në ditët tona me e plotë se ajo e poetëve të kohës republikane.

Interesi të veçantë zgjoi në këtë kohë edhe oratoria, por për këtë degë të artit, që luajti një rol aq të rëndësishëm në periudhën e mëparshme, rendi i ri që me pak i favorshëm. Me vendosjen e perandorisë ligjerata politike e humbi rëndësinë e saj të dikurshme.



## VIRGJILI

Poeti më i madh i periudhës së Augustit, Publ Virgjil Maroni (70-

19 para erës së re) qysh në kohët e lashta u bë objekt le- gjendash. Megjithatë biografët e vjetër kishin mjaft të dhëna të sakta rreth jetës së poetit. Sipas këtyre të dhë- nave, Virgjili rridhte nga shtresat e ulëta të popullsisë së lirë të Italisë së Veriut. Babai i tij me parë zanatçi, më vonë mundi të sigurojë një cope toke rreth qytetit Mon- tava, kur me 15 tetor të vitit 70 para erës së re lindi Vir- gjili. Mësimet e para ai i mori në qytetin pranë Mantoves në Kremone, pastaj në Mediolanum (Milano), që ishte qen- der kulturorë në Italinë e Veriut. Nga fundi i viteve 50- te shkoi në Rome për t'u specializuar në retorike dhe në shkencë. Karriera avokatore, për të cilën përgatiteshin za- konisht nxënësit e rinj të shkollës retorike, nuk i shkoi mbare; Virgjili nuk kishte talent oratorik dhe vetëm një herë doli para gjykatësve, sipas njoftimeve të një bashkë- kohësi të tij poeti fliste ngadale dhe nga mënyra e të fo- lurit "dukej gati si njeri i pamësuar". Përveç kësaj ai ishte shumë i ndrojtur, madje edhe më vonë, kur u bë poet i dëgjuar, sa here dilte përpara publikut kureshtar dhe të interesuar të njëjtte poetin turbullohej. Biografi antik Donati na ka dhënë portretin fizik të Virgjilit. "Shtat- gjatë, me fytyrë fshatari e shëndetlig".

Vitet e rinisë Virgjili i kaoui nën një ndikim të dy- fishtë ideor. Nga njera anë, atë e tërhiqte poezia e neote- rikeve dhe hartonte poezi lirike në stilin "e ri". Në to- ka mjaft shpërthime lirike, meditacione, sulme të mprehta kundër personave të ndryshëm. Virgjili përpiqet t'i afro- het stilit të Katullit, i citon dhe i përpunon vargjet e tij. Vjershat e tij të rinisë u botuan pas vdekjes së poe- tit në një përmbledhje të vogël. Nga ana tjetër, në rininë e tij ndikoi edhe shkolla epikuriane, që ishte përhapur mjaft në atë kohe. Ajo e shtyn Virgjilin të ndahet nga retorika dhe, sipas fjalëve të tij, "ta drejtoje lundren në një skele të lumtur, duke synuar drejt fjalëve të men- gura të Sironit të madh". Nga shkolla e Sironit dhe e Filo- demit kaloi poeti epik dhe tragjik Varij, miku i ngushtë i Virgjilit. Nga kjo shkollë me vonë duket se kaloi dhe Horaci. Predikimet epikuriane për t'u futur në jetën priva- te dhe për t'u kënaqur më pak, lanë gjurme të thellë në tërë

krijimtarinë e mëvonshme të Virgjilit. Me pak e preku veprën e tij ana iluministe e epikurizmit, por, sidoqoftë, Lukreci pas katulit u bë mësuesi i dytë për poetin.

Nga gershetimi i aleksandrizmit "erudit" dhe sensual me idealin e jetes së qete në gjirin e natyrës doli vepra e rëndësishme e Virgjilit "Bukoliket" (rreth viteve 42-39). Siç e tregon vete titulli, poeti përpunoi ato idile baritore me të cilat u mor dhe Teokriti. Përmbledhja poetike baritore e Virgjilit përbëhet nga dhjete ekloge. Poeti romak në poezinë e tij pastprale (baritore), ndjek rrugën poetike të neoterikeve, orientohet nga poezia helenistike, por qëndrimi i tij ndaj tematikes baritore ndryshon mjaft nga ai i Teokritit. Poeti grek i ka paraqitur figurat e barinjve në poezinë e tij me një fare ngjyre ironike, duke treguar epërsinë e kulturës së tij ndaj primitivizmit të barinjve. Ndërsa te Virgjili nuk e shohim atë largësi midis autorit dhe personazheve të tij. Me "Bukoliket", që është hartuar në çastet e luftës së ashpër civile, poeti predikon largimin nga realiteti, në një bote ideale që është e çliruar nga ato vese për të cilat moralistet e fundit të republikës e kritikonin shoqërinë romake. Në veprën e tij "Bukoliket", mjedisin baritor poeti e idealizon, duke e vene përballë botes së egoizmit, të mbushur nga dëshirat për pasuri dhe pushtet. Figurat e barinjve, të cilëve ai u këndon në veprën e tij, mishërojnë idealin e jetes private, kalimin nga republika në perandori. Ata bëhen partizane të regjimit të Oktavian Augustit. Poeti e shikon këtë bote baritore, të cilën e ka idealizuar dhe e ka paraqitur sipas shijeve dhe pikëpamjeve të tij, me simpati të veçanta. Barinjtë në "Bukoliket" paraqiten si njerëz të mësuar, që dinë të flasin dhe të diskutojnë për probleme letrare, për të cilat ata duken të informuar mirë.

Virgjili ka huazuar shumë motive, figura dhe shprehje poetike të Teokritit dhe poetet e tjera helenistike. Ai ka ruajtur deri dhe kornizën poetike, në të cilën ka vendosur figurat dhe mjedisin baritor. Por në trajtimin e materialit të huazuar Virgjili është treguar mjeshtër dhe virtuoz. Ai i ka vizatuar ndjenjat e personazheve të tij me fuqi të madhe emocionale, me patos dramatik.

Që në veprën e tij të parë të dëndësishme Virgjili u tregua poet tendencioz. Në botën baritore ai futi gjerë-

sisht realitetin e gjallë aktual. Si nxitje për këtë u bë një fakt me karakter biografik. Kur ne vitin 41 midis pronave të tjera u konfiskua prona e vogël e Virgjilit për t'ua ndarë ushtarëve të Oktavianit, poeti me ndihmën e shokëve me influencë i fitoi përsëri të drejtat e tij mbi këtë pronë. Për këtë fakt poeti shprehu mirënjohjen e tij ndaj atij që ia ktheu përsëri pronën: në një nga eklogat e " Bukolikëve" një bari plak falenderon një djalosh " të hyjnueshëm" që i kishte kthyer atij copën e tokës në kohën e turbullirave të përgjithshme.

Tendencioziteti politik i poetit u bë edhe më i thellë në eklogen IV, që u bë shumë e njohur. Kjo ekloge i është drejtuar konsullit Asin Polionit, një nga protektorët e Virgjilit dhe frymëzues i poezive të tij baritore. Poeti e fton Muzen baritore " të këndoje për gjëra me të rëndësishme", dhe me një stil të ngritur e të mjegullt prej orakulli profetizon për ardhjen e një epoke të re; kjo epoke është e lidhur me lindjen në vitin 40 të një fëmije, që do të bëhet sundimtar i botës. Ky fëmijë, i vizatuar nga poeti me veti njerëzore dhe hyjnore bashke shënoi fundin e shekullit të hekurt dhe fillimin e shekullit të arte.

Kjo ekloge shkaktoi diskutime të zjarra si në antikitet, ashtu dhe në kohët e reja. Rreth saj u bënë shumë komente. Që në kohët e lashta dolen dy interpretime kryesore: njeri me karakter historik dhe tjetri me karakter mitologjik. Të dyja këto pikëpamje vazhdojnë dhe sot e kësaj dite të kenë partizanet e tyre. Interpretimi i parë thotë se Virgjili ka pasur ndër mend ndonjë fëmijë që, pritej të lindete në ndonjerën prej familjeve të shquara të Romës së asaj kohe. Duke dashur të përcaktojnë konkretisht këtë familje partizanet e interpretimit historik ndahen dhe përmendin emra të ndryshëm; të Oktavianit, të Antonit, madje dhe të Asin Polionit, të cilit i është drejtuar kjo ekloge.

Sipas interpretimit të dytë, ekloga IV i thur lavde rendit të ri në formë profecie mitologjike mbi lindjen e njeriut perendi, i cili do të sillte rilindjen e botës. Komentuesit dhe partizanet e pikëpamjes së dytë mitologjike bënë shumë vërejtje dhe konkluzione, por kjo çështje edhe sot e kësaj dite nuk mund të quhet e zgjidhur përfundimisht. Te krishterët e lashta thoshin se në këtë ekloge është profetizuar ardhja e Krishtit, prandaj ata e ndero-

nin poetin dhe e quanin si njeri të pajisur me urtësi të lartë.

"Bukoliket" e Virgjilit luajtën rol të rëndësishëm në poezinë romake përsa i takon formës. Poeti romak e përpunoi në mënyrë të përsosur heksametrin latin nga ana ritmike dhe sintaktike.

Me Virgjilin vargu latin arriti atë lartësi artistike, që arriti proza nga Ciceroni e këndej.

"Bukoliket" e ngritën Virgjilin në radhën e parë të poetëve romake, kurse gatishmëria për të pranuar rendin e ri politik e afroi atë me qarqet drejtuese të shoqërisë. Ai hyri në rrethin e Mecenatit, domethënë në rrethin e afërm të sunduesit të Italisë, te Oktavianit.

Vepra e dytë e madhe "Gjeorgjiket" ("Mbi bujqësinë"), poeme me karakter didaktik, u është kushtuar Oktavianit dhe Mecenatit. Poeti punoi për të rreth shtate vjet dhe e mbaroi vetëm në vitin 29, pas luftës së Akciumit.

Tema që zgjodhi Virgjili për poemën e tij u përgjigjej prirjeve të poetit dhe ishte tepër aktual. Gështja e riven-dosjes së pronësisë së vogël mbi tokën dhe e tërheqjes së një pjese të masave parazitare të qytetit në punët bujqësore me qëllim që këto të neutralizoheshin politikisht, ishte shtruar disa here në Rome; kurse pas luftërave shkatërrimtare civile kjo gështje u acarua dhe më tepër. Pushteti i ri në këtë gështje u tregua po aq i pafuqishëm sa dhe i pari, kurse problemi mbetej i hapur dhe shqetësonte mendjet e rretheve drejtuese.

"Gjeorgjiket" përbëhen nga katër libra: libri i parë i është kushtuar bujqësisë, i dyti silvikulturës (kulturës së pyjeve) dhe pjesërisht vitikulturës (kulturës së rrushit). Libri i tretë i kushtohet blegtorisë dhe i katërti apikulturës (rritjes së bletës). Virgjili studioi me kujdes literaturën lidhur me këto gështje, por pa i vënë qëllim vetes të japë këshilla praktike për këto probleme. Qëllimi kryesor i poetit ishte të predikonte vlerën morale të punës bujqësore, të paraqiste gëzimet që i jep ajo njeriut. Qëllimi dhe tendencioziteti politik e bënë veprën e Virgjilit të dallohet nga vepra analoge të letërsisë heleenistike, ku zakonisht sundonte një fare erudicioni empirik.

Titullin e poemit (Georgica) Virgjili e mori nga Nikandret Kolofoni. Poeti e quajti këngën e tij "askreike".

për të treguar se rruga e tij kaloi përmes veprës së Hesiodit, që kishte lindur në Askra të Beotisë.

Në eklogat e "Bukolikëve" himnizohej jeta fshatare si një oazë pushimi dhe qetësie shpirtërore, kurse në "Gjeorgjikët" i këndohet dobisë së punës së fshatarit. Ndërsa në "Bukolikët" poeti këndonte:

Gjithçka mund dashuria  
Dhe ne i nënshtrohemi asaj...

ne "Gjeorgjikët" ai këndon:

Gjithçka mund puna...

Poeti tregon se

Vetë Jupiteri, ati i epërm, deshi ta bëjë punën e bujkut të vështirë, ai i pari punoi me mjeshtëri tokën, duke u ndezur me shpresë zemrat njerëzve...

Thurja lavdi rolit të punës e afroi Virgjilin me Hesiodin. Por ndërsa Hesiodi në veprën e tij "Punët dhe ditët" dhe tablo karakteristike të jetës dhe të gjendjes së vështirë shoqërore të fshatarësisë, Virgjili, përkundrazi, e idealizoi dhe e mbështolli me një val të bukur romantik jetën e fshatarit. Në këtë anë poeti i Perandorisë Romake qendron shumë më pas rapsodit të lashtë grek, i cili, ndryshe nga i pari, mundi të shikoje me realisht e më qartë marrëdhëniet shoqërore. Virgjili me të drejtë thekson në veprën e tij në Roma u rrit si fuqi e madhe duke u mbështetur në fshatarësinë e lire, por ai nuk pa kontradiktat e mprehta shoqërore midis fshatarëve dhe latifondistëve, punën e skllëvërve në ekonomine fshatare, mjerimin e fshatarëve të varfër, të shpronësuar plotësisht. Virgjili nuk e zbuloi këtë realitet, jo pse nuk mundi, por sepse nuk dëshoi. Duke dalë si ideolog i perandorisë dhe propagandues i kësaj përmes poezisë, Virgjili me qëllim të caktuar e himnizoi jetën e qete fshatare, idealizoi jetën apolitike, zakonet primitive dhe besimet e lashta të fshatarësisë italiane. Ëndërrimet e epikurianit këtu gërshetohen me qëllime të qarta politike dhe ideologjike duke i thurur

lavde Epikurit dhe Lukrecit, poeti thote:

Të lumtur kanë qenë ata që e kanë ditur shkakun e  
gjerave,  
Ata çdo frikë dhe fat që nuk pyet, të gjitha  
I shkelën me këmbë, - dhe ushtimen madje t'Akeronit.

Ky është një moment interesant në veprën e Virgjilit, i cili miraton filozofin epikurian, që e gjen kuptimin dhe lumturinë e jetës në zbulimin e të fshehtave të natyrës me anën e dijes dhe të arsyes.

Po ashtu si filozofi, i lumtur është dhe fshatari që ruan besimet e lashta, dhe që e arrin pa e ditur lumturinë e tij:

I lumtur është ai që njeh dhe hyjnite fshatare,  
Panin dhe Silvanin plak dhe Nimfat-motra të dashura.

Veprën e tij "Gjeorgjiket" Virgjili u përpoq ta sperkate me grimca filozofike. Ai kishte menduar të shkruante në të ardhmen një epike filozofike mbi natyrën. Kjo enderr që nuk u realizua kurse lindi nga ndikimi i poemës së Lukrecit. Dhe ky ndikim duket qartë edhe në "Gjeorgjiket".

Poeti kishte simpati dhe dashuri të veçante për punën bujqësore. Përshkrimet e frymëzuara idilike të jetës fshatare, të zbukuruar me figura të gjalla mplekseshin me lëndat e shumta që i thureshin Oktavianit. Përmes digresioneve të shumta, ku është përqëndruar krejt ana ideologjike e veprës, poeti i thurte lavde Italisë, natyrës së saj të bukur, fiseve dhe personaliteteve historike. Kjo kishte tendencë të theksuar politike në ato vite kur u shkrua poema, meqenëse Oktaviani kishte mbledhur rreth vetes të gjitha forcat e Italisë në luftë kundër pjesës lindore të perandorisë. Rajtimi i gjakeve dhe vendosja e qetësisë pas luftërave të gjata civile, kthimi i epërsisë së dikurshme të Italisë mbi pjesët e tjera të perandorisë së madhe, të gjitha këto ishin parulla me të cilat Oktavian Augusti tërhoqi në anën e tij një pjesë shumë të madhe të popullsisë së Italisë.

Duke i thurur lavde Oktavianit dhe perandorisë së tij nga pozitë e fshatarit që qëndronte larg politikës dhe që "gëzonte", jetën e heshtur e të "gëzuar" në fshat,

Virgjili në " Gjeorgjiket " e atij s'bën tjetër veç ri-përtëririn edhe një herë qëllimet e tij politike dhe ideologjike, që i shprehu më parë në " Bukoliket". Kjo pozitë tendencioze e poetit gjeti shprehjen e saj të plote artistike në " Eneiden".

Në " Gjeorgjiket " Virgjili premton se do të hartojë një poemë mbi gjestet dhe veprat e Augustit. Edhe perandorit ia kishte qejfi që ndonje poet i madh ta bënte atë hero të epopesë së tij. Nga Virgjili prisnin të shkruante një poemë historike, tradicionale në letërsinë romake ( të tilla siç shkroi Gnej Nevi dhe Kuint Enni), ku te përmendej origjina trojane e fisit të Juleve, ku bënte pjesë edhe vetë Augusti, Virgjili iu vu punës për të trajtuar mitin, legjenten mbi Enean trojan, i cili kishte origjinë "hyjnore" nga ana e së emës, Veneres ( Afroditës).

Augusti e ndoqi me interes dhe dashamirësi punën e Virgjilit rreth fatit të heroit trojan, që do t'i lëshonte rrenjet e tij deri te Augusti. Dhe kjo i pëlqente shumë perandorit.

Miti mbi Enean ishte bërë shumë popullor dhe i njohur në Romë. Qysh në shekullin III u duken pohime zyrtare rreth origjinies së Romës nga Troja. Fiset aristokratike përpiqeshin ta çonin gjenealogjine, origjinën e tyre, te Eneu dhe bashkudhëtarët e tij. Dijetari i njohur romak Varroni i shekullit I shkroi madje një traktat me titull " Familjet trojane". Në mënyrë të veçantë fisi i Juleve e lidhte zanafillen e tij me djalin e Eneas, Askanin. Ata thoshin se emri i dytë i Askanit, II ishte shndërruar pastaj në Jul. Kështu që Julet dilnin paraardhësit e Veneres ( domethënë të Afroditës, nënës së Eneas). Edhe Jul Qezari në kohën e tij nuk ishte kundër të pranonte origjinën e tij prej perendish.

Duke përpunuar mitin mbi Enean, Virgjili shkroi një poemë jo vetëm rreth fillimeve të perandorisë romake, por dhe rreth stërgjyshërve të Augustit.

Poeti ia hyri punës pothuajse menjëherë pas mbarimit të "Gjeorgjikeve". Në vitin 26 ishte bërë tanime e njohur në rrethet letrare se ai ishte duke punuar rreth një poeme të madhe mbi Enean dhe se po përgatiste një epope, si ajo e Homerit. Virgjili e pa se kjo detyrë nuk ishte e lehtë, sepse duhej krijuar një epope në stilin homerik dhe që t'u përgjigjej kërkesave të reja ideologjike. Vështirësi të veçanta lindnin dhe me trajtimin e materialit të

gojëdhënes. Hero qendror i poemës, Enea, ishte një i mërguar, që kishte braktisur atdheun e rrenuar e në flake. Kjo figure kërkonte nga poeti një trajtim të veçantë, plot takt e delikatesë, në mënyrë që ta përlligjte largimin e Eneas nga atdheu e të mos shkaktonte tek lexuesi një qendrim negativ ndaj heroit. Sidoqoftë tema që do të trajtohej ishte shumë interesante, madje kishte dhe karakter aktual: gojëdhana mbi origjinën e Romës nga Troja ishte shumë e përhapur dhe besohej me bindje të plote, sa sa pati dhe mendime të tilla ta transferonin qendren e perandorisë në Lindje. "Madje Jul Cezari në kohën e tij kishte menduar ta rindëronte Trojen dhe ta bënte kryeqytet. "Eneida" duhej ta trajtonte mitin në mënyrë të tillë që të mbështeste të gjitha këto tendenca. Shtjellimi i subjektit kërkonte, gjithashtu, një erudicion të madh, njohje të thellë me materialet mitologjike dhe historike. Por poeti ishte i përgatitur shumë mirë dhe mund t'i kalonte të gjitha vështirësitë.

Sipas njoftimeve të një biografi antik, Virgjili hartoi një plan paraprak të poemës, duke dhënë një përmbajtje të shkurtër në proze e duke e ndarë krejt materialin në 12 libra. Në vitin 19 para erës së re "Eneida" ishte gati në doren e parë. Autori caktoi edhe tre vjet për përpunimin e saj. Por vdekja ia prishi këto plane; duke u kthyer nga një udhëtim nëpër Greqi, Virgjili u sëmur dhe ashtu në gjendje të rëndë e sollën në qytetin Brundisium (Brindizi i sotshëm), ku vdiq me 21 shtator të vitit 19. Para vdekjes dëshoi ta digjte poemën e tij të pambaruar dhe në testament la porosinë që të mos botohej asgjë nga trashëgimia e tij letrare që nuk ishte botuar nga vetë autori. Augusti e kundërshtoi porosinë e poetit dhe ngarkoi shokët e tij që ta botonin "Eneiden". Ashtu siç e kërkonin rregullat antike të botimit të një vepre pas vdekjes, botuesit nuk bënë ndryshime të rëndësishme në poemë. Ajo që nuk ishte përpunuar nga vetë autori mbeti pothuajse ashtu.

Subjekti i "Eneides" ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë tregohen endjet, shtegtimet e Eneës dhe në pjesën e dytë luftërat e tij në Itali. Secila pjesë është e ndarë në gjashtë libra. Gjysma e parë e poemës nga ana tematike i afrohet "Odisesë" dhe gjysma tjetër "Iliades".

Ideja kryesore e "Eneides" është përmbledhur në vargjet që hapin poemën:



Unë këndoja armet dhe burrin, që ...  
i flakur nëpër vise dhe dete...  
vuajtja kaq shumë në luftë...

Nga ky formulim lexuesi antik kuptonte se qëllimi i autorit ishte të bashkonte në një të vetme tematiken e dy poemave homerike.

Poeti tregon se Enea braktisi atdheun, sepse ashtu deshi fati. Autori i referohet fatit jo vetëm për të përli-gjur ikjen e Eneës nga Troja, por edhe për ta bërë fatin fuqi lëvizëse të ngjarjeve, sepse ishte "fati" ai që e shtyn Enean të themeloje:

Qytetin, dhe në Laciun ta sjelle hyjnite  
që nga ze fill fisi i latineve...

Dryshe nga eposi homerik, që futet i tëri në të kalua-rën, të Virgjili miti gjithnjë gërshetohet me të tanish-men dhe vuajtjet e Eneas nuk janë veç një fillim kuptim-plote i asaj madhështie të Romës që përgatiti "fati".

Vuajtjet e Odisesë në shtegtimet e tij ishin shkaktuar nga zemërimi i Poseidonit; ato të Eneas nga "urrejtja e Junones së zemëruar". Armiqësia e Junones (Heres) ndaj trojaneve është një tradite homerike, por Virgjili e pa-suroi atë me një motivacion tendencioz politik: Junona është paraqitur si mbrojtëse e Kartagjenës dhe armike shekullore e romakëve. Edhe nga ana kompozicionale pjesa e parë e "Eneides" i ngjan "Odisesë". Naracioni fillon me shtegtimet e fundit të Eneas, kurse ngjarjet e mëparshme janë vënë në gojën e vete heroit.

Kur Enea me floten e tij të vogël u afrohet brigjeve të Italisë, qëllimit të fundit të udhëtimit të tij të gjatë e plot vuajtje, Junona e zemëruar ngre një stuhë të tmerr-shme, që i flak anijet andej-këndej dhe i shkatërron. Tro- janet, të lodhur e të raskapitur notojnë drejt brigjeve të panjohura.

Ashtu si "Odisea" e Homerit edhe "Eneida" kalon përmes peripecish dhe të papriturash, që e bëjnë subjek-tin interesant dhe u japin vuajtjeve të Eneas më tepër ngjyrë tragjike. Grushtet e rënda të fatit heroit i përba llon me një besim të madh në të ardhmen.

Ndërkaq tregimi ndërpritet nga një skene që ndodh në Olimp: Jupiteri i zbulon Veneres fatin e ardhshëm të Eneas dhe te pinjojeve të tij deri në kohën e Augustit, dhe paralajmëron fuqinë dhe madhështinë e shtetit romak. Me tjtje plani olimpik do të gërshetohet vazhdimisht me atë tokësor dhe heronjtë në veprimet e tyre shpesh do të frymëzohen nga peshpëritjet e perëndive.

Përballë armiqësisë kryeneçe të Junones qëndron dashuria dhe kujdesi i Veneres, nënës së heroit. Fati tani nisi t'i buzëqeshe Eneës dhe bashkudhëtarëve të tij. Tani ata lundrojnë me erera të mbara drejt brigjeve të Kartagjenës që po ndërtohej, Këtë qytet madhështor e kishte themeluar një grua energjike, mbretëreshë Didone, që kishte ikur nga Tiri atëherë kur burrin e saj të dashur Siheun e kishte vrare tradhtisht vëllai i tij Pigmaliioni. Ajo e merr vesh se në shtetin e saj kishin ardhur udhëtarë të larget nga Troja, mjerimet e së cilës i kish dëgjuar tërë bota. Madje edhe tempullin që Didona i kishte ngritur Junonës e kishte zbukuruar me figura të marra nga skena të ndryshme të luftës trojane.

Didona i pret me zemër të hapur trojanët:  
Edhe mua një fat si i juaji më hodhi në shumë mjerime  
e më mundi gjersa gjeta qetësi në këto vise.  
E di ç'është dhimbja, prandaj mundohem t'i ndihmoj  
fatkeqet.

Përshtypje të veçantë i bën asaj fati i Eneas. Në mbrëmje, në gostinë që kishte shtruar për miqtë e largët, duke biseduar me të, ajo " thith në shpirtin e saj dashurinë " dhe i lutet t'i tregojë me hollësi vuajtjet e tij.

Me këtë prelude të dashurisë së Didonës ndaj Eneas mbyllet libri i parë i poemës.

Libri i dytë dhe i tretë zë tregimin e Eneas në gostinë e shtruar për nder të tij dhe të shokëve që i shkojnë pas. Në librin e dytë bëhet fjalë për rënien e Trojës. Virgjili kësaj radhe duhej ta trajtonte nga pozitrat dhe interesat e trojanëve. Tregimi poetik duhej të të tronditëte me skenat e tij tmerruese dhe prekëse rreth vuajtjeve të Trojës, duhet t'ua hiqte grekëve atë aureolë lavdie, me të cilën i kishte kurorëzuar tradita dhe të përlligjte sjelljen dhe mërgimin e heroit të poemës. Libri i dytë fillon me tre-

gimin rreth " kalit të drunjtë". Lufta e gjatë rreth mu-  
reve të Trojës nuk i dha grekëve asnjë fitore. Atëherë  
ata shpiken lojën me " kalin e drunjtë", dhe kështu " i  
mundën" trojanët jo me luftë të ndershme e të hapur, por  
me dredhi. Falltari Laokoon i kishte porositur trojanet  
" t'i kenë frikë grekët edhe kur japin dhurate". Perënditë  
mizore dhe zemërliga për të zhdukur dyshim rreth asaj që  
tha Laokooni e mbytën atë dhe dy fëmijët e tij me gjarpëri-  
njtë gjigandë që u dërguan si dënim gjoja për gënjeshtren  
që kish thënë Laokooni. Trojanët pas këtij ndëshkimi " hyj-  
nor " futën me gëzim dhe me ceremoni kalin e drunjtë në qy-  
tet. Kështu grekët mundën të hyjnë në Trojë. Përshkrimi i  
luftimeve që u bënë nëpër natën e errët dhe të mbarsur me  
trathti ka ngjyra të forta dramatike. Enea mblodhi një një-  
sit të vogël luftëtarësh. Por njësitë u asgjësua. Në lufte  
u vra mbreti plak Priami nga djali mizor i Akilit. Hyj-  
nitë e porositin dhe e detyruan më në fund Enean ta lerë  
qytetin e rrënuar. Ai ngarkoi mbi shpinë babanë e tij Anki-  
sin, që mban në duar perënditë pise ( penatet), të ndërтуara  
në Trojë. Me Enean bashkohen shumë bashkudhëtare dhe të gjit-  
thë së bashku marrin rrugën e mërgimit.

Libri i tretë flet për endjet e Eneas. Heroi shtegton  
nëpër dete e vende të ndryshme duke kaluar rreziqe e vuajt-  
je të mëdha.

Gojëdhëna na e ka paraqitur lundrimin e Eneas si diçka  
që ndodh në të njëjtën kohë me aventurat e Odisesë dhe po-  
thuaj në të njëjtat vende. Virgjili është përpjekur ta tra-  
jtojë materialin në mënyrën e tij. Duke i çuar trojanët  
në ujërat pranë Karibdit dhe Sciles ose tek ishujt e ciklo-  
peve ai nuk i dublon situatat homerike.

Enea e çon tregimin e tij deri në çastin kur mbërrin  
në Sicili, ku i vdes i ati. Duke u nisur nga Sicilia për  
në Itali e ze një stuhi e tmershme.

Libri i katërt është pjesa më e fuqishme e me pateti-  
ke e " Eneides" Ky libër shërben në poemë si një lëndinë  
e bleruar, si një oaz, ku heroit, i lodhur dhe i raskapi-  
tur, gjen prehjen dhe dashurinë.

Mbretëreshës krenare Didona ia mori zemrën tregimi pre-  
kës i Eneas rreth vuajtjeve të tija dhe ra në dashuri me të.  
Por ajo është lidhur me një betim të shenjte: kur ishte  
gjallë i shoqi, ajo i ishte betuar se do t'i qëndronte  
besnike edhe pas vdekjes, dhe tani atë e mundonte ndër gjë-

gjja e vrare. Lufta midis ndjenjës dhe detyrës, fitorja e ndjenjës është akti i parë i tragjedisë.

Didona dhe Enea dalin për gjah. Rasti krijon një situatë shumë të favorshme për shpërthimin e pasionit. Ata i ze shtrëngata në mes të pyllit dhe futen në një shpellë:

Toka dhe Junona që lidh martesat  
japin shenjen, u ndezen zjarret dhe Eteri i  
maleve  
dëshmitar i bashkimit dhe nimfat maje shkëmbi-  
njve nisen të psherëtimë.

në vend të pishtarëve të dasmës dhe brimtare të gëzuara të dasmorëve. Por nuk shkon shumë e vjen katastrofa; hyjnitë i kujtojnë Eneas misionin që i ka ngarkuar ffati dhe ai bëhet gati të niset nga Kartagjena. Zgjidhjen tragjike të dashurisë Virgjili e ka përpunuar me kujdes të veçantë. Poeti është përpjekur të tregojë vuajtjet gjithnjë e më të mëdha të Didones, e cila njëkohësisht kërkon të ruajë edhe dinjitetin e saj si grua dhe mbretëreshë. Ajo nis të provoje madje edhe një fare urrejtje për atë që po bëhet gati të largohet nga Kartagjena. Por dashuria është për të më e fortë se çdo ndjenje tjetër; ajo i dërgon njerëz Eneas duke e lutur ta shtyjë për më tutje nisjen e tij. Por kur sheh anijet trojane të dalin në detin e hapur atë e pushton për herë të fundit ndjenja e hakmarrjes së tërbuar dhe përmes mallkimeve rrenqethese për Eneas dhe pasardhësit e tij ajo profetizon armiqësinë e papajtueshme midis popujve të tyre dhe lindjen e një hakmarrësi të ardhshëm. Këtu Virgjili bën aluzion për Hanibalin. Pastaj Didona, mbretëresha dhe themeluesja e Kartagjenes, duke qenë plotësisht e vetëdijshme për madhësitë e vepres së saj vret veten me një kamë, që ia pat dhuruar dikur Enea.

Kështu mbaron libri i katërt, që ka një kontrast të fuqishëm midis fillimit të lumtur dhe fundit tragjik.

Libri i peste duket sikur na kujton Homerin në disa episode. Enea, si niset nga Kartagjena, vjen edhe një herë në Sicili, ku organizon lodra me rastin e përvjetorit të parë të vdekjes së babait të tij Ankisit. Kjo na kujton këngën e rrethetete të "Iliades", ku flitet për lodrat që organizohen me rastin e varrimit të Patroklit. Kjo ishte diçka që kish karakter aktual dhe që i përgjigjej poli-

'tikës së Augustit, i cili kërkonte për qëllime demagogjike të ringjallte përsëri në Romë zakonet e vjetra.

Libri i gjashtë i " Eneides" përgatiti atmosferën e luftërave të ardhshme midis Eneës dhe fiseve të ndryshme italice. Duke lundruar gjatë brigjeve të Italisë, Enea vendoset në qytetin Kum. Këtu ndodhej orakulli i njohur Apoloni, kurse pak më tutje, sipas besimeve të vjetra, ishte hyrja që çonte në botën tjetër. Profeteshja Sibila paraflot për luftën që e pret Enean në Laciun. Pastaj ajo shoqëron atë në botën e të vdekurve që të takohet me të atin. Edhe këtu Virgjili duket sikur hyn në gare me Homerin, i cili po ashtu ka treguar zbritjen e Odisesë në botën tjetër për t'u takuar me të atin, Laertin. Këto dhe burime të tjera letrare e biblike e frymëzuan më vonë Dante Aligierin të përfytyronte udhëtimin e tij fantastik në botën tjetër.

Ankisi i tregon Eneës burrat e ardhshëm të shtetit romak, që janë mbartës të lavdisë luftarake dhe qytetare. Në këtë lavdi romake shikonin epërsinë e tyre ndaj kulturës greke dhe intelektualizmit grek.

Pas shtegtimeve, që zenë ta gjashtë librat e pjesës së parë të " Eneides" vijjnë luftërat. Këtyre u është kushtuar pjesa e dytë e poemës, libri i shtatë deri në librin e dymbëdhjetë.

Pjesa e dytë " " Eneides" është hartuar mbi një bazë të gjerë gojëdhënash që flasin mbi lashtësinë e fiseve italice. Kjo nga fryma e saj i ngjet " Iliades". Enea bëhet një fare Akili.

Në këtë pjesë tendenca ideologjike sa vete e bëhet më e qarte. Poeti orvaqet të zhduke ndryshimin midis trojanëve dhe italiceve. Prandaj mbreti, i laciunimit, Latini, kur merr vesh se kishte ardhur Enea, që ishte paracaktuar nga orakulli si burri i bijes së tij Lavana, i pret trojanët miqësisht. Nëse u prish kjo marrëveshje, fajtorë për këtë është Junona, që ve në lëvizje forcat e ferrit. Furia Alekto, e frymëzuar nga Junona, ndez me armiqësi kundër trojaneve mbretin e fisit të rutuleve, Turnin që ishte fejuar me Lavinian. Grate latine, të frymëzuara gjithashtu nga furia Alekto, në një ekstaze çmendurie kërkojnë lufte kundër trojanëve. Në krye të tyre është mbretëresha Amata, që mbron Turnin. Kurse mbreti plak Latini hiset menjandë dhe nuk përzihet.

Libri i shtatë mbaron me një enumeracion fisesh e prijë-

šash që hyjnë në lufte kundër Eneas. Kjo na kujton këngën e dytë të "Iliades" ku poeti bën të parakalojnë para syve të lexuesit aleatet e grekeve dhe të trojaneve, anijet, pajimet luftarake e çdo gjë që e kanë sjellë me vete në murret e Trojës. Midis tyre shquajnë Mezenti me të birin Lavsin, i dëbuar nga Etruria dhe vajza e re Kamila, prijëse e kalorësisë së volseve.

Libri i tetë hapet me disa tablo idilike nga jeta e popullsive shumë të lashta, që banojnë në trojet e Romës së ardhshme. Këtu sundon plaku grek Evandri nga Arkadia, që kalon një jetë të thjeshtë e të varfër. Këtij i drejtohet Enea për t'i kërkuar ndihmë. Dhe Evandri i jep djalin e tij Palantin me një njësi të vogël luftëtaresh. Ai e keshillon Enean t'u drejtohet etruskeve për të marrë një ndihmë më të mirë. Në këtë këngë Virgjili vizaton fillimet e Romës dhe bën aluzion për madhësitinë e ardhshme të saj. Me kërkesën e Venerës, Vullkani (tek greket Hefesti) përgatiti për Enean armë dhe e zbukuron mburojen me skena, që paraqesin ngjarjet që do të vijnë që nga ulkonja që ushqeu themeluesit e Romës, deri në betejën e Akeiumit, dhe fitoren e Augustit. Edhe kjo tablo na kujton këngën e tetëmbëdhjetë të "Iliades", ku flitet edhe për përgatitjen e armëve të Akilit.

Në librin e nëntë shohim të flakërojnë armet në luftime të rrepta, ku tregojnë trimërinë e tyre prijësit nga të dhe lavdi luftarake, por Enea qëndron më lart nga ata. Përballë trimërisë bujare dhe këmbëngulëse të Eneës qëndron e atij që i "urrente zotat" egërsisht. Palanti dhe Lavsi janë dhënë si të rinj ideale. Në fillim nismen e luftës e kanë italiket, pastaj ajo dalëngadalë kalon në anën e trojanëve. Në mungesë të Eneas, Turni rrethon kampin trojan. Një nga episodet me të bukura të librit të nëntë është shpërthimi nga rrethimi i dy të rinjve trojane, Nisit dhe Euriali, që shkojnë të lajmërojnë Enean. Përmes figurave të këtyre dy të rinjve Virgjili ka shprehur idealet e etikës së lashtë. Në ato dy figura është mishëruar etja djaloshare për lavdi, miqësia dhe heroizmi djaloshar. Në vepren dhe vdekjen e tyre poeti shikon kuptimin e jetes. Euriali vritet, sepse nuk deshë të ndahet nga shoku i tij i nisur për të kryer një detyrë të rrezikshme. Nisi, i cili kalon tanime rreziqet me sukses kthehet përsëri nga rruga për të

shpëtuar nga rreziku shokun e tij dhe vritet. Kjo gjë si-  
gurisht e pengoi Nisin të kryente misionin e tij, por poeti  
ka dashur të tregojë me këtë se për njeriun e botës antike  
miqësia qëndronte në një radhe me qdo lloj detyrimi tjetër.

Në librin e dhjetë tregohet për kthimin e Eneas në  
kamp dhe për fillimin e një beteje të ashpër, në të cilën  
Palanti vritet nga Turni dhe Lavsi dhe Mezanti nga Enea.  
Më tutje tregohet për varrimin e Palantit dhe për trimërinë  
e rrëmbyer të Turnit.

Në librin e njëmbëdhjetë flitet për trimërinë dhe vdek-  
ken e Kamiles.

Libri i dymbëdhjetë dhe i fundit na tregon dyluftimin  
midis Eneas dhe Turit, që duhet ta përcaktojë fundin e luftës  
dhe fitoren. Konflikti olimpik zgjidhet me në fund. Poeti  
gjen rastin ta thellojë dhe më tepër tendenciozitetin e tij  
politik duke krijuar një situatë të tillë: Junona heq dorë  
nga urrejtja për Enean, me kusht që trojanët të përzihen  
dhe të shkrihen me latinët, të marrin gjuhën dhe zakonet  
latine.

Laciumi të rrojë në shekuj dhe fisi i mbretërve  
albanë.

Vyrtyti italik për jetë e forcofte degën romake.  
Troja mbaroi, bëj që dhe emri i Trojës të shuhet.  
i thotë ajo Jupiterit dhe merr pëlqimin e tij. Skena e dy-  
luftimit është ndërtuar sipas modelit të dyluftimit në mes  
të Akilit dhe të Hektorit, me shumë detale të ngjashme,  
deri të kandari që mban Jupiteri.

Pas një beteje të ashpër e të lodhshme Turni mundet.  
Eneas u vjen keq e don të mishërojë, por në shpatullën e  
tij dallon rripin e mikut të tij të ngushtë Palantit, dhe  
është si Akili që hakmerret për Patrokilin, ai i ngul shpa-  
ten kundërshtarit në kraharor.

Pozita botëkuptimore që ze Virgjili në kohën e tij për-  
shkon tërë strukturën e poemës, tërë mendimet dhe figurat  
artistike. Në përputhje të plotë me politiken ideologjike  
të Augustit "Eneida" lidhëzohet lashtësinë e Romës dhe të  
mbarë Italisë, zakonet dhe besimet e tyre. Kjo gjë përcak-  
toi dhe zgjedhjen e temës dhe mënyrën e trajtimit të saj.

Sipas Virgjilit dhe gjithë bashkëkohësve të tij, rreni-  
mi i Trojes dhe ardhja e Eneas në Itali ishin fakte histo-  
rike. Duke hequr dorë nga eposi mbi ngjarjet e kohës së

tij, poeti krijoi një poemë rreth së kaluarës, duke e dhënë atë me ngjyra të idealizuara. Idealizimi i lashtësisë vihat re dhe në metoden me të cilën poeti karakterizon heronjtë e poemës. Kujdes të veçantë i ka kushtuar Virgjili heroit kryesor të veprës, Eneas, i cili mishëron idealin e "virtytit" romak, siç paraqitet ky nga ideologët e perandorisë në kohën kur kjo ishte në ngritje. Enea është veçshur me cilësitë pozitive të njeriut "të urtë", sipas filozofisë stoike: me arsyetim, bujari dhe trimëri.

Ndryshe nga heronjtë homerike, Enea është më pak aktiv në jetë. Atë e "udhëheq fati", dhe çdo gjë e rëndësishme që ndërmerr ai, mbaron sipas vullnetit të perëndive dhe jo sipas bindjeve të tij personale. Ky lloj pasivitet është cilësi e re e "virtytit" romak, e trumbetuar kaq shumë për qëllime politike dhe social në kohën e Augustit. Ideja e nënshtrimit të vullnetshëm fatit, e dale nga filozofia stoike, gjen shprehje të plotë artistike në veprën e poetit të Perandorisë Romake.

Të shkojmë andej nga na drejton fati, gjithnjë andej,  
Kur s'është e mundur te mundim çdo fat, atëherë mundim ta durojmë.

Duke iu nënshtruar fatit Enea nuk mundet:

Ta kalojë jetën dhe t'i bëjë punet ashtu si do ai.

Ndryshe nga heronjtë e Homerit, forca lëvizëse e të cilit nuk është kaq e qartë, Enea është e vetëdijshme për detyrën dhe misionin historik që i ka ngarkuar atij fati. Misioni i tij lidhet me fatin e brezëve të ardhshme. Kështu tabloja e lashtësisë që paraqit Virgjili në poemën e tij përshkohet fund e krye nga idetë e kohës së tij. Vetë Roma është dhënë në perspektiven e së ardhmes. Qysh në "Gjeorgjiket" e tij Virgjili i thuri lavde Italisë, si vend i paqes dhe i mirëqënies. Në "Eneiden" kjo lavdi pasurohet me nota të reja; Italia paraqitet si territori qendror i shtetit romak. Ndërsa "Analet" e Kuint Ennit ishin poema e polisit romak. "Eneida" është poema e Italisë. Patriotizmi italik, që i kaloi kufijtë e ngushtë të organizimit fisnor dhe të polisit, i dha "Eneides" një ton të ri, që ishte i panjohur për epusin grek. Është kjo një arsye më tepër që i shtyu poetet e klasicizmit evropian t'i shkruajnë poemat "nacionale" duke pasur si model "Eneiden".



" Qetësia " e eposit homerik, përshkrimi i hollësishëm i anëve të jashtme është i huaj për Virgjilin . Bota e jashtme nuk bëhet qëllim në vetvete . Ajo i intereson poetit vetëm si nxitëse e fantazisë dhe e emocioneve . Toni kryesor i " Eneides " është patetika e ndjenjave të larta . Heronjtë e Virgjilit paraqiten në shumicën e rasteve të tronditur, të emociounuar . Bota e tyre e brendshme shpesh zbulohet përmes fjalëve dhe monologëve të ngjeshur e të fuqishëm .

" Eneida " në tërësinë e saj ka frymë liriko-dramatike dhe figura stilistike që kanë për qëllim ta tronditin, ta prekin lexuesin .

" Eneida " ka thurje interesante e njëkohësisht mjaft të qartë nga ana kompozicionale . Poema përbëhet nga libra të ndryshëm dhe çdo liber paraqet një terësi dramatike, me thurje, peripeci dhe finale . Tregimi poetik shtrihet si një zinxhir i gjatë, me hallka që lidhen nga një unitet veprimesh dhe nga prirja e përgjithshme ideore . Në poemë ka përshkrime të gjalla që të rrëmbejnë, si ai i detyrës qytetare, i heroizmit, i guximit, i miqësisë ( episodi i Nisit dhe i Eurialit ), i dashurisë prindërore ( vdekja e Priamit ) . Poema dallohet për bukurinë e shumë skenave të dhëna me forcë dramatike, për bukurinë e peizazhit dhe të pasioneve të fuqishme ( Didona ) .

" Eneida " është shkruar me një ton të ngritur solemn . Autori është përpjekur të mënjanojë çdo gjë që atij i duket " e ulet " dhe " banale " . Kjo është një arsye tjetër që i ka shtyrë përfaqësuesit e klasicizmit evropian ta quajnë " Eneiden " vepër të përsosur dhe model unik për t' u imituar .

Një mori motivesh Virgjili i ka marrë nga Homeri, madje ka marrë situata dhe skema të tera deri dhe shprehje, megjithatë " Eneida " ndryshon shumë nga poema e tij . Ndryshimi qendron në frymën e përgjithshme, në prirjen idealizuese dhe në tendenciozitetin e theksuar që ka " Eneida " .

Po t' i hedhim një sy krijimtarisë letrare të Virgjilit do të vërejmë se poeti ndoqi një rrugë interesante duke kaluar nga Teokriti te Hesiodi, nga Hesiodi te Homeri .

" Eneida " është monumenti më i rëndësishëm i klasicizmit të kohës së Augustit dhe nga ana e formës ajo është një nga veprat më të bukura të antikitetit . Stili i ngjeshur, i saktë, gjuha e pasur në shprehje e figura, vargu i rrjedhshëm dhe tingëllues, të gjitha këto i japin veprës një shprehje të fortë poetike . Stili i Virgjilit qendron larg kompozitetit dhe lulkave të stilit aziatik, po ashtu dhe thjeshtësi-

së së shtenë e artificiale te stilit atikist.

Të rehat që solli Virgjili në poezinë romake u vlerësuan në mënyra të ndryshme nga bashkëkohësit e tij, por pas pak kohe ato gjeten pëlqimin e të gjithëve. Virgjili u bë poeti klasik dhe krejt letërsia e mëvonshme romake u mbështet gjithmonë tek ai. Ai u bë autori kryesor në shkollën romake, vepra e tij shërbente për mësimin e gjuhës dhe te stilit.

Virgjili është një nga autorët e paktë romakë, veprat e të cilëve janë përkthyer në gjuhën greke. Emër të madh ai gëzoi edhe më vonë në botën kristiale. Në këtë anë një rol të veçantë luajti ekloga e katërt, e cila, siç u tha dhe më lart, gjeti dy interpretime. Poeti, që kishte profetizuar gjoja rreth ardhjes së Krishtit mbahej nga kristianizmi si mbartes i urtësisë dhe i diturisë hyjnore.

Virgjili me veprën e tij ushtroi ndikim të madh edhe në kohën e mesme, kur u hartuan epopetë e mëdha në gjuhët kombëtare. Atë e mbajtën gjithnjë si poet model dhe mbartes të urtësisë hyjnore. Dantja e zgjodhi Virgjilin si mësues dhe udhëheqës në botën e përtejme.

Edhe më vonë, në epokën e Rilindjes, të klasicizmit, dhe në shekullin XVIII Virgjili gëzoi famë të madhe. Në shekullin XIX, kur u zgjua interesi për krijimtarinë poetike popullore të kombeve të ndryshme, kur dijetarë të ndryshëm shkunden nga pluhuri i rëndë i shekujve "Iliaden" dhe zbuluan në të bukuri të pashtershme të gjenisë popullore lavdia e "Eneides" filloi të tronditej. Me gjithë luhatjet e shijeve letrare, "Eneida" mbetet si një nga veprat me madhështore që ka krijuar gjënia njerëzore.

## HORACI

Figurë e shquar në letërsinë romake është edhe poeti Kuint Horac, Flaku (65 - 8 para erës së re).

Veprimtaria poetike e Horacit u zhvillua në një rrugë pak a shumë të ndryshme nga ajo e Virgjilit, qoftë nga tendenca e saj ideopolitike, qoftë edhe nga forma e stilit.

Horaci lindi në Venuze, krahina e Puljes në Jug të Italisë. Babai i tij dikur kishte qene skllav, por fitoi lirinë dhe mblodhi një fare pasurie. Nga pikëpamja ligjore fëmijët që lindnin nga skllavë të liruar ishin njëlloj si të gjithë qytetarët e tjerë, por origjina prej skllavi lin-

te hijen e saj, që zhdukej vetëm në brezin tjetër. Të gjitha këto rrethana në jetën e Horacit janë gjurme edhe në krijimin letrar të poetit.

I ati beri shumë sakrifica për t'i dhënë të birit arsimin e duhur dhe për ta ngritur atë në rrethet e larta të shoqërisë.

Horaci shkoi në Romë, që kur ishte i vogël dhe aty ai i kaloi të gjitha shkallët e arsimit të athershëm, që nga arsimi fillor, që kishte si bazë "Odisenë latine" të Liv Andronikut e deri në mësimin e filozofisë në Athinë. Nga të gjitha rrymat filozofike me tepër në mendimet e poetit ndikoi epikurizmi, që ishte përhapur shumë në atë kohë.

Mësimet filozofike të Horacit u ndërprejnë nga lufta civile, që shpërtheu me force pas vrasjes së Cezarit në vitin 44 para erës së re. Në atë kohë në Athinë erdhi Brutit, i cili mbledhi partizanë për mbrojtjen e Republikës kundër armiqve të tij politike. Horaci u fut në ushtrinë e Brutit, dhe u ngarkua me detyrën e tributit ushtarak, si komandant legjion, gjë që ishte deri diku jo e zakonshme për birin e një skllavi të liruar.

Ushtria e Brutit u kthye keq në luftën e Filipese dhe u tërhoq. Pas shumë vjetesh Horaci e kujton atë situatë tragjike dhe komike, kur edhe ai si gjithë të tjerët ua dha këmbëve. Këto kujtime ai i vesh me petkun poetik, si reminescence e poezisë së Arkilokut, që shkroi në kohën e tij për mburojen e humbur.

Me ty, Filipea, provuan në ikjen  
e shpejtë, duke hedhur tutje mburojen  
kur na la trimëria e guximi, fatit  
me trup iu nënshtrua ushtari....

Pas thyerjes që pësoi ushtria e Brutit, Horaci u kthye në Itali, duke përfituar nga amnistia që u shpall për partizanet e Brutit. Por, siç e thotë edhe vetë, ai u kthye "me krähë të prera".

Ndryshe nga shumë shkrimtarë dhe poete, Horaci që në fillim të krijimtarisë së tij letrare doli me një program të qartë estetik. Ai luftoi gjithnjë për një poezi me përmbajtje dhe për një formë të lartë artistike. Horaci ishte kundër neoterikeve dhe poezisë së tyre pa ide, po ashtu dhe kundër atyre që gjunjëzoheshin përpara poetëve të la-

shtë të Romës. Për Horacin, modelet më të mira që ka ndjekur janë veprat e klasikëve grekë. Ky program letrar pajtohej plotësisht me lëvizjen klasikiste që kryesohej nga poetet Vari dhe Virgjili. Madje këta u interesuan për talentin e poetit të ri dhe ia rekomanduan Mecenatit, që e bëri Horacin një nga njerëzit më të afërm të tij dhe pastaj edhe pronar të një qifliku në malet Sabine. Përmes Mecenatit Horaci u fuq dhe në rrethin e Augustit. Po poeti u përpoq të rrinte sa më larg pallatit, duke pëlqyer me shumë të jetoje në pronën e tij të vogël se sa në Romë. Propozimin për t'u bërë sekretar i perandorit ai nuk e pranoi.

Vepra e parë poetike e Horacit është një përmbledhje e vogël me vjersha që njihet me emrin "Epode". Këto janë hartime poetike me karakter polemizues që na kujtojnë shumë jambet e mprehta të klasikut grek, Arkilokut. Vete poeti mendon se nga Arkiloku ka marrë frymën e zjarrte dhe formën. Këtë e shpreh në një nga mesazhet drejtuar Mecenatit:

I pari une jambet e Parosit<sup>1)</sup>  
Ia dhurova laciimit. Nga Arkiloku vetëm masen  
E vargut edhe pasionin mora une, jo temat e tij  
As edhe fjalët që sulmuan Likambin.

Në të vërtetë këto epode nga Arkiloku kanë vetëm formën metrike dhe tonin agresiv që gërshetohet me momentin didaktik. Poeti duket se ka shfrytëzuar trashëgimine letrare të të gjitha epokave, duke krijuar një vepër të veten origjinale.

Ndryshe nga Arkiloku, Horaci godet me satiren e tij jo armiqtë personalë, por ata që janë të rrezikshëm në përgjithësi për shoqërinë. Poeti qëndron mbi subjektivizmin e neoterikeve. Kushtet politike të perandorisë nuk ishin të përshtatshme për një poezi të mprehtë qytetare dhe as për sulme kundër personave të shquar.

Në epodin e shtatë Horaci na del me proteste të ashpër kundër luftërave civile që s'kanë të mbaruar. Në ato vite kur Virgjili profetizonte për lindjen e një fëmije, me të cilin do të fillonte "shekulli i artë". Horaci për kundrazi tregohet shumë pesimist. Perspektiven e shoqëri-

1) Ishulli Paros, ku kishte lindur Arkiloku.

së e shikon të errët dhe lumturinë njerëzore e shikon jo në Itali, por diku larg, në "ca ishuj". Si pararendes i lashtë i Rusoit dhe i Bajronit, poeti romak predikon largimin nga Roma dhe arratisjen romantike në ishuj të lumtur, utopikë.

Në kohe Horaci hoqi dorë nga çdo opozite kundër rendit në fuqi. Ai tani i kufizon sulmet e tij jambografike kundër gjerave shumë pak të rëndësishme: ai thumbon lajkataret, arriviset etj. Vetëm lufta kundër Antonit e frymëzoi përsëri poetin të shkruajë vjersha politike, në të cilat për herë të parë duket emri i Cezarit.

Po në vitet 30 Horaci shkroi dhe dy vëllime me satira. Në to duket prirja për një pajtim, megjithëse të ngadalshëm, me rendin e ri. Poeti merret me probleme të etikës dhe të sjelljes së individit në shoqëri. Në frymën e doktrinës së epikurit, poeti tani e shikon jetën si filozof që është gati të pajtohet me sistemin e ri politik, i cili i dha fund luftës civile dhe "krijoi kushte të mira" për t'iu kushtuar prirjeve personale dhe për t'u përsosur moralisht.

Sipas Horacit, lumturia qendron në "mesin e arte" ("aurea mediocritas"). Kjo shprehje e krijuar prej tij, është si të thuash, sinteza e filozofisë që predikon të kënaqurit me pak në jetë. Të kënaqesh me pak, sipaz Horacit, do të thotë të ruash pavarësinë e shpirtit, të sundosh mbi pasionat, të gëzosh i qetë e i moderuar të mirat e kësaj jete. Ndikimi i epikurizmit dhe i stoicizmit këtu duket hapur.

Kjo filozofi pa dashur të çon në nënshtrim, në të kënaqurit me atë që ke dhe frenon masat e shtypura dhe të shfrytëzuara për luftën për të drejtat e tyre.

Me këtë filozofi Horaci deshi të ruajë pavarësinë dhe lirinë personale të tij. Kjo i shërbeu atij si mjet për të kapërcyer pasionet dhe dëshirat dhe për t'u ngritur lart në shoqëri e për të pasur më tepër. Lumturia, sipas poetit, qendron në pasurinë e mendjes dhe të shpirtit dhe jo në atë materiale. Prandaj me satirën e tij ai sulmon të gjitha ato që i quan rruge të rrejshme për të arritur lumturinë: interesin, etjen për pasuri dhe lavdi, cmirën etj.

Interes të veçantë nga pikëpamja artistike paraqesin disa satira në të cilat si flet për vetveten, për shijet dhe dëshirat e tij. Atij nuk i vjen rende të kuptojë origjinën e tij "të ulët", përkundrazi e kujton me krenari baba-

në e tij skllav të liruar që ishte kujdesur me sa kishte mundur për zhvillimin mendor dhe moral të të birit. Po me atë krenari flet ai edhe për bindjet e tij të dikurshme republikane.

Horaci përpiqet t'i japë satires së tij frymë objektiviteti. Nga e përgjithshmja ai kërkon të arrijë në të veçantën, dhe nga e veçanta në të përgjithshmen e paanshme, në të verteten, qoftë kjo edhe e hidhur. Kështu, duke gjykuar veset e të tjerëve ai nuk i fshihet të metat e tij dhe i thimbon me ironi gjykatësit e rrepte që nuk shohin trashëni në sytë e tyre.

Dy mije vjet më parë në poezinë e Horacit tingëllon motivi naimian " larg qytetit, rrëmujës dhe rremetit" kur thotë:

Ja dëshirat e mija ç'kanë qenë:

Një are e vogël, kopshti, dhe pranë shtëpisë  
Një burim që gurgullon gjithnjë, edhe me tutje pylli  
Me shumë e më mirë se kaq me dhanë hyjt e pavdekshëm.  
Me tepër s'u kërkoj, veç te m'i ruajnë këto që kam...

Fryma e qendrimit epikuriaj ndaj jetës pershkon edhe përmbledhjen e dytë të satirave horaciane. Mendimet shpërndahen në formë dialogu, që poeti e ve në gojën e personave të tjerë. Poeri vete qendron në pozitën e dëgjuesit pasiv. Tri nga këto satira u janë kushtuar gështjeve letrare. Poeti polemizon me ata njerëz që e kishin kritikuar pse kishte përdorur disa emra personash për të ilustruar të metat njerëzore. Nga ana tjetër rrethet letrare kishin shprehur pakënaqësinë nga qe ai nuk merrte pjesë në recitimet publike dhe krijonte me ngadalsi shumë të madhe. Horaci mbron të drejtën e satirikut për të demaskuar lirisht veset e shoqërisë. Këndeje gjen shkas poeti të shpallë disa nga parimet e programit të tij, estetik, që do të shpërndahet gjerësisht në veprën e tij të mëvonshme. "Arti poetik". Poeti shfaq mendimin se satira dhe komedia nuk hyjnë në sferën e poezisë së lartë, por i afrohen me shumë stilit të prozës. Këtë ndryshim poeti nuk e bën për të treguar se proza qendron me ulet dhe është më e lehtë se poezia. Ai thotë se Muza e prozës kërkon artin e saj të veçantë, se poeti duhet të gërshetojë talentin e tij me cilësi oratorike, me ngjeshjen, mendjemprehtësinë dhe me ironi të holla. Për të ilus-

truar mendimet e tij Horaci sjell si shembull të kundërt Lucilin i cili nuk i plotësonte këto kërkesa. Ky poet i lashte romak nga që kishte lehtësi shumë të madhe në të shkruar, hartonte me shpejtësi të çuditshme vargje që vuanin nga fjalët e shumta dhe nga mungesa e përpunimit stilistik të tyre.

Ai e quante për pune të madhe  
Të diktonte dyqind vargje njeheresh,  
Duke ndenjurr mbi një këmbë. Ai rridhte  
Si një përrua i turbullt.

Si modele për të mësuar artin e të shkruarit Horaci rekomandonte poetet klasike greke. Por, për të arritur atje ku duhej, kërkohej një pune e lodhshme dhe e vazhdueshme për të lëmuar stilin, vargun. Në një nga vjershat e tij poeti i sintetizon këto mendime duke thënë: "Ktheje stilin sa më shpesh" (Stili ishte një lloj shufre, me të cilën shkruhej mbi një pllakë të lyer me dylle. Ana tjetër e shufrës, që nuk ishte me maje, shërbente për të fshirë çishte shkruar. Nga ky mjet kemi sot fjalën stil).

Periudha e parë e krijimtarisë letrare të Horacit u mbyll aty nga viti 30. "Epodet" she dy përmbledhjet me satira, që u botuan gjatë kësaj periudhe i siguruan poetit një emër të ndëruar në letërsinë e periudhës perandorake.

Në vitin 23 para erës së re Horaci nxori tre libra me poezi "Carmina" (Këngë). Komentuesit antikë i quajtën edhe me termin greqisht "Ode". Dhe ky emërtim përdoret me shumë edhe në literaturën e sotme rreth Horacit.

Në këto vjersha, me të cilat hapet periudha e dytë e krijimtarisë poetike të Horacit, gjejmë në përgjithësi po atë frymë filozofike dhe etike që karakterizojnë në tërësinë e tij botëkuptimin e poetit. Tematika e vjershave është shumë e larmishme. Vargjet politike dhe mendimet filozofike përzihen me motivet e dashurisë, me ato të gostisë, të miqësisë, me nota përqeshëse e demaskuese. Vjershat në përgjithësi i përshkon një frymë didaktike. Dhe kjo lidhet ngushtë me programin estetik të poetit, i cili kërkon poezi me ide dhe përmbajtje. Me një qëndrim meditativ prej filozofi, Horaci trajton probleme që lidhen kryesisht me problemin e madh të lumturisë, që poeti e çiku edhe në

veprën e tij të mëparshme. Si epikurian i vërtetë, Horaci shikon rreth e rrotull dhe vëren se koha rrjedh me shpejtësi të çuditshme, stinet e vitit pasojnë njera-tjetrën, hëna e vjetër ikën për të dalë hëna e re, lulet vyshken e lulëzojnë përsëri. Të gjitha këto i kujtojnë poetit jeten e shkurtër të njeriut. Ai i shikon se si vdekja e zbehte nuk kursen asgjë. Ajo troket njëlloj si në kasollen e të varfrit, ashtu edhe në pallatin e të pasurit. Këndeji Horaci nxjerr si konkluzion:

Kape ditën e sotme, gëzoje  
Dhe sa më pak i beso ditës së nesërme.

Deviza horaciane "Carpe diem" (Kape ditën) u bë si lajtmotiv e frymëzoi poete, si Omar Khajami, Ronsari e të tjerë.

Ku e gjen Horaci lumturinë? Sipas poetit, njeri me të vërtetë i lumtur është ai që ruan qetësinë e shpirtit, që mban një mase në lumturinë e tij dhe që nuk thyhet në fatkeqësi dhe në situata të tjera të vështira, por Horaci nuk e mohon se dhe vera, gostia, dashuria i japin gëzim njeriut.

Etja për pasuri dhe dëshira për lavdi e nderime janë të kota. Pozita e lartë fsheh në vetvete rreziqe:

Era shkund me shpesh lisat vigane,

.....

Malet e lartë me shpesh tërheqin goditjet e rrufe-së.

Poeti në përgjithësi nuk e mohon pasurinë. Ai thotë se pasuria është e mirë atëherë kur njeriu di ta përdorë atë; por me shtimin e pasurisë zakonisht shtohen dhe telashet e lakmia. "Bën një gjumë të qetë njeriu që ka një pasuri të vogël".

Nga të gjitha këto, edhe një here Horaci duket sikur kërkon të nenvizojë idenë se burimi i lumturisë qëndron në "mesin e artë", në kufizimin e dëshirave. Si ideal të mirëqënies njerëzore. Horaci vizaton jeten e tij të qetë në pronën e tij në malet Sabine.

Motivin e dashurisë dhe të verës Horaci e trajton ndry-



she nga poetet e rinj romakë ( neoteriket). Lasioni i dashtë-  
risë tek ky paraqitet si vegim, dhe grate, të cilave u ka  
kënduar, nuk kanë vija të theksuara individuale. Emocionin  
e forte të dashurisë ai e ka dhënë përmes personave të tje-  
rë. Ai përshkruan shqetësimet dhe stuhitë që e presin adhu-  
ruesin e pamësuar të bukuroshes kapriçioze, tregon djaloshin  
e shendoshë, që ofilitet shpirtërisht dhe fizikisht nga  
zjarri i dashurisë. Poeti u tërheq vemendjen të rinjve të  
mos lëshohen në dëfrimet mekatore të Veneres, që bashkon  
njerëzit, te cilët nuk i përshtaten njeri-tjetrit as nga  
pamja e jashtme dhe as nga cilësitë shpirtërore.

Për poetin epikurian rëndësi të veçantë ka miqësia.  
Vjershat në këtë temë shquajnë për ndjenjën e tyre të the-  
llë dhe ngjyrën intime. Në këtë stil është shkruar poezia elegante  
kushtuar Pompej Varit, bashkëpunëtorit të poetit në ushtri-  
në republikane të Brutit, me rastin e kthimit të tij në  
Romë kur u shpall amnistia. Një radhe odeshe te frymëzu-  
ara nga ndjenja e thellë e miqësisë së sinqerte i janë kush-  
tuar Mecenatit.

Interes të veçantë paraqesin odet në tema politike dhe  
shoqërore. Mbrojtësit e poetit pritin prej tij vepra për  
nder të Augustit. Por Horaci u pajtua me rendin e ri shumë  
me ngadalë se Virgjili. Siç u tha dhe më lart, Horaci, që  
nga vjershat e tij të para republikane deri në fund të vi-  
teve 30 nuk trajtori probleme politike. Ai u kthye tek ato  
vetëm në kohën e luftës civile midis Antonit dhe Oktavianit,  
i cili kish filluar të fitonte simpatinë e popullsisë ita-  
like. Ashtu si poeti i lashtë grek Alkeu në kohën e tij,  
edhe Horaci shtetin romak e paraqet si një " anije" që është  
në rrezik të bëhet lodër e erërave. Oktaviani tani viza-  
tohet si prijës që e nxjerr Italinë nga qorrrokaku i luf-  
tërave civile dhe e çlirion shoqërinë romake dhe kërcënimi  
i stuhive sociale.

Por lavdërimet që i bën Oktavianit në përmbledhjet me  
vjersha të vitit 23, në " Odet" ose " Carminat" kanë ton të  
përmbajtur në krahasim me veprat e tjera të kësaj kohe, si  
" Gjeorgjiket" e Virgjilit, Horaci u thur lavde atyre anë-  
ve të programit të politikës së brendshme dhe të jashtme  
të Augustit, që ishin të pranueshme për patriotet romakë  
me tendenca konservatore republikane. Nga ana tjetër ai  
përkrahte reformat e ndërmarra nga Augusti për të ringja-  
llur virtytet, zakonet dhe besimet e lashta fetare. Nga ky

prizëm ai fshikullon veset e kohës, degjenerimin dhe kupiditetin e saj. Burimi kryesor i së keqes është etja e çmendur për të grumbulluar dhe shtuar pasurinë. Pronat kolosale me pallate luksoze dhe me kopshte dekorative shpien në pakësimin e sipërfaqes së lëvrueshme dhe në shpronësimin e pronarëve të vegjel.

Ti gëzohesh t'u marrësh tokën klienteve të tu,  
Dhe çifti i pafat, me fëmijët e rreckosur.  
Shpërngulet duke marrë me vete hyjnitë atnore.

Nuk ishte kështu në Romën e lashte:

Secili kishte atëherë pak,  
Por lulëzonte prona e përbashkët.

Odet e Horacit shquajnë për larminë tematike, për problemet interesante që trajtojnë dhe për formën e tyre elegante. Poeti bëri një punë të madhe e të pandërprerë për të zotëruar artin e fjalës e për të përsosur stilin e tij. Duke përdorur një figurë të vetë poetit, në punën e tij, ai i përngjet " bletës punëtore që mbledh nektarin e luleve". Që në vitin 23, kur botoi tre librat e " Odeve" Horaci i drejtohet me poezinë e parë Mecenatit, duke shprehur shpresën se do të futet në " numrin e poeteve lirike". Kjo ide shprehet edhe në vjershën e njohur " Monumentit", që mbyll entologjinë me vjersha:

Ngrita një monument me të qëndrueshëm se bronzi,  
.....  
I pari unë i përktheva këngët eoliane  
Në mënyrën latine. Siç e meritoj vulose krenarinë,  
Dhe kryet me dafine delfjane m'i kurorëzo,  
O Melpomene<sup>1)</sup>

Në vitin 20 para erës së re Horaci botoi librin " Mesazhet " ( Epistulat). Nga tematika ato janë të afërta me " Odet". Edhe në këto duket tendenca didaktike moralizuese. Meditacionet filozofike gërshetohen me përshtypje të gjalla te autorit nga sfera të ndryshme të veprimtarisë

1) Muza e tragjedisë.

së tij. Poeti flet për punën që bën vetë në pronën e tij, për pritjen që u bën miqve, për bisedat që bën me ta në tema të ndryshme, për udhëtimet e tij etj. Me të gjitha këto situata, që i filladit me mendime filozofike, Horaci kërkon të na e paraqesë veten jo si dijetar i urtë, por si njeri midis gjithë të tjerëve, që përpiqet ta përkryejë vetveten, duke ditur rrugën nëpër të cilën duhet të ecë.

Gëzimin dhe lumturinë e jetes, qetësinë dhe lirinë shpirtërore ai i gjen në vetminë dhe thjeshtësinë e jetës fusharake, duke luftuar dëshirat e çmendura dhe pasionet. Në një mesazh drejtuar Mecenatit autori me shumë kujdes e mirësjellje, por prerazi deklaron se është gati të heqë dorë nga çdo dhuratë, po që se kjo do t'ia kufizonte lirinë dhe qetësinë shpirtërore.

Përmbledhja poetike "Mesazhet" shënoi një hap të rëndësishëm përpara për sa i takon artit dhe mënyrës së paraqitjes së botës së brendshme të individit.

Në vitin 17 para erës së re u festuan me madhësi të veçantë "lodrat shekullore". Kjo feste u quajt si ngjarje e madhe, që shënoi fundin e periudhës së luftërave civile dhe fillimin e epokës së re të lulëzimit paqësor të Romës. Ceremonia festive e përgatitur me shumë kujdes, ku morën pjesë personalitetet me të shquara të Romës, mbaronte me një himn që mbyllte festën. Hartimi i këtij himni i qe besuar Horacit. Për poetin kjo do të thoshte se admirohej zyrtarisht vendi që zinte si në letërsinë romake pas vdekjes së Virgjilit. "Në Himnin jubilar" me stil solemn ai thuri lavde patriotizmit romak. Që nga kjo kohe Augusti krijoi dhe shprehu mendimin se "vepra e Horacit do të jetë në shëkuj". Përveç Himnit perandori e ngarkoi Horacin të shkruante dhe një vjershe ku të këndonte fitoret e dy thjeshterëve të tij, Tiberit dhe Druzit kundër armiqve të Romës. Kështu poeti u detyrua, pas një intervali të gjatë, të shkruajë edhe një libër të katërt të "Odeve" të tij në vitin 13. Krahas varianteve të disa temave lirike të mëparshme poeti u thur lavde Augustit dhe djemve të tij nga gruaja (thjeshtërve), politikes së brendshme dhe të jashtme të Augustit, si mbartëse të paqes dhe të mirëqënies. Në odet e Horacit tanime zhduket çdo gjurmë republikanizmi.

Nga fundi i jetës Horaci botoi librin e dytë të "Mesazheve", kushtuar problemeve të letërsisë. Libri përmban

tri letra. Pikëpamjet teorike të Horacit mbi letërsinë dhe parimet estetike që ndoqi ai në praktikën e tij poetike u shprehën gjerësisht sidomos në letren e tretë, që në antikitetin e mëvonshme u quajt "Arti poetik" (Ars poetica).

"Arti poetik" u bë një lloj manifesti për klasicizmin romak të epokës së Augustit. Që në fillim të krijimtarisë letrare Horaci luftoi kundër rrymave letrare që predikonin kultin e formës pa ide dhe përmbajtje. Si teoricien ai i dënoi bejtet pa përmbajtje, që synonin drejt efekteve formale. Ai nënvizoi rëndësinë që kishte përmbajtja në art. "Dija dhe mençuria janë themeli dhe burimi i arrit të vërtetë letrar".

Ashtu si Ciceroni për oratorin, edhe Horaci për poetin kërkon një përgatitje të shëndoshë filozofike. Por edhe forma e bukur letrare për Horacin ka rëndësinë e saj. Ai pajtohej në këtë mes me neoteriket, që kërkonin nga poeti përpunim të gjatë e të kujdesshëm të veprës së tij. "Ç'është shkruar duhet të rrije nënte vjet pa u treguar" gjersa ajo të piquet përfundimisht. Horaci mendon se letërsia e vjetër romake ka dobësi nga që shkrimtarët nuk treguan kujdes për formën. Ideali estetik i poetit është "të përzihet e dobishmja me të këndshmen". Një ndihmë e madhe për poetin është edhe kritika.

Estetika që parashtrohet Horaci në veprën e tij "Arti poetik" ka karakter klasicist. Vepra letrare duhet të jetë e thjeshtë, unike e harmonishme. Asimetria, largimi nga tema, eskursionet përshkruese, manierizmi, të gjitha këto e prishin pastërtinë dhe bukurinë e vërtetë të veprës. Asnjë lloj bukurie nuk vlen pa ngarkese të forte emocionale. Gërshetimi i tyre duhet të përbëjë thellimin e letërsisë së klasicizmit romak. Si mjet i fuqishëm për të mësuar artin e të shkruarit; poeti rekomandon klasiket greke. "Nga modelet greke, - shkruan ai, - mos u ndani as ditën, as natën". Por modelet duhet të përvetësohen në mënyrë krijuese dhe jo të imitohen.

Nga të gjitha gjinitë poetike Horaci kujdes të veçantë i kushton dramës. Ato ç'është ai për dramën përbëjnë kanunin e tragjedisë klasike. Autori i "Artit poetik" i hedh poshtë tendencat për të shkëputur korin nga veprimi, për të forcuar anën narrative e për efekte të forta vizive. Ashtu si teoricienet helenistike edhe Horaci parashtrohet

rregullin e njohur se tragjedia duhet të përbëhet nga pese akte. Më vonë kjo u bë një nga normat kryesore për dramaturgjinë e klasicizmit evropian. Ndryshe nga "Poetika" e Aristotelit, poetika e Horacit është më normative. Duke e parë procesin e zhvillimit letrar në një kohe më të gjatë e në shumëllojshmëri më të madhe nga ç'e bëri Aristoteli, Horaci deshi të japë ligje më të qëndrueshme të poezisë.

Për poetiken e klasicizmit evropian "Arti poetik" i Horacit luajti rol jo më të vogël nga "Poetika" e Aristotelit. Kodi i klasicizmit "Arti poetik" i Bualose në shekullin XVII jo vetëm mban titullin e veprës së Horacit, por edhe materialin e parashtron në renditje pothuaj të njëjtë, me hollësi të shumta të huazuara të poetit romak, që shpesh citohen fjalë për fjalë.

Horaci u afirmua si poet klasik që në kohën e tij. Vepra e tij shërbeu si tekst leximi dhe komentimi në shkollën romake. Por në antikitetin e mëvonshëm ai nuk u çmua. Është e vërtetë se në epokën e kristianizmit e pranuan prirjen e poetit për t'u larguar nga qyteti e për t'u thelluar në vetvete, sepse kjo përputhej me disa anë të doktrinës kristiane, por këto prirje në kristianizëm kishin karakter jetar, kurse te Horaci, i cili nuk jetoi në epokën e kristianizmit, nuk gjejmë gjurme dhe mbështetje as dhe të fese pagane politeiste.

Famën si poet i madh Horaci e fitoi më vonë. Ai u çmua shumë veçanërisht në periudhën e Humanizmit, kur lufta për personalitetin e njeriut kundër botëkuptimit kristian mori kuptim të thelle filozofik e shoqëror. Poeti italian i shekullit XIV Petrarka e çmoi shumë Horacin jo vetëm si mendimtar, por dhe si lirik të madh. Edhe në kohët moderne poezia e tij u bë objekt imitimesh. Veçori të ndryshme të anëve etike e filozofike të veprës së tij letrare u shfrytëzuan në mënyra të ndryshme nga rrymatë të ndryshme letrare gjatë gjithë kohëve.

Si artist e mendimtar, si teoricien i letërsisë, Horaci ze vënd të dalluar në letërsinë botërore. "Mesazhi mbi artin poetik" shërbeu si model në shekujt e 17<sup>-të</sup>, 18<sup>-të</sup> në Evropë, për Bualonë, Hotshedin etj.

GAJ KORNEJ GALI

Themeluesi i elegjisë romake ka qenë Gaj Kornej Gali ( viti 69 gjer me 26 para erës së re).

Ai i përkiste brezit më të ri të neoterikeve. Përktheu në gjuhën latine vjershat "erudite" të Euforionit nga Kalkida. Një fare erudicioni mitologjik përshkronte dhe ato cikle të elegjive erotike, që Gali i shkroi për nder të Likorides ( pseudonim i aktorese Kiterida). Gali kishte qenë shok shkolle me Augustin dhe më vonë pati edhe detyra të larta shtetërore.

Elegjia në Romë doli si rrymë e re që lidhej në shumë anë me traditat e neoterikeve dhe që lëronte kryesisht motivin e dashurisë.

Kjo degë e poezisë romake lulëzoi me vrull në periudhën e vendosjes së Perandorisë Romake, dhe përëndoi shpejt, duke lënë si përmendore të saj krijimet e katër poetëve me të shquar, Galt, Tibulit, Propertit dhe Ovidit. Elegjia e dashurisë pati një jetë të shkurtër në Romë, por më vonë luajti një rol shumë të madh për zhvillimin e lirikës erotike evropiane. Ajo lindi dhe u zhvillua në kushtet e rritjes së prirjeve individualiste epikuriane në radhët e skllavopronarëve aty nga fundi i luftës civile dhe fillimi i cesarizmit. Me prirjet epikuriane dhe me tematiken e dashurisë që trajtoi, elegjia u vù në opozitë me ideologjinë e epokës së Augustit, i cili kërkonte të ringjallte virtytet dhe doket e së kaluarës. Elegjia doli gati si vazhdim i rrugës së zhvillimit të lirikës romake të poetëve " të rinj", " neoterikëve" të gjysmës së parë të shekullit I para erës së re. Duke përpunuar motivet e poezisë helenistike të dashurisë, elegjia romake përshkruan përjetimet personale, të poetit, peripecitë e tij në marrëdhëniet me gruan e dashuruar, dhe në këtë vështrim ajo lidhet me elegjinë greke të dashurisë të Mimnermit.

Lulëzimi i elegjisë në kohën e Augustit lidhet me faktin se kjo gjini poetike doli si reagim ndaj rendit në fuqi. Tendanca erotike në poezi shërbeu si maske për të fshehur opoziten kundër ideologjisë zyrtare. Me forcimin e perandorisë, elegjia e humbi aktualitetin e saj. Trajtimi i motivit të dashurisë nuk shërbente më si shprehje e pakënaqësisë së përshtur ndaj shturjes sociale.

Pararendës i elegjiakeve romake ka qenë Katuli me vjershat e tij kushtuar Lesbies. Te poetët elegjiakë dashuria paraqitet si një ndjenjë e fortë, si epiqender e jetes, që nuk le vend për emocione të tjera, sidomos për emocione me karakter social. Kurse në krijimet poetike të Katulit vuajtjet dhe emocionet e dashurisë nuk jepen me ato ngjyra tragjike si te poetët elegjiake.

Është kuptimplote të vërejmë se në vitet 40-30 para erës së re, koha kur lindi dhe u zhvillua elegjia, edhe Virgjili në eklogat e "Bukolikeve" të tij masken e dashurisë baritore e përdori si prirje për t'u larguar nga realiteti i kohës. Por Virgjili u pajtua shpejt me këtë realitet. Poetët elegjiakë, të cilët e përdoren maskën e poetit të dashuruar si përpjekje për t'u larguar nga realiteti në botën utopike të dashurisë dhe të poezisë, përkundrazi e ndërprejnë krijimtarinë e tyre letrare atëherë kur rrethanat e reja politike dhe sociale nuk ndihmonin në zhvillimin e këtij lloji poetik.

### TIBULI

Një dëshmi e qartë e "apolitizmit" politik të poetëve elegjiakë është vepra e Alb Tibulit, ( 50 - 19 pa-

ra erës së re).

Në elegjinë e tij ai le në heshtje problemet aktuale. Ndryshe nga shumë poetë të kohës së tij, ai nuk u përmend asnjëherë emrin e Augustit dhe as ngjarjet historike, që ishte bërë zakon t'u thureshin lavde në letersi, si p.sh. beteja e Akciumit, ku Oktavi korri një fitore të shkëlqyer kundër rivalit të tij Antonit, lufta kundër partëve etj.

Momenti i fluturimit nga realiteti në jetën e qete të fshatit të Tibulit është më i fuqishëm se tek te gjithë poetët e tjerë elegjiakë. Ai përshkruhet si një "parajsë e humbur", larg tronditjeve dhe tallazeve të kohës. Ideali i poetit është "jeta pa punë" në një prone të vogël duke u kënaqur me pak.

Tibuli ka shkruar dy përmbledhje me vjersha. E para ka si figurë qendrore Delian ( e cila ka jetuar vertet). Delian e kanë mbyllur në shtëpi dhe e ruajnë. Poeti mendon gjithnjë për atë, qendron para derës së saj, i lutet dhe e mëson të dashuren si të mashtroje rojet. Në këtë vjershe shohim motivet e "serenades" që do të përhapet aq shumë në kohën e mesme. Me tutje Tibuli shpreh mendim-

min se çdo t'i duhej lufta e heroizmat kur ai mund ta kal-  
jë jetën aq bukur me Delian e tij. Ç'duhet pasuria dhe luksi  
kur nuk ka dashuri të lumtur. Tibullit i mjafton jeta e var-  
fër e fshatit me miken e tij.

Te të vije keq për mua, Venera shpirti im  
Te shërben me devocion te përjetshëm,  
Pse e djeg, ti, mizore, viktimën tënde?

Me tutje shprehen mendime të zymta për pabesinë e De-  
lias dhe për zhgënjimiet që ka pasur poeti nga ajo, kur  
ëndërronte ta bënte zonjë shtëpie në një shtëpi të thjeshtë  
në fshat, ku do të vinte t'i vizitonte Mesala, (orator dhe  
burre shteti romak, mbrojtës i poetit). As vera, as ndonjë  
dashuri tjetër nuk do të mund t'ia largojnë poetit pikëllim-  
in.

Me vargjet e tjera poeti, ka kritikuar drejtpërsëdrejti  
plaget e shoqërisë së tij, disa nga tiparet e rënies mora-  
le të kësaj shoqërie. Qoftë mallkuar kodoshja që i paraqi-  
ti Delias një dashnor të pasur. Dhuratat e shkatërrojnë da-  
shurinë dhe miku i varfër është më i mirë se i pasuri.

Në përmbledhjen e datë poetike dashuria paraqitet me  
ngjyra me t'ë zymtë e pesimiste.

Vjershat e Tibullit dallohen për origjinalitet dhe emo-  
cione të fuqishme, për qartësinë dhe pastërtinë e gjuhës.  
Qysh me kohe kritika antike vuri në dukje elegancën e ty-  
re.

## PROPERCI

Properci (49 - 15 para erës së  
re). Lindi në qytetin Asizi, kra-  
hina e Umbrias. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Ro-  
më, ku u njoh me Mecenatin.

Edhe Properci në lirikat e tij i këndoi dashurisë dhe  
emocioneve të saj, por ndryshe nga Tiburi melankolik ai  
çan më me guxim në detin e halleve të dashurisë.

Përmbledhja e parë me vjersha doli me titullin "Cin-  
tia". Poeti i vizatën ndjenjat e tij në një sfond mitolo-  
gjik. Edhe te Properci dashuria bëhet epiqender e jetës.  
Dashuria e parë dhe e vetme për të është Cintia. Ajo është  
burimi i frymëzimit dhe i poezisë. Por Cintia shpesh para-  
qitet si e pakapshme, kapricioze dhe e paqëndrueshme, dhe  
kjo gje e bën poetin të vuajë, të rrembehët nga vrullet e



pasionit dhe të xhelozisë.

Që në elegjinë e parë të dashurisë, që fillon me fjalën Cintia, Properci përshkruan gjendjen e rende shpirtërore të tij, dhe kjo i jep tonin, kryesor librit. Vjershat e tjera na njohin edhe më mirë me portretin e heroinës. Si të don- te të tërhiqte vemendjen e lexuesit kundër luksit dhe mjete- ve kozmetike poeti lëvdon bukurinë natyrale të Cintias aftësitë e saj muzikore dhe poetike. Në një vjershe tjetër ai bisedon me miqtë që kërkojnë ta ndajnë nga Cintia, por atij i duket e pamundur jeta pa " sunduesen e ashpër".

Në përmbledhjen e dytë të elegjive poeti trajton gjith- një temën e dashurisë për Cintian duke na e dhënë këtë në aspekte të ndryshme. Tani poeti ka më shumë rivalë dhe Cin- tia na del e pabesë, mendjehetë, që jepet pas interesit. Kurse dashnori, që dikur i qëndronte asaj besnik, tani ad- miron te gjitha bukuroshet që takon.

Për një kohë edhe Properci hyri në rrethin e Mecenatit, por u mundua të ruajë gjithnjë lirinë e mendimeve të tij. Ai i ironizon përpyjekjet e Augustit, që synonin të rin- gjallnin virtytet e lashta. Properci e refuzoi proprozimin e Mecenatit për të shkruar një poemë epike për nder të Au- gustit.

Dy nga elegjite e përmbledhjes së dytë u bënë shumë të njohura në kohën e re, ajo ku përshkruhet Amuri me të gjitha atributet; dhe tjetra, ku tregohet se si turma e Amu- reve e kapi poetin që bridhte naten rrugëve dhe e çoi të lidhur me pranga në shtëpi, ku e pritete mikja. Vjersha që mbylli këtë përmbledhje poetike parashton si te thuash programin letrar të Proprecit: duke vazhduar traditat e neoterikeve dhe te Gakit poeti e gjen frymëzimin në da- shurinë e tij dhe ecen në rrugën e poetëve elegjiake heleni- stike, të Kalimahut dhe të Filitit.

Edhe në përmbledhjen e tretë të elegjive të tij, që do- li aty nga viti 22 para erës së re, ai përsërit deri diku vjershën " Monumenti" të Horacit dhe thotë se ai i pari e solli në Itali poezinë e Kalimahut dhe të Filitit, dhe se vjershat e tij janë me të përjetshme se piramidet dhe tem- pujt. Ashtu si Kalimahu, edhe ai e shikon veten të trans- portuar në malin e Muzave, ku Apoloni dhe Kaliopa e nda- lonte të shkruaje epope dhe e porositin të qëndroje në tru- allin e poezisë erotike. Cintia tanime nuk e luan me atë rol që luante më parë. Kjo përmbledhje nuk e ka me atë frymë të theksuar subjektivizmi. Poeti jep gjykime të për-

gjithshme rreth forcës së pasionit, rreth dashurisë me interes etj. dhe shpesh shfaq dëshirën të çlirohet nga prangat e dashurisë.

Si poet elegjiak, Properci i sugjeruan të bëhej i dobishëm për ideologjinë zyrtare, dhe të ndiqte shembullin e mësuesit të tij Kalimahut dhe të shkruante një vepër si " Shkaqet " e Kalimahur, domethënë një paralel romak rreth festave dhe riteve të kultit shtetëror romak. Properci nuk mund t'i shmangej një propozimi të tillë, prandaj përmbledhjen e tretë të vjershave të tij e mbyll duke deklaruar prerazi se po heq dore nga Cintia, domethënë nga poezia e dashurisë.

Ideja për të shkruar një cikël me vjersha erudite narrative nuk u realizua. Përmbledhja e fundit me vjersha, që u botua aty nga viti 10 para erës së re, hapet me një vjershe që tregon se si u përmbys plani për të shkruar një vepër të ngjashme me " Shkaqet " e Kalimahut dhe se poeti i rikthehet tematikës së dashurisë. Properci kërkon t'ia kundërvëjë elegjitë e tij stilit të agritur të eposit. Sipas mendimit të tij " vargu i Mimnermit ka me shumë force në dashuri se sa Homeri".

Në vjershën e parë të ciklit të fundit të vjershave të tij Properci thotë se do të dante të bëhej një " Kalimah romak", të këndonte ngjarjet me interesante të historisë dhe ritet e kulteve romake, por atë e ndaloi astrologu, i cili profetizoi se do të pësonte një dështim të plotë në synimet e tij.

Në përmbledhjen e fundit të elegjive të tij vërehet një fare ndryshimi nga e kaluara në trajtimin e temës së dashurisë. Ai nuk është më poeti i dashuruar si më parë, megjithëse pohon se mbetet gjithnjë skllav i dashurisë. Në këtë cikël vjershash interesante është përpyekja për të pasuruar poezinë e dashurisë me elementin e dashurisë bashkëshortore. Në këtë anë Propersi vazhdon rrugën e filluar nga Katuli, veç këtë temë ai e përpunon nga prizmi i ndjenjës së gruas, e cila kërkon besnikëri nga burri. Tani shfaqet mendimi se " çdo dashuri është e madhe, por më e madhe është dashuria për bashkëshortin". Ndryshe nga përmbledhjet e para poetike tani si mbartëse e ndjenjave më fisnike të dashurisë është gruaja. Ringjallet përsëri figura e Cintias, e cila, ndryshe nga ç'ishte më parë, paraqitet si mike besnike, që vuan nga mendjehetësia e

adhuruesit te saj. Në këtë mënyrë ndërrohen rolet. Me parë vuan poeti nga ajo, tani vuan ajo nga poeti. Hieja e Cintas së vdekur i del poetit përpara dhe e qorton për zemrën e tij mizore e të pabesë. Por ajo e fal poetin, sepse "për një kohe të gjatë sundoi në vargjet e tij" dhe i premtonte se do të takohen përsëri pas vdekjes në fushat e bukura të Elizesë, ku ajo ishte lejuar të jetonte së bashku me heroinat e njohura të mitologjisë për jetën e saj të pastër.

Në një vjershe që vjen pas kësaj, krahas idealizimit të Cintas, gjejmë dhe elemente humori. Me një ton të këndshëm e gazmor, poeti, duke parodizuar stilin e elegjisë "erudite", kërkon të shpjegojë shkaku e skandalit që kishte prishur parmbreme gjumin e qetë të fqinjët. Ç'kishte ndodhur? Cintia ishte nisur në një shoqëri gazmore nga qyteti i përmendur Lanuv, dhe poeti, duke përfituar nga mungesa e saj, zbavitet me vajza të dyshimta. Por ata e shqetësojnë parandjenja të zymta. Dhe me të vertetë, pa pritmas Cintia, kthet "lëshon rrufe" dhe hakmerret ashpër kundër rivaleve të saj dhe mikut mendjelhete.

Duke i kënduar dashurisë bashkëshortore Properci krijon veper artistike, që i përgjigjej plotësisht politikës së perandorit, i cili u përpoq të frenonte shthurjen morale të familjes, që po degjeneronte me shpejtësi në kohën e tij.

Ndryshe nga poetet bashkëkohës Properci nuk deshi ta ngushtojë mendimin dhe patosin e ndjenjave të tij në kor-nizen e një forme tepër të lëmuar. Kjo e bëri atë të thyejë edhe rregullat e sintaksit të zakonshëm poetik, gjë që ndonjëherë ka përftuar edhe errësirë e mungesë lidhjeje në mendime. Kritikë antike parapëlqeu me tepër Tibulin elegat dhe harmonioz. Ai u çmua më tepër në kohët e reja. Madje ushtroi edhe një fare ndikimi, sidomos te Petrarka, i cili për të krijuar Laurën e tij në shumë anë u frymëzua nga figura e Cintas.

## OVIDI

Krijimtaria poetike e Ovidit (43 para erës së re - 18 era e re) i përket gjysmës së dytë të sundimit të Augustit, periudhës,

1) Sipas mitologjisë Elizea ishte vendi ku pushonin shpirtat e heronjve dhe të njerëzve të virtytshëm.

kur i ashtuquajturi " shekulli i artë" shkonte gjithnjë e më shumë drejt krizës politike dhe ideologjike. Këto rrethana përcaktuan zjer në një fare mase edhe karakterin e veprës poetike të përfaqësuesit të fundit të elegjisë romake.

Shumë të dhëna autobiografike poeti na i jep në veprën poetike " Vjersha të trishtuara " ( "Tristia"), që e shkroi gjatë periudhës së internimit. Ai lindi me 20 mars të vitit 43 në qytetin Sulmone, Italia e mesme, në një familje të lashte kalorësish. I ati donte që dy djemtë e tij të ndiqnin karrierën avokatore, prandaj që kur ishin fëmijë i dërgoi në Romë të mësonin oratorinë. Por me ndryshimin e gjendjes politike " mësimi në Forum" nuk e kishte me atë rëndësi që, kishte pasur me vitet e rinisë së Ciceronit. Përgatitja themelore oratorike tani bëhëj në shkollën retorike, në " deklamacione". Deklamacionet ishin fjalime në tema të trilluara, larg realitetit. Kishte dy lloje deklamacionesh: së pari ishin kontroversiet, fjalime gjyqsore të improvizuara, kause të imagjinuara, me ngjarje të paqena, gati romaneske, me " tirane" dhe "pirate", me armiqëbenin si bazë për të shtjelluar konflikte të stisura me pahir me qëllime ushtrimi. Lloji tjetër i deklamacioneve ishin svasoriet, meditacione të vëna në gojën e figurave historike e ndonjëherë mitologjike në situata të ndryshme.

Sipas fjalëve të Senekes plak, i cili na ka lënë një përmbledhje me deklamacione të periudhës augustiane, Ovidi mbahej si " deklamator " i fortë, por anët logjike të deklamacionit -provat juridike dhe parashtrimi sistematik e rendonin poetin dhe ai më me endje deklamonte svaserie se sa kontroversie, kështu që jepete përshtypjen se po recitonte vargje në prozë. Vetë Ovidi pohonte se proza nuk i kishte ecur kurrë atij dhe se pa dashur kalonte gjithnjë në vjershe:

Shpesh me thoshte im atë: "Ti merresh me pune të kota,

Se moq Homeri la pas ndonjë pasuri?

I prekur nga fjalët e t'im eti, si braktisa

Muza dhe Helikone, nisa të shkruaj, po jo në vargje,

Fjalët vetiu veç renditeshin në vargje,

Ajo çka unë shkruaj në prozë derdhje pa dashur në vjershë.

Si i dha fund arsimit me udhëtimin tradicional në Greqi dhe në Azi të Vogël, Ovidi u kthye në Romë, që të fillonte karrierën e tij, por ai zuri poste të rëndësishme, siç ëndërronte dhe shpejt hoqi dorë nga ajo. Defrimet publike dhe letërsia e tërhiqnin atë me tepër se sa perspektiva për të hyrë në senat. Ovidi kaloi një jetë të pavarur në shoqërinë e lartë romake dhe në rrethin e poetëve, duke mbajtur lidhje edhe me poetet e rrethit të Mecenatit, sidomos me Propertin.

Krijimtaria letrare e Ovidit u zhvillua në tri etapa. Në etapën e parë poeti shkroi poezi në tema dashurie, në të dytën poezi në tema erudite-mitologjike dhe në të tretën shkroi vjershat e internimit.

Vepërtarinë poetike e nisi me elegjite e dashurisë, të cilat i përmbledhi në pesë libra. Përmbledhja që na ka arritur me titullin "Vjersha dashurie" ("Amores") sipas traditës elegjiake ka heroinën e saj, të cilën Ovidi e ka quajtur Korina, për nder të poeteshës greke, me këtë emër, të shekullit V para erës së re. Vetëm pak poezi i drejtohen drejtpërsëdrejti Korines. Pjesa më e madhe e elegjive janë vjersha që përsëritin tematikën e Katulit, të Tibulit dhe të Propertit. Edhe tek Ovidi, si tek ata, takojmë motivin e serenades, bukuroshen që jepet pas interesit, rivalin në dashuri etj, por Ovidi, ndryshe nga ata, mban qëndrim të veçantë ndaj realiteti dhe përdor mjete stilistike të ndryshme nga ato të pararendesve të tij.

Ovidi nuk e ka atë ndjenjë pakënaqësie ndaj rendit politik në fuqi, që e kishin shumica e shkrimtarëve të brezit të kaluar. Poeti, i cili u rrit në atmosferën e perandorisë, i ngopur me shkëlqimin e jashtëm të "Romës së arte" e përgëzon veten që ka lindur pikërisht atë herë. E vetmja gjë në politiken ideologjike të perandorisë, me të cilën nuk pajtohej Ovidi ishte gjunjëzimi zyrtar para së kaluarës dhe parullat për të rilindur zakonet dhe virtytet e lashta. Ashtu si poetët e tjerë elegjiakë, me prirje epikuriane, Ovidi në ndryshim nga Tibuli ashtu dhe nga Virgjili, nuk ishte aq i prirë për të idelizuar të kaluarën; sipas mendimit të tij, ajo ishte e ashpër. Ovidi e kujtonte se të kthesh rroten e historisë është e pamundur. "Ne jetojmë si

ñjerëz të bashkëkohësisë sonë" ( Fatet, I, 226). Prandaj ai nuk e miratoi politiken e Augustit për të rivendosur moralin dhe virtytet e lashta qytetare.

Ovidi , si poet i dashurisë nuk shkëputet nga realiteti; ai nuk largohet në gjirin e natyrës e nuk futet në ideale fusharake, por qëndron i lidhur me jeten mondane të Romës. Ai nuk e idealizon dashurinë, përkundrazi i këndon asaj si këngëtar gazmor, madje ndonjëherë edhe me nota të një ironie të lehtë. Ndryshe nga Tibuli e Properci ai kërkon t'u shpëtoje vuajtjeve të dashurisë. Një ndryshim i rëndësishëm midis Ovidit dhe pararendesve të tij është se ky futi në poezi elementet e stilit deklamativ, retorik. Stili deklamativ zotëroi në krejt letërsinë e periudhës së perandorisë dhe me veprën e Ovidit filloi një etapë e re në zhvillimin e poezisë romake.

"Vjershat e dashurisë" dallohen për elegancën e stilit, për tablotë e gjalla nga jeta dhe për situata të mprehta psikologjike.

Në përmbledhjen tjetër poetike me titull " Heroinat" poeti shtjellon në vargje një serë letrash që shkruajnë disa heroina mitologjike, të cilat jetojnë larg burrave ose të dashurve të tyre. Letrat në vargje, shtjelluar në formë monologjesh lirike i japin dorë poetit të derdhte në figura të bukura elegante ndjenjat subjektive të këtyre heroinave, motivin e xhelozisë, dhe të shkëlqejë me stilin e tij plot dritë e vezullime. Pesëmbëdhjetë letra dashurie në emër të pesëmbëdhjetë heroinave trajtojnë në thelb të njëjtën temë: ndarjen, mallin, vetminë, vuajtjet e dashurisë, kujtimet e hidhura nga fillimi i dashurisë së pafat, lutjet e thekshme për t'u kthyer etj. Nga vargu i heroinave mitologjike poeti përmend Penelopen modeste dhe Fedren e zhuritur nga pasioni, Enonen sentimentale dhe Mesean hakmarrëse, Brizeiden e ndarë me dhunë dhe Didonën e braktisur. Secila i jeton në mënyrën e vet gëzimet dhe hidhërimet. Poeti ka zbuluar me mjeshtëri dhe fuqi arti psikologjinë e grave të dashuruara. Prandaj vepra e tij " Heroinat" ka pasur gjithnjë sukses.

Për të trajtuar poetikisht figurat e këtyre heroinave mitologjike Ovidi u mbështet në burime dhe autorë të ndryshëm: të Homeri për Penelopen dhe Brizeiden, të tragjikut greke për Dejaniren, Medean dhe Fedren, të Virgjili për Didonën etj.

Nga trajta shpirtërore figurat e Ovidit qëndrojnë shu-  
më larg nga figurat madhështore të eposit ose të tragjedisë.  
Këto bukuroshe "te ndjeshme" janë pothuajse gjithmonë të  
frikësuara, pa asnjë ndihmë; Didona e Ovidit, për shembull,  
është zhveshur krejtësisht nga ato tipare heroike, me të  
cilat e veshi në kohën e tij Virgjili.

Gjatë kohës që punonte për "Heroinat" Ovidi shkroi edhe  
tragjedinë "Medea", për të cilën kritika antike kish thë-  
në fjalë të mira. "Medea" e Ovidit ashtu dhe "Tiesti" i  
Varit, vepra këto që nuk na kanë arritur, janë mbajtur si  
krijimet me të mira të poezisë tragjike romake.

Një vepër tjetër e Ovidit është "Arti i dashurisë".  
Në të poeti zhvillon edhe me tutje tendencën didaktike që  
karakterizoi që në fillim elegjinë romake. "Arti i dashu-  
risë" ka një frymë didaktike parodizuese dhe është shkruar  
në vargje në formën e elegjisë.

Vepra përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë quhet "Gjet-  
ja". Poeti duket se parodizon me ato udhëzime didaskalike  
të retorikes që e niste problemin e dashurisë me momentin  
e "gjetjes" së objektit të denje për t'u dashuruar. Pjesa  
e dytë e veprës parashtron një serë udhëzimesh si duhet  
fituar dashuria. Në pjesën e tretë tregohet se si duhet të  
ruhet dashuria. Mësimet jepen një herë për burrat dhe pas-  
taj për gratë.

Parashtrimi i këtyre udhëzimeve që synojnë "t'u mëso-  
jnë" të tjerëve artin e të dashuruarit gjallërohet e bëhet  
mjaft interesant nga sentencat e mprehta, nga tregimet mi-  
tologjike, nga skenat nga jeta.

Me një ton tallës e didaktik se bashku është hartuar  
dhe poema e dytë "Ilaçi i dashurisë". Në të poeti jep  
këshilla se ç'mjete duhen përdorur për të ndihmuar atë që  
ka rënë në dashuri pa shpresë.

Me poemat "didaktike" mbaron periudha e parë e krijim-  
tarisë letrare të Ovidit. Tani poeti kapet pas gjinisë nara-  
tive në vargje, ku shkelen talenti i tij si tregimtar i  
hollë e shumë tërheqës. Ovidi shkruan poema të tipit kata-  
logjik, që bashkon një numër të madh tregimesh e legjendash  
të afërta midis tyre nga pikëpamja tematike. Të tilla vepra  
i takojmë shpesh edhe në poezinë aleksandrine ("Shkaqet"  
e Kalimahut, poemat e Eratosthenit etj.).

Poemat e tipit katalogjik të Ovidit janë "Metamorfo-  
zet" dhe "Fastet". Motivi i metamorfozës, i shndërrimit,

ze një vend të madh midis legjendave dhe gojëdhanave të të gjithë popujve.

"Metamorfozet" e Ovidit është e shkruar në 15 libra dhe ka më tepër se dyqind legjenda, që mbarojnë me motivin e shndërrimit të diçkaje në diçka tjetër. Poeti është përpjekur t'i lidhte me një pe të gjitha këto legjenda dhe të ruajë një fare rendi kronologjik. Poema nis me krijimin e botës, që është "metamorfoza" e parë, e shndërrimit të kaosit në kozmos dhe vjen pastaj në kohët historike deri tek "metamorfoza" më e re, e pranuar zyrtarisht, të "shndërrimi" i Jul Qezarit në kometë.

Në hartimin e "Metamorfozave" Ovidi u ndodh përpara disa vështirësive për nga ana kompozicionale, meqenëse një pjesë e madhe e legjendave e humbasin fillin kronologjik dhe nuk kanë midis tyre një lidhje të brendshme. Poeti përdori të gjitha mënyrat dhe mjetet kompozicionale për të ruajtur një farë vazhdimësie nga tere ai material i ndryshëm e i shpërndarë nëpër shekuj. Për të mënjeluar monotoni Ovidi përdori figura të pasura e të larmishme, kombinimi me lehtësi të jashtëzakonshme tablote e trishtuara me ato të gëzueshme, kaloi në mënyrë të natyrshme nga tragjika në komiken, nga madhështorja në grotesken.

Po permendim disa nga "metamorfozat" më të njohura si atë të shndërrimit të Dafnes në dafinë; mitin për Faetontin që i kërkoi babait të tij Heliosit (Diellit) karrocen, me të cilën për pak sa s'dogji botën; legjenden mbi Narcisin, që nuk pranoi dashurinë e nimfes Eho (Jehona) dhe u dashurua me vetveten; novelën mbi dashurinë fatkeqe të Piramidit dhe të Tisbes; gojëdhenen mbi Nioben, që u mburr me fëmijët e saj dhe me në fund i humbi nga mendjemadhësia; tregimin fantastik për fluturimin fatkeq të Dedalit dhe Ikarit; idilin e Filemonit e Baukides; legjenden mbi Ofreun e Euridiken etj.

Me një fare humori e ironie i ka trajtuar figurat e perendive Ovidi në "Metamorfozat" e tij, duke i zbritur ato nga piedestali i tyre. Perendite jetojnë sipas mënyrës së shoqërisë romake: në qiell ndodhen pallatet për perendite e fuqishme dhe vendet ku jeton plebeu. Ashtu si përfaqësuesit e shoqërisë aristokratike romake edhe perendite merren me intriga e aventura dashurie. Këto janë argetimet kryesore për ta. Jupiteri, p.sh., është si burri në një komedi, të gjitha punet e tij i bën fshehurazi nga gruaja.



Në pjesën e fundit të veprës së tij "Metamorfozet" Ovidi kalon nga legjendat greke në ato italice e romake. Libri i fundit që mbyll veprën, midis të tjerash parashton edhe doktrinën e Pitagores mbi metempsihozen, transferimin e shpirtit nga një trup i gjallë në tjetrin. Poeti e përmend këtë gjë për të "mbështetur" filozofikisht motivin mitologjik të metamorfozës.

Për mitet romake Ovidi flet veçanërisht në veprën e tij "Fastet", elegji me karakter entologjik. Poeti mori përsipër të kryejë atë punë që pati nisur në kohën e tij Properci, të krijojë serinë e elegjive narrative rreth gojëdhënave dhe riteve të kultit romak. Kjo vepër duhet të përshkruhej nga fryma e ideologjisë zyrtare dhe Ovidi po bëhej gati t'ia kushtonte atë Augustit. Si mjet për të lidhur legjendat e ndryshme poeti mori kalendarin romak, këndej vjen edhe titulli i veprës "Fastet".

Çdo libër i kushtohet një muaji të veçantë dhe fillon me interpretimet erudite - gramatikore të emrit të muajit. Duke dashur të ruajë rendin kalendarik autori është detyruar të ndeshet me një fushe pak të njohur për të, me atë astronomike. Nga ana tjetër kjo e ka bërë të fute edhe mitet rreth prejardhjes së konstelacioneve. Përmbajtja kryesore e "Fasteve" janë legjendat që lidhen me festat romake. Mitet me origjinë greke dhe folklori italik alternohen me tregime nga historia romake duke arritur deri në ngjarjet aktuale. Në mënyrë të veçantë janë nënvizuar ditet e shënuaara për shtëpinë perandorake. Me gjithë dëshirën për t'i thurur lavde lashtësisë, Ovidi shpesh hidhet në atë fushe, që i jep dorë të shkëlqejë me bukurinë e figurave poetike; në fushen e erotikes. Kështu ai flet me frymëzim për dhunen që kreu djali i mbretit të fundit romak, për dhunen e Tarquinut mbi Lukrecien e mençur dhe të urtë. Këtë temë e trajtoi dhe Shekspiri në poemën e tij "Lukrecia".

Në kohën kur Ovidi ishte duke mbaruar "Metamorfozet" dhe kishte arritur deri në gjysmën e "Fasteve", në vitin 6 të erës së re Augusti e internoi atë në një krahinë të largët të perandorisë, në breg të Detit të Zi, në qytetin Tomi (Konstanca e sotme). Arsyet e internimit nuk dihen. Poeti akuzohej për imoralitetin e veprës së tij "Arti i dashurisë", si vepër që synonte të prishte themelet e jetes familjare. Por me këtë akuze u bashkua një arsye tjetër me konkrete, e siç duket më e rëndësishme, për të cilën

Ovidi flet shpesh me shprehje të fërrëta. Nga aluzionet që bën poeti mund të mendohet se ai ka qenë dëshmitar okular, ndoshta rastësisht, i një krimi që nuk ka pasur karakter politik, por që e prekte personalisht Augustin; kujtimi i këtij krimi dukej sikur i hapte plagë perandorit. Studiuesit thonë se po në vitin 8 para erës së re ishte internuar për jetën e saj të shturur mbesa e Augustit, Julia e re, dhe ndofta Ovidi kishte gisht në aventurat e saj.

Fatkeqësia që ra mbi Ovidin ishte diçka krejt e papritur për të. Në dëshpërim e sipër ai dogji dorëshkrimin e "Metamorfozeve". Por vepra u ruajt në saje të kopjeve që kishin shokët e tij.

Gjatë rrugës për internim, që zgjati disa muaj, Ovidi shkroi librin e parë të "Vjershave të trishtuara" ("Tristia"). Njera nga elegjitë që përbëjnë këtë vepër përshkruan shumë bukur natën e fundit të poetit në Romë; në elegji të tjerave flitet për vështirësitë e rrugës, për lundrimin nëpër tallaze e stuhi, për bisedimet që bën nga larg me gojë emrat. Pas pak kohe si arriti në Tomi shkroi librin e dytë, që ishte një mesazh i gjatë, plot elozhe drejtuar veprimtarinë e tij letrare, duke iu referuar shembujve të poetëve të së kaluarës, që kishin trajtuar lirisht temat e dashurisë dhe siguron se vjershat e tij kanë qenë në pjesën më të madhe trillime dhe s'kanë shprehur aspak jetën personale të shkrimtarit. Por Augusti nuk ndërroi vendim.

Tri përmbledhjet e fundit të "Vjershave të trishtuara" shkruar në vitet 10-12 të erës së re përshkohen nga një notë e thëksuar ankimi për fatin, nga një notë lutjeje për të lehtësuar gjendjen e vështirë të poetit. Ovidi ankohet për klimen e ashpër të Skithisë, për pabesinë e shokëve, flet me admirim për gruan e tij të devotshme, kërkon mbrojtje, kërkon ta transferojnë në një vend tjetër internimi etj. Mbas gjithë këtyre flet për poezinë dhe e lavdëron atë si ngushëllim të vetëm për jetën e pafat. Në vjershën e fundit të librit të katërt Ovidi tregon biografinë e tij. Gjatë kohës së internimit poeti shkroi dhe disa vjersha pa rendësi.

Pak kohe pas vdekjes së Augustit në vitin 14 era e re Ovidit iu ngjallen shpresat për t'u kthyer në atdhe. Kur u bë perandor Tiberi poeti u përpoq të tërhiqte vemendjen e,

trashëgimtarit të ri të fronit. Ai filloi të përpunojë "Fastet", por nuk arriti të përpunojë as edhe librin e parë, sepse vdiq, në internim në vitin 18 të erës së re.

Ovidi hyri në letërsinë romake si artist i shquar i formës së lehte elegante. Kritika antike në kohën e saj vuri në dukje shkathësinë e poetit në të shkruar. Në rrethet e lexuesve Ovidi qysh në kohën e tij fitoi popullaritet të madh, i cili u ruajt edhe në kohën e mëtejme. Poezia e dashurisë e Ovidit frymëzoi liriken e shkruar në gjuhën latine dhe atë të trubadureve provansalë. "Metamorfozet" e Ovidit u quajtën "Bibla pagane". Duke filluar me Rilindjen evropiane subjektet e Ovidit u përpunuan shumë herë; në bazë të tyre u shkruan novela, opera, balete etj.

### 3. ZHVILLIMI I HISTORIOGRAFISË

#### TIT LIVI.

Vepra historike e Tit Livit mbeti si monumenti më i rëndësishëm i prozës së kohës së Augustit. Tit Livit (59 para erës së re deri me 17 era e re) lindi dhe u rrit në qytetin e lashtë Patavia (Padova e sotme). Në kohën e luftës civile në mes të Cezarit dhe të Pompeut, qytetarët e Patavias morën anën e senatit. Këto simpati republikane Livi i ruajti tërë jetën e tij. Ai himnizoi Pompeun duke përkrahur vrasësit e Cezarit, Brutin dhe Kasin.

Reformat dhe prirja e Augustit për të ringjallur zakonet e lashtë u pritën mirë nga Livi, që kërkonte të ruhejshin traditat. Duke e quajtur historinë "mësuese të jetës" Livi doli si historian tendencioz. Në veprën e tij historike ai deshi të paraqesë tërë virtytet, ndërgjegjen e lartë të detyrës qytetare dhe patriotizmin e të parëve.

Si letrar Livi vazhdoi traditat e prozës Ciceroniane, prandaj në një mesazh drejtuar të birit ai e porosit të lexojë Ciceronin dhe Demostenin si modele të mira të prozës.

Vepra që e bëri të njohur Tit Livin është monumenti historik "Qe nga themelimi i qytetit" një punë që zgjati dyzetë e pesë vjet. Ky është një parashtrim letrar i krejt historisë romake, që nga fillimet e saj mitologjike e deri në vitin 9 të erës së re. Nga tere kjo vepër vëllimore ka mbetur vetëm një e katërta.

Në veprën e tij ai parashtron me stil të bukur dhe

tërheqës njoftimet historike të historianeve të mëparshëm, pa sjellë në to ndonjë notë origjinale. Livi qëndron mbra- pa Tuqididit, Polibit madje dhe Salustit në të kuptuarit e ngjarjeve historike. Ai kishte përgatitje të përcipte në problemet politike dhe ushtarake.

Sipas Tit Livit ngjarjet historike përcaktohen nga cilësitë morale të popullit dhe të burrave të shtetit. E kaluara duhet t'i shërbejë njerëzimit si pasqyrë e gjallë shembujsh të mirë ose të këqinj. Rendësi të veçantë ai i kushtonte problemit moral si forcë lëvizëse e shoqërisë. Prandaj në hyrjen e vepres së tij autori porositi lexuesin t'u kushtojë vemendje të veçantë "zakoneve", domethënë fi- gurës morale të masave të popullit dhe të burrave të shtetit në periudha të ndryshme të historisë romake. Cilësitë e larta të të parëve, patriotizmi dhe dashuria për liri, bu- rrëria dhe vetëmohimi, bujaria dhe thjeshtësia, të gjitha këto e rritën shtetin romak, kurse prishja e zakoneve u bë shkak i turbullirave qytetare. Kjo është ideja themelore që përshkon tërë veprën historike të Livit. Gjunjzimi i saj ka bërë historianin romak të idealizojë lashtësinë e popullit të tij.

Idealizimi i së kaluarës është një shprehje e mbyllur e pakënaqësisë së autorit ndaj rendit në fuqi. Krahas kë- saj "virtytin romak", Livi e vë përballë cilësive negati- ve të popujve të tjerë, mendjelehtësisë së grekërve dhe galëve, pabesisë së kartagjenasve dhe etruskëve.

Stili i Tit Livit është i këndshëm dhe emocionues. Një bukuri të veçantë i japin atij fjalimet, që ishin element i rëndësishëm për historiografinë antike. Fjalimet e shumta nuk e pengojnë rrjedhën e naracionit; ato ndihmojnë për të karakterizuar personazhet historike si dhe për të sqaruar situatat politike e pikëpamjet e këtij ose atij grupi so- cial. Fjalimet nuk janë origjinale, por të krijuara nga ve- të Livi. Figurat historike të të gjitha periudhave jo vetëm që flasin me stilin e Livit, por shprehin mendime dhe ndje- nja që janë të kohës së Augustit. Duke dashur të ndikojë jo vetëm në mendjen, por dhe në ndjenjat e lexuesit, ai, ashtu si Salusti, jep karakteristika artistike me një stil që e bëjnë Livin një tregimtar tepër tërheqës dhe një orator të shkëlqyer.

Historiani romak Tit Livi përpiqet t'ua përshtatë sti- lin fakteve të ndryshme sipas kohës kur kanë ndodhur; kë-

shtu librat e parë kushtuar Romës së lashtë përbukonin nga një kolorit i lehtë arkiak nga pikëpamja gjuhësore. Në përgjithësi kritika antike, e çmtoi Livin. Ajo vuri në dukje "pastërtinë" dhe "gjuhën e embël" të Livit dhe e krahasoi atë me Herodotin. Edhe në kohën e Rilindjes ai u çmua shumë. Por duke filluar nga fundi i shekullit XVII kritika historike nisi të zbuloje te metat shkencore të veprës së Livit. Sidoqoftë ky mbeti edhe për një kohë të gjatë model i historiografisë antike dhe burim i rëndësishëm për informatat mbi periudhën republikane. Shkrimtarët evropianë janë mbeshtetur shumë në jetëshkrimet paralele të Plutarkut dhe në historinë e Livit.

## Kreu IV

### ZHVILLIMI I LETËRSISE ROMAKE NE SHEKULLIN I

#### DHE II TË ERËS SË RE

#### 1. SHOQERIA ROMAKE DHE KULTURA NE SHEKULLIN I

Struktura e perandorisë së krijuar nga Oktavian Augusti qendroi me tepër se 200 vjet që nga vdekja e themeluesit të saj deri në krizën e shekullit III. Diktatura ushtarake ishte e vetmja formë shtetërore, me të cilën shoqëria antike, e brejtur nga kontradiktat e skllaverisë, mundi ta zgjatë jetën e saj pas rënies së sistemit republikan. Nëse Augusti u përpoq t'i maskojë deri diku format e sundimit autokratik, pasardhësit e tij ishin hapur tenderat e sundimit despotik. Në këto kushte kushdo i kishte humbur shpresat për t'u kthyer ndonjëherë në rendin republikan. Sundimi i perandorëve të parë nga dinastia e Augustit, e Tiberit, e Kaligules, e Klaudit, e Neronit, ishte e mbushur me intriga dhe krime të përgjakshme kundër opozites që kërkonte të ruante autoritetin e senatit dhe lirinë e dikurshme. Në këto kushte pakenaqësia e shtresave të gjera të popullit ishte shtuar edhe më tepër, por rralëherë shperthente hapur; vetëm kryengritjet e popujve të nenshtruar e prishnin herë pas here "qetësinë" e brendshme të perandorisë.

Në të vertetë shteti romak nga ana e jashtme kishte arritur shkëlqimin e tij më të madh në shekullin I të erës së re. Roma tani ishte shtrirë shumë edhe në tokat rreth Renit dhe Danubit, në Britani, në brigjet veriore të Afrikës. Italia në këtë kohë u bë një qender e rëndësishme e tregtisë mesdhetare duke ruajtur mbi tërë perandorinë prioritetin ekonomik. Nga të gjitha anet e perandorisë derdhehin tani në Romë pasuri të mëdha, prodhime të ndryshme, para, deri dhe përfaqësues të shquar të kulturës. Numri i

sklleverve sa vente e rritej me tepër . Për të pre-  
rë rrugën e abuzimit dhe të përvetësimit të pasu-  
rive të provincave nga ana e nepunësve romake, qendra i-  
ndërronte çdo vit magistratet që administronin provincat  
dhe me anën e nepunësve burokrate e të stervitur për asi-  
punesh nisi të shfrytëzojë në mënyrë edhe me të organizuar  
se më parë e sistematikisht pasuritë e këtyre provincave.

Ne keto kohe zgjerohet shumë rjeti i rrugeve për të  
komunikuar me provincat dhe popuj të ndryshëm. Perandoria  
kishte marrëdhënie tregtare edhe me vende shumë të largëta,  
si Kina dhe Hindia, që sillnin në Itali sende zbukurimi, gu-  
rë të çmuar dhe mëndafsh.

Por, krahas lulëzimit të jashtëm të shtetit romak,  
shumë shpejt filluan të duken edhe simptomat e dekompozimit  
të afert të sistemit skllavopronar. Procesi i gëlltitjes së  
ekonomive të vogla nga të mëdhatë, që kishte shqetësuar Ro-  
mën qysh nga koha e Grekerne, në periudhën e perandorisë ma-  
ri përpjesëtime edhe më të gjera. Shpërndarja e tokave par-  
tizansve veterane të Cezarit dhe të Augustit si dhe masat e  
tjera që u moren për të përkrahur pronërit e vegjël mundën  
vetëm ta ngadalësonin këtë proces, por jo ta eliminonin. Në  
kohën e perandorisë u duk qartë se pronat e vogla mbi token  
nuk kishin si t'i shpëtonin procesit të shkatërrimit të ty-  
re dhe të koncentrimit në latifondet e mëdha. Si pasojë e  
kësaj filloi braktisja e vendbanimeve fshatare (sidomos në  
Italine e Mesme dhe të Jugut) dhe rritja e elementëve parazi-  
te në qytetet e mëdha.

Engelsi në veprën e tij "Bruno Baueri dhe kristianiz-  
mi i hershem" lidhur me këtë thotë se popullsia gjithnjë e  
më shumë po diferencohet duke u ndarë në tri klasa, që  
përbëheshin nga elementet dhe kombesite më të ndryshme :  
te pasurit, që ishin pronarë të mëdhenj tokash dhe fajde-  
xhinj, ose të dyja së bashku; së dyti ishin qytetaret " e  
lire" të varfër, (në Rome këta i ushqente shteti, sepse  
ishin të papunë, ndërsa në provincat duhej të interesoheshin  
vete për bukën e gojës) dhe më në fund ishte klasa që  
formohej nga nje masë shumë e madhe skllëvërisht. Në raport  
me shtetin, domethënë me perandorin, që sundonte si despot  
dhe ishte absolut në çdo pikëpamje, dy klasat e para ishin  
pa të drejta, gati-gati siç ishin skllëverit në raport me  
padronet e tyre. Veçanërisht në periudhën që nga sundimi i  
Tiberit e deri të Neroni u bë gje e zakonshme që romakët

e pasur t'i denonin me vdekje për t'u rrëmbyer pasurinë.

Krahas renies së madhe ekonomike të Italisë, që nisi të duket qysh në shekullin I të eres së re, nisi të nxjerrë kokën dhe degjenerimi social dhe moral i shoqërisë romake. Ashtu siç thotë Engelsi në veprën e lartpërmendur, njerezit duke humbur çdo të drejtë dhe shpresë për mundësinë e një rendi më të mirë, u kapën nga një fare apatie dhe demoralizimi. Humbi interesi i dikurshëm për problemet politike dhe shoqërore, që bënin të gjallërohej forumi romak. Njerezit nisnin ta shikojnë jetën nga një prizëm i ngushtë egocentrik, ta gjejnë kuptimin e ekzistencës së tyre në kërkim të pasurisë dhe të argëtimit ndiesore, në shpifje dhe intriga. Kurse masat parazite të Romës, sipas shprehjes së satirikut Juvenal, kërkonin "vetëm buke dhe çhfaqje" dhe të dy kërkesa. Pushteti perandorak ishte i interesuar që ta mbante me bukën e gojës dhe me argëtimit këtë masë të gjerë parazite të lumpenproletariatit, me qëllim që ta paralizonte politikisht dhe të shuante tek ajo çdo mundësi për revoltë, ashtu siç shuante urtësinë e saj. Në atë kohë u ndërtuan shumë cirke dhe vende të tjera defrimi ku jepeshin shfaqje me egersira dhe me gladiatorë. Të gjitha këto bëheshin për të larguar vëmendjen e popullsisë nga problemet politike dhe shoqërore. Servilizmi, rendja pas të mirave materiale, renia e ndjenjave sociale, paqëndrueshmëria e marrëdhënieve në familje, beqaria dhe ulja e theksuar e lindjeve - të gjitha këto veçori karakteristike të shoqërisë romake të shekullit I era e re. Kjo renie e përgjithshme shoqërore e morale është vënë re gjatë historisë gjithnjë në shoqëri me klasa antagonistë në kufijtë e kalimit nga një formacion në një formacion tjetër ekonomik. Një gjë e tillë përsëritet në kushte të tjera historike, edhe sot në shoqërinë borgjeze kapitaliste, në periudhën e degjenerimit dhe të krizës me të madhe ekonomike dhe ideologjike të saj.

Në të gjitha fushat e ideologjise dhe të shkencës vërehet re një renie e theksuar. Filozofia, e cila nuk ka qenë kurrë e fortë dhe e pavarur në Romë, u zhvillua gjithnjë e më shumë në drejtimin e saj idealist. Filozofia jo vetëm që nuk luftoi kundër bestytive, por edhe i përkrahu ato. Filozofët romakë hoqën dorë nga problemet teorike dhe e kufi-



zuan veprimtarinë e tyre ne fushen e etikës. Ne periudhën e luftes se perandoreve me senatin, ideali stoiko-epikurian për të përballuar me qendrese pasive, me stoicizëm, çdo te keqe dhe për të për buzur te mirat e jetes, ideali i predikuar nga filozofet dhe moralistet e Romës - i sherbente rendit në fuqi. Filozofet u bënë apologjete te perandorise dhe përpunuan teorine e monarkut "te vertete", qe është "sherbetor" i shtetit. Por shumë nga këta filozofë, si Seneka etj., ndryshe predikonin dhe ndryshe vepronin në jeten e tyre personale, dhe kjo i diskreditoi ata në sytë e masave te gjera të popullit.

Retorika nga ana formale u zhvillua mjaft, sepse me "argumentimet" e saj të stërholluara duhej t'i sherbente pushtetit perandorak për të mbuluar plagët e perandorisë.

Zhvillim te madh arriti nga ana e jashtme arti. Ne te vertetë përmbajtja e ketij arti ishte pa ide dhe shumë e varfër. U ndertuan vepra madheshtore arkitekturore, kolona dhe harqe triumfi te jashtëzakonshme, statuja kolosale prej tridhjetë metrash, si ajo e Neronit. Karakteristike ishte prirja për sa më shumë detaje dhe ngjyra te forta. Raporti i harmonishem midis se teres dhe pjesës, karakteristik për stilin klasik, këtu zhdukej fare. Nje hap përpara shenoi portreti ne pikturë dhe skulpture për sa i takonte shprehjes se botes se brendshme.

Periudha nga vdekja e Augustit (viti 14 era e re) deri nga fundi i sundimit te Trajanit (viti 17) është bërë zakon te quhet "shekulli i arte" i letersise romake. Letërsia e kësaj periudhe qëndron shumë larg nga problemet aktuale. "Qender letrare dhe kulturore e gjithë perandorisë mbeti gjithnjë Roma, qe ndikonte me shijet e saj, madje edhe ne boten greke. Ndryshimet qe ndodhen ne jeten shoqërore te Romës pas vendosjes se perandorisë ndikuan ne tematiken e letersisë. Tema politike e humbi rëndësi qe kishte ne shekullin e fundit te republikes dhe në Kohen e Augustit: madje mund te thuhet se ajo u zhduk fare me mbarimin e luftes midis senatit dhe perandoreve. Veprat e letërsise së kesaj periudhe ne shumicen e rasteve futen ne boten e fantazisë.

Karakteristike tjetër e letersise se kesaj periudhe ishte stili deklamativ retorik, i cili synonte te përftonte nje patos, qe fshinte varfërinë e përmbajtjes. Nje frymë deklamative pati sidomos drama, e cila nuk i kushtonte aq

rendesi përmbajtjes sa efektive skenike. Shfaqjet teatrale ishin të mbushura me krime gjithfare llojesh, me vrasje, djegie, egersira që shqyejne njerez etj. Letersia e zhveshur nga përmbajtja politike dhe sociale u zhvillua kryesisht në një tematike të ngushtë të jetes private, individuale. Përshkrimi i interesave të vogla personale, i vilave, gostive, shfaqjeve etj. zinte vend të madh tani në letersinë romake.

Letërsia u bë një fushe magnetike, që tërhoqi jo vetëm shkrimtarë të sprovuar, por edhe shumë forca diletan-te nga rrethet e larta të shoqërisë romake. Gata të gjitha perandoret shkruan vepra në vargje dhe në proze.

Në arenën e letërsisë u duken edhe shumë shkrimtarë me prejardhje nga provincat romake. Veçanërisht nga Spanja, provinca më me kulturë nga provincat e tjera të romanizuara, dolën një radhe shkrimtarësh të njohur, si Seneka, Llukani, Kuintiliani, Marciali etj. Llojet letrare, tipike për këta shkrimtarë, kanë qenë epigrami, tragjedia, fabula, satira demaskuese dhe romani me probleme të jetes së përditshme.

#### SENEKA

Luc Annei Seneka (4 para erës së re - 65 era e re) lindi në Spanjë, në qytetin Kordove dhe u rrit në Romë. Mori arsim në retorikë dhe në filozofi. Sukseset e tij si orator ndezen ziline dhe terbimin e perandorit Kaligula, që nuk mund ta duronte lavdinë e të tjerëve. Kaligula dha urdher që ta vrasin Seneken, por hoqi dorë nga mendimi i tij dhe u zbut kur e siguruan se Seneka edhe kështu do të vdiste shpejt, sepse ishte i sëmurë.

Kur erdhi në fuqi Neroni i cili para se të bëhej perandor kishte qenë nxenes i Senekes e mbuloi atë me ndere e pasuri. Dhe, në të vertetë udheheqesi i perandorisë në vitet e para të sundimit të Neronit, që Seneka.

Seneka u bë përfaqësues i filozofisë së stoicizmit, e cila në një farë mënyre u bë shprehje e veçante e ideologjive së kastes aristokratike të shoqërisë. Ai predikonte virtytin, filozofinë e përsosmërisë morale dhe të përmbajturit në pasionet e ndryshme. E tërë kjo ishte në frymën e filozofisë stoike, parimet e së cilës hynë, si pjesë përbërëse, në dogmën e krishtianizmit. Por morali stoik, që Seneka predikoi si në traktatet filozofike ("Mbi zemërimin",

"Mbi veprat e mira", "Mbi humanitetin" etj., ashtu dhe në tragjeditë e tij, nuk e penguan atë të shfrytëzojë të gjitha të mirat e jetës dhe ta rrethojë veten me një luks përrallor. Madje, më vonë, bashkëkohësit e akuzuan si njeri që kishte grumbulluar për një kohë të shkurtër një pasuri shumë të madhe, që arrinte në treqind milionë sesterca. Ndofta për t'iu përgjigjur këtyre akuzave Seneka shkroi traktatin "Mbi jetën e lumtur" ku trajtohet problemi i qendrimit të filozofit ndaj pasurisë.

Seneka zhvilloi një veprimtari të gjerë letrare e filozofike. Krahas veprave me karakter shkencor shkroi dhe vepra poetike: epigrame, satira, tragjedi.

Pikëpamjet filozofike të Senekës nuk janë konsekuente e të qendrueshme. Duke e quajtur veten ndjekës të Stoit, Seneka nuk e quan të domosdoshme t'i përmbahet një drejtimi të caktuar, prandaj shumë gjëra i merr edhe të antagonistit i Stoit, të Epikuri. Epikurizmin ai e merr si pretekst për t'iu larguar nga jeta politike dhe për t'iu futur në jetën private. Në këtë frymë i shkroi traktatet "Mbi prehjen e shpirtit", "Mbi pushimin".

Filozofinë e quan "ilaç të shpirtit". Ajo e mëson njeriun si të jetojë dhe si të vdesë, i siguron atij pavarësi në shpirtërore dhe qetesinë. Krahas problemeve të botes shpirtërore dhe të moralit, që zene vendin kryesor në kerkimet filozofike të Senekës, ky u interesua dhe për problemet e natyrës, por edhe këto ai i pa nga prizmi fetar dhe etik, si mjet për të njohur perëndinë, që është shkrirë dhe bërë një me natyrën. "Ç'është perëndia?" - pyet ai, dhe përgjigjet vetë: "Shpirti i gjithësisë".

Përsa u takon pikëpamjeve politike ai qendron i vendosur në anën e perandorisë dhe nuk mund të përfytyroje tjetër rend shtetëror përveç perandorisë.

Në fushën e ideve shoqërore Seneka i quan të gjithë njerëzit të barabartë. Sklleverit i quan "shok", "miq" "njerëz" si të gjithë të tjerët. Por "turmen" e ka frikë. Shumë kuptimplote për të parë kontrastin midis predikimeve dhe praktikës personale të Senekës janë mendimet e tij mbi pasurinë. Ai himnizoi thjeshtësinë e zakoneve dhe gëzimet e njerëzve të varfër dhe nuk kursen fjalë për të denuar teprimet dhe luksin e pasanikeve. Sipas Senekës njeriu i urte "nuk e dashuruan pasurinë, por e parapëlqen

midis te tjerave", nuk i jep shpirtin asaj, por e pranon ne shtepine e tij, e fiton atë, por nuk bëhet skllav i saj". Detyra e njeriut te urte, filozof është të mos e refuzoje pasurine, por te dije kur është e nevojshme te heqe dore nga ajo dhe te mos vuaje kur ta humbasë.

Kuptohet se kjo filozofi u sherben klasave ne fuqi, sepse ajo justifikon çdo mjet kur është puna për të vënë pasuri. Edhe doktrina e pajtimit me fatin është po aq regressive. Seneka meson se njeriu duhet t'i duroje mungesat, te munde pasionet dhe ngasjen. "Gjithe jeta e njeriut duhet te jete nje përgatitje për vdekjen". Për këtë arsye kristianizmi mori shumë teza nga etika stoike e Senekes, dhe autorët kristiane te pjesëve perendimore, te perandorisë qe shkruan ne gjuhen latine, e citojne Seneken me simpati.

Vete Seneka pranon se nuk e ka pasuruar filozofine me ndonje përmbajtje të re. "Ilaçet për shpirtin janë gjetur nga te vjetrit, neve na mbetet vetëm te vendosim dhe kur duhet t'i përdorim ato".

Veprat me te mira, qe shprehin ne mënyrë të plotë pikëpamjet e autorit janë "Letrat morale drejtuar Lucilit", qe kerkon te përsoset. Seneka jep nje sere mesimesh, duke u nisur nga praktika jetesore e tij, si duhet te arrije njeriu te përkryejë vetveten. Kës formë me pyetje e përgjigje përdor autori edhe ne traktin "Mbi prehjen e shpirtit". Seneka i largohet tipit klasik te dialogut filozofik dhe përdor me shumë formën e diatribes dhe te polemikes me nje oponent te imagjinuar. Ashtu si shumices se bashkekohesve te tij edhe Senekes i pëlqejne ngjyrat e gjalla dhe mjetet afektive, sugjестive.

Afektet dhe anen patetike i takojmë edhe ne tragjedine e Senekes. Ne pjesët e tij autori romak është mbështetur mjaft ne përvojen dhe në subjektet mitologjike te tragjedise greke dhe romake, qe u zhvilluan me Euripidin e këndeje. Qe nga kjo kohe tragjedia atike greke filloi te prirej nga patetika e botes se brendshme dhe nga stili deklamativ. Me një stil te tillë janë shkruar ne përgjithesi edhe tragjedite e Senekes. Ky ruajti format e jashtme te tragjedisë klasike greke: monologet dhe dialogoget, kombinimin e alternuar te vargjeve me pjesët lirike korale. Ne dialogoget, ashtu , si me parë, nuk veprojne me shumë se tre personazhe, (tre aktore). Seneka

ruajti edhe subjektet mitologjike, qe përpunuan ne kohen e tyre klasiket e tragjedisë greke. Ai përsëri shkroi tragjedite "Medea", "Fedra", "Herkuli i çmendur", "Edipi" etj. Por ne keto vepra poeti romak solli ndryshime nga pikëpamja e strukturës dhe e trajtimit te heronjve. Kështu p.sh., tek "Medea" e Euripidit heroina e dramës e urren atë qe e genjeu aq keq dhe qe u martua me nje tjetër. Ndersa Medea e Senekes mundohet ta kthejë përsëri Jazonin, te cilit i propozon te arratisen. Tek Euripidi Jasoni paraqitet egoist i ulet, ndersa Seneka na e ka dhene ate te lodhur e te dërmuar shpirtërisht, qe e ndjen fajin qe ka bere. Vetem dashuria për fëmijët e mban atë ende ne jetë.

Ne krahasim me "Medean" e Euripidit tragjedia e Senekes është thjeshtësuar. Idete dhe kritika kunder moralit tradicional ne familje, qe dalin ne tragjedine e Euripidit, për Seneken nuk janë aktuale. Seneka, si filozof-moralist, nënvizon tmerrin e krimin e Medeas, e cila lëshohet në krahët e një pasioni të çmendur; qëllimi i autorit është të sjellë në tragjedi moralin stoik, që e mëson njeriun t'u qëndrojë larg pasioneve. Ato janë lënë mënjane dhe nuk janë zgvendësuar me ndonje problematike tjetër. Edhe figura e Medeas është thjeshtësuar tepër. Ndersa Euripidi na ka dhene dramën e gruas se genjyer qe ndodhet ne nje lufte motivesh, deri sa e gjen rrugen nga duhet te shkoje, Seneka tërë vemendjen si autor e përqëndron ne mjetet qe kerkon Medea për nje hakmarrje sa më të tmerrshme. Këto janë veçori karakteristike për tërë krijimtarinë dramaturgjike të Senekës. Tragjeditë e tij nuk ngrenë probleme dhe as nuk zgjidhin konflikte. Si dramaturg i periu-dhes se perandorisë romake, si filozof stoik, ai e percepton boten si nje fushe, ku vepron verberisht fati i pamëshirshëm, te cilit njeriu mund t'i kunderve vetëm qendresën e tij shpirtërore, gatishmerine për të duruar gjithçka ne mënyrë stoike, e ne rast nevojë edhe për te mbaruar stoikisht. Ne këtë mënyrë mbaroi edhe vetë Seneka ne vitin 65 te erës së re, kur Neroni, i cili kishte filluar ta urrente tepër, gjeti shkakun e vullqshem për ta hequr atë nga skena atëherë kur u zbulua i ashtuquajhuri komplot i Pisonit. Seneka mori urdher nga Neroni t'i japë fund jetës. Sipas Tacitit Seneka e vrau veten me vendosmeri te plotë e në mënyrë stoike.

Veprat filozofike te Senekes hedhin edhe me tepër dritë mbi qendrimin e tij ndaj botes. Në traktatin "Mbi prehjen e shpirtit" ai bën një pyetje te tillë: "A duhet te hidhërohem për mbarimin fatkeq te njerëzve të mirë? Përgjigjja: në qoftë se ata mbaruan burrërisht nuk duhet të hidhërohem, por duhet t'i urojmë vetvetes një vendosmëri të tillë. Në qoftë se ata nuk u treguan te fortë në vdekje, ata nuk janë aq të çmuar sa të na dhimbsen.

Kjo etikë e Senekës lidhet me qellimin final te filozofisë së tij: të edukojë njeriun të ruajë qetësinë e shpirtit. Ky do të ishte edhe qëllimi i jetës. Është e qartë se nje etikë e tillë në thelb është reaksionare, sepse të largon nga çdo revoltë kundër së keqës dhe të bën të nënshtruar. Zaten vetë Seneka predikonte se virtyti qendron në nënshtrimin ndaj domosdoshmerisë. Prandaj dhe kristianizmi mori shumë nga doktrina e tij. Jo vetë, por përmes tij u ndikuan nga stoicizmi edhe shkrimtarë e poetë të kohërave te ndryshme, si Korneji, Rasini, Alfred de Vinji etj.

## 2. POETE TË TJERË TE SHEKULLIT I TË ERËS SË RE

Nga shekulli i parë e tutje poezia u zhvillua shumë. Me të tani merren jo vetëm poetë te afirmuar, por edhe diletante. Edhe vetë perandori Neron shkroi poema dhe kjo i bëri shumë letrarë te kohës të shpresojnë në favore nga ana e tij; kështu që levizja poetike u gjallërua shumë. U bënë përpjekje të ripërtëriheshin ato gjini letrare që lulëzuan në periudhën e Augustit. Poetët bukolikë nisen të himnizonin ardhjen e nje shekulli tjetër "te artë".

### MARK ANES LUKANI

Mark Anes Lukani (39 - 65 te erës sonë) është një nga poetët e kësaj kohe, që shkroi shumë, por nga tërë vepra e tij është ruajtur vetëm eposi i pambaruar historik "Mbi luftën civile" (ose "Farsalia"). Subjekti i poemës është lufta e Cezarit me Pompeun, që solli shkatërrimin e republikës. Lukani parashtroi në mënyrë sistematike ngjarjet kryesore të kësaj lufte duke filluar nga koha kur Cezari kaloi lumin Rubikon, paraqet betejën e Farsales,

vrasjen e Pompeut dhe të Katonit të ri. Poema këputet me episodin e ardhjes së Cezarit në Egjipt dhe me kryengritjen e banorëve të Aleksandrisë. Në poemë ngjarja kryesore është lufta vendimtare në Farsalë.

Nga ana ideologjike dhe artistike poema e Lukanit i afrohet shumë veprës së Senekës. Ajo është shkruar me një stil të ngritur patetik dhe deklamativ, dhe përshkohet nga idetë e filozofisë stoike. Qysh me "Eneiden", si forcë lëvizëse e ngjarjeve u paraqit fati, megjithatë Virgjili e ruajti traditën mitologjike të eposit të lashtë duke paraqitur edhe perënditë. Lukani shkëputet nga tradita homerike dhe virgjiliane, duke i përjashtuar perënditë "olimpike" si fuqi që marrin pjesë në ngjarjet. Ngjarjet, sipas atij, i drejton "fati", e thena.

Duke hequr dorë nga mitologjia greke Lukani e quajti veten poet origjinal dhe pretendoi një lavdi si ajo e Homerit, ndërsa Virgjilin as që e përmend fare.

Në poemën e tij ai e ul tepër figuren e Cezarit dhe idealizon atë të Pompeut dhe të Katonit të ri, si përfaqësues të republikanizmit. Lukani tërthorazi ka synuar të bëjë aluzion për Neronin, si tiran gjakatar. Por, në se në pjesën e parë të poemës është përpjekur të jetë i vëmendshëm dhe t'i shprehë idetë në mënyrë diplomatike, në pjesën e dytë i shpreh në mënyrë të prerë e të qartë. Kështu, ai shpreh dhimbjen se pas betejës në Farsalë liria e braktisi për gjithmonë Romën, se Roma në jetë të jetëve u përmbys në pluhur, se romakët qysh nga ajo kohë janë bërë skllëvër të sundimtarëve. Dhe tërë shprehën poeti e ka vënë te Brutit; i cili duhet ta vrasë Cezarin, duke nënkuptuar kështu Neronin. Biografit e lashtë të poetit flasin për ngrindjen midis Lukanit dhe Neronit. Neroni e ndaloi poetin ta vazhdonte poezinë jo vetëm nga që e kish zili lavdinë letrare të tij, por edhe sepse e kuptoi opozitën republikane të autorit, që i kundërvihej pushtetit të tij. Lukani, mori pjesë në besëlidhjen e Pizonit dhe kur besëlidhja u zbulua u detyrua të presë damarët. Poeti gezoj famë që në antikitet. Veprën e tij e lexuan dhe e komentuan në shkollë, por poema e tij tërhoqi vëmendjen sidomos në periudhën e revolucioneve borgjeze në Angli dhe në Francë. Në atë kohë ajo u quajt si manifest i republikanizmit dhe i urrejtjes ndaj despotizmit. Dantja në kohën e tij e çmoi shumë

Lukanin.

### AUL PERS FLAKU

Aul Pers Flaku (34 - 62 era e re) është një nga poetët e kohës së Neronit, ndjekës i filozofisë stoike, mjaft e për-

hapur midis skllavopronarëve të mëdhenj të shekujve të parë. Ndjekësit e filozofisë stoike, në predikimin e moralit dhe të përkryerjes shpirtërore shikonin një nga mjetet për ndreqjen e shoqërisë së degjeneruar antike.

Pers Flaku shkroi "satira" dhe e quante veten vazhdues të Lucilit dhe të Horacit. Por ndërsa Horaci në satirat e tij të para, mundi ashtu si Lucili të godasë personalitetet e veçanta, atmosfera politike e kohës së Neronit lejonte vetëm një satirë të përgjithshme filozofike. Vetëm e para nga të 6 satirat e Aul Persit, kushtuar problemeve të letërsisë, dallohet për një konkretësi më të madhe. Në këtë satirë Aul Persi shpreh protestën e tij kundër poezisë pa ide, kundër atyre poetëve që rendin pas formës së bukur të veprës. Poeti kritikon poezinë e fryrë e pa përmbajtje, poetët deklarativë dhe epigamë të aleksandrizmit, nga prireshin dhe shumë diletantë aristokratë, midis të cilëve dhe Neroni. Temat e satirave të tjera kanë karakter të përgjithshëm etik: mbi vetënjohjen, mbi lirinë e vërtetë, mbi dobinë e filozofisë etj. Sidoqoftë, edhe në këto satira, pavarësisht nga karakteri i përgjithshëm i tyre gjejmë shumë skicime nga jeta, shumë digresione medituese, që flasin për shqetësimin e sigurtë të poetit, për zemërimin e tij ndaj veseve dhe shëmtimit moral të majës së shoqërisë romake Engelsi, duke vlerësuar në mënyrë negative filozofët e Romës të shekujve të parë të erës së re, vlerëson pozitivisht veprimtarinë e Aul Pers Flakut: "Vetëm shumë të rrallë nga filozofët, si Persi, i dermuan me fshikullin e satires bashkohësit e tyre të degjeneruar.

### GAJ PETRONI

Gaj Petroni ka jetuar në shekullin I të erës së re. Vepra e tij e njohur është romani

"Satirikon" shumë i gjerë, i shkruar në

prozë që alternohet me vargje. Nga të 20 librat e tij kanë mbetur vetëm libri i 15 dhe i 16 e disa fragmente. Romani "Satirikon" na jep një tablo të gjerë të jetës së shoqërisë romake të kohës. Në veprë gërshetohen aventurat e dashurisë me shtëgtime e aventura të tjera. Në pjesën që njohim, tre-



gimi bëhet në veten e parë nga heroi që quhet Enkolpi. Ky është përfaqësues i deklasuar i shoqërisë së lartë romake, që është bërë vagabond dhe vrases. Enkolpi dhunon një tempull, grabit një vilë, bëhet gladiator. Fati e hedh atë nga një qytet në tjetrin, nga një fatkeqësi në tjetrën. Sipas traditës së poemave antike edhe kështu heroin e ndjek këmba këmbës zemërimi i perëndisë.

Petroni në këtë roman ka vizatuar me ngjyra të gjalla e me realizëm një radhë procesesh të rëndësishme në jetën shoqërore të kohës: diferencimin e madh shoqëror, renien ekonomike të Italisë, korrupsionin moral, përhapjen e feve të Lindjes, dekadencën e arteve. Autori thekson në roman se çdo gjë vlerësohet me para, prandaj nuk ka e nuk mund të ketë drejtësi, as pasterti marrëdhëniesh shoqërore, as nderim të njeriut ndaj njeriut. Në kushtet e një realiteti të tillë ai mban qëndrim skeptik dhe gati për buzës ndaj shoqërisë së kohës. Ai e sheh se rreth e rrotull sundon padrejtësia, pushteti i parësë, para së cilës janë të pafuqishme dhe ligjet. Persa u takon hyjnive Petron u përmbahet pikëpamjeve epikuriane: "hyjnitë i ka krijuar frika."

#### FEDRI

Fedri ka jetuar në shekullin I të erës së re. Ka qenë skllav i liruar. Lindi në Maqedoni, por që kur ishte i vogël u njoh me kulturën romake dhe me gjuhën latine. Duke filluar nga vitet 20 të shekullit të parë të erës së re Ferdi botoi pesë përmbledhje me titull "Fabula të Ezopit". Siç dihet krijimtaria fabulistike në Greqi iu atribuua Ezopit, rreth të cilit u krijuan legjenda dhe shumë anekdota. Fedri mori subjektet ezopiane dhe i përpunoi në gjuhën latine duke ia përshtatur realitetit të kohës së tij. Karakteri origjinal i fabulave të Fedrit qëndron në faktin se ky i pasuroi këto me përvojën e jetës romake.

Fedri është poet plebe. Në shoqërinë romake vetëm ai mund të merrej me një gjini "të ulët", siç e quanin shtresat e larta fabulën. Fedri mendon se fabula është krijuar nga skllavërit, të cilët nuk kanë guxuar të shprehin lirisht ndjenjat e tyre, prandaj kanë qenë të detyruar të shpikin këtë formë gazmore alegorike.

Elementi i satirës shoqërore duket më i theksuar në dy përmbledhjet e para të fabulave, ku levizin si personazhe figurat e kafshëve. Zgjedhja e subjekteve dhe mo-

rali që nxjerr autori nga ato dëshmon qartë për tenden-  
cën e tyre kundër klasave në fuqi. Shumë fabula, si "Ujku  
dhe qengji", "Lopa, dhia, delja dhe luani" etj. tregojnë  
se bashkëpunimi me "të fortët" është i pamundur, se grin-  
djet midis "të fortëve" rendojnë mbi kurrizin e të verbër-  
ve etj. Janë ruajtur rreth 120 fabula.

Kritika që i bëri Fedri shoqërisë romake nuk gjeti  
kushte të favorshme, përkundrazi, rrethet sunduese e pri-  
ten atë me zemerim dhe autorin e persekutuan për guximin  
e tij. Pas botimit të dy përmbledhjeve të para Ferdi shkroi  
fabula të tipit anekdotik, me një satirë naive e pa drej-  
tim të caktuar.

Fedri është mjeshtër në të treguar. Gjuha e tij është  
e ngjeshur e stili i tij i prerë e i ngjeshur. Por kjo  
prirje ndonjëherë ka bërë që fabula të jetë e thatë dhe  
morali i saj të mos dalë në mënyrë aq të natyrshme.

Fedri u bë i njohur më vonë e jo në kohën e tij.  
Vepra e tij mori rëndësi të veçantë nga fundi i shekullit  
XVI, në kohën e Rilindjes, kur forcat ~~parimitare~~ parimitare nisën  
të shikonin në fabulat e Fedrit kritikën e drejtë kundër  
së keqës. Ezopi në këtë kohë nisi të njihet përmes fabu-  
lave të Fedrit, ashtu si Fedri u bë i njohur në Evropë më  
tepër përmes La Fontenit. Nga ky i fundit i morën dhe i  
përpunuan fabulat në kohën e tyre fabulisti rus Krillovi  
Naimi dhe Çajupi, duke ua përshtatur kushteve shoqërore  
të vendeve të tyre.

### 3. PRIRJE KLASICISTE NË LETËRSI

Pas luftës politike midis qarqeve drejtuese të Romës  
dhe aristokracisë së senatit, që ishte në opozitë me perandorin, paran-  
doria e forcoi bazën e saj sociale dhe opozita e aristokra-  
cisë u dobësua.

Në këto kushte e predispozita shoqërore e politike  
në letërsinë romake nisi të duket një levizje letrare që  
synonte të ringjallte si model imitimi, në kundërshtim  
me "stilin e ri", veprat e prozatorëve dhe të poetëve kla-  
sikë romakë, kryesisht të Ciceronit dhe të Virgjilit.

Përfaqësues i flaktë i këtij drejtimi të ri klasicist  
ishte Mark Kuintiliani, (shekulli I i erës së re). Për të

mbrojtur tezat e tij në polemikë me "stilin e ri" Kuintiliani shkroi traktatin "Rreth shkaqeve të prishjes së retorikës". Ky traktat ka humbur, por nga Kuintiliani mbeti një traktat tjetër me titullin "Të mësuarit e oratorisë" që është një sintezë e përvojës së tij të gjatë si mësues i retorikës. Në këtë vepër autori flet për të gjitha etapat e oratorisë të ardhshëm, duke filluar që nga mosha e fëminisë. Prandaj, krahas problemeve të retorikës ai prek edhe shumë çështje me karakter pedagogjik. Kuintiliani nuk është as me stilin e ri, por as edhe me partizanët arkaistë të vëllezërve Grakë dhe të Katonit. Si model për t'u imituar ai rekomandon Ciceronin. Nga të 12 librat e këtij traktati rendësi të veçantë për historinë e letërsisë ka libri 10, ku autori flet për ata shkrimtarë që i shërbejnë më mirë oratorit në punën e tij.

Prirja e Kuintilianit për të ringjallur oratorinë e Ciceronit dhe "Eneiden" e Virgjilit në kushtet e reja politike dhe shoqërore ishte konservatore dhe anakronike. Madje, padashur, ajo i shërbente rendit në fuqi, sepse bashkë me gjinitë e mëdha klasike ishte e detyruar me doemos të ringjallte dhe një botë të tërë fantastike mitologjike, që ishte vënë në themel të veprave, si "Eneida" etj.

Edhe poeti i talentuar Publ Papin Staci, që jetoi në shekullin I të erës së re, talentin e tij e harxhoi kot, sepse deshi të ringjallë epopenë e lashtë. Ai shkroi poemën "Tebaida", sipas subjektit të njohur të "Të shtatëve në Tebë". Në këtë vepër autori është detyruar të përsëritë situata të njohura, duke u bërë kështu epigon i autorëve klasikë, që patën trajtuar këtë temë.

Në poemën e tij të dytë "Akileida" Staci gjen një fushë më të përshtatshme për talentin e tij. Duke trajtuar mitin për Akilin ai mundi të gërshetojë me një naracion të këndshëm elementin idilik me botën e brendshme të Akilit të dashuruar.

Famen si shkrimtar Staci e fitoi jo me poemat e tij mitologjike, por me vargje të improvizuara "me rast", të cilat nisën të bëhen shumë popullore qysh nga koha e Katulit, e sidomos në epokën e perandorisë, kur jetoi u bë më e nderlikuar. Këto lloj vargjesh i dhanë mundësi poetit t'u bëjë jehonë ngjarjeve dhe fakteve më të ndryshme të jetës shoqërore. Të tridhjetë e një vjershat Staci i quajti

"Silvae", pyje, lëndë. Poeti, mik i pasanikëve, vëmendjen e tij e përqëndroi në ngjarjet e jetës private vetëm të kastës së pasur, duke përshkruar herë vilat, herë përmendoret, festat etj.

Poetë të tjerë të drejtimit klasicist kanë qenë Valer Flaku, që përpunoi poemën e gjatë "Argonautika" të Apolonit nga Rodosi, dhe Sil Italiku partizan i flaktë i Virgjilit dhe i Ciceronit, që vuri në vargje tregimin historik të Tit Livit mbi Luftën Punike.

Të gjithë këta poetë të drejtimit klasicist jo vetëm që dhanë vepra pa ide e u bënë epigone e imitues të thjeshtë të klasikëve, por edhe në fushën e stilit ata nuk mundën të çlirohen plotësisht nga ndikimi i poezisë së "stilit të ri" kundër të cilit ata luftuan.

MARCIALI Forma më e vogël letrare, epigrami që sherbeu për të paraqitur në art ngjarje dhe detaje nga jeta e përditshme, gjeti të Marciali mjeshtrin e saj. Materiali është një nga epigramatistet më të shquar jo vetëm të letërsisë romake, por edhe të letërsisë botërore.

Mark Valer Marciali (40 - 104 era e re) ishte me origjinë nga Spanja. Kur erdhi në Romë gjeti përkrahjen e shkrimtarëve romakë me origjinë nga Spanja, si Seneka etj. Në vjershat e tij të shkurtra me humor e satirë të mprehtë e tallëse, e ndonjëherë mjaft tërëse, ai pasqyroi qëndrimin e tij ndaj jetës dhe shoqërisë së kohës.

Sidoqoftë Marciali nuk hyri në opozitë me regjimin, përkundrazi ai deshi të bëjë jetën parazitare të "klientelës", duke gëzuar favore dhe tutelë tek njësit me influencë. Është e vërtetë se ai shprehu mjaft të vërteta të hidhura kundër pasanikëve romakë, megjithatë mundësitë satirike të tij u kufizuan ngaqë ai ishte i varur nga protektorët e tij. Kur ishte rreth 40 vjeç, sepse Marciali nisi të shkruajë shumë vone, nxori veprën e parë me epigrame me titull "Libri i shfaqjeve", ku u thur lavde përleshjeve të egërsirave dhe të gladiatorëve. Veprën ia kushtoi perandorit Tit. Më vonë shkroi dhe vepra të tjera me epigrame.

Midis 1200 epigrameve që shkroi Marciali gjejmë dhe nga ato që nuk kanë karakter satirik. Kemi kështu epigra-

me të tipit tradicional në formë epitafesh, në tema gostie dhe miqësie etj..Një kategori tjetër përbëjnë epigramet që godasin profesione e karaktere, të meta fizike e morale. Në këtë drejtim poeti kishte një traditë të pasur letrare nga e kaluara dhe këtë e shfrytëzoi në mënyrë krijuese, duke dhënë figura karakteristike në rrethanat konkrete të jetës romake. Në epigramet e Marcialit leviz një galeri e tërë figurash, që poeti i gjen në jetën e përditshme: diletanti, që mundohet të bëjë gjithçka dhe asgje s'e bën saktë, simulanti që shtihet si i sëmurë, me shpresë se do të gjejë përkrahjen e miqve, servili, karrieristi, dorë-shtrenguari, lajkatari, dallaverexhiu, cmirëziu etj. Me shumë hije e drita poeti paraqet edhe vuajtjet, poshtërimet e zhgënjimet që pëson klienti, ashtu siç i provoi edhe vetë Marciali në jetën e tij.

Shumë epigrame u kushtohen temave letrare, polemikës me arkaistët, me poezinë erudite, me plagjiatet dhe diletantët pa talent. Duke mbrojtur epigramën si gjini të parapëlqyer prej tij, Marciali shpreh mendimin se kjo formë poetike nuk është kaq e lehtë siç e kujtojnë shumë. Në një nga epigramet me temë letrare ai thotë se në veprën e tij nuk do të gjejsh as gorgona, as kentaurë, as harpie e krije-sa të tjera fantastike, por vetëm jetën e gjallë:

Vetëm njeri mban erë vargu im.

Prirjet subjektive që e shtynë Marcialin të kërkojë një jetë të lehtë e penguan atë të hyjë thellë në dukuritë e jetës e të verë gishtin mbi plagët e shoqërisë së tij. Ai gjithnjë kalon mbi sipërfaqen e gjërave, nuk demaskon me forcë e nuk nxjerr konkluzione morale siç bënin poetët satirikë të lashtësisë. Sidoqoftë ai mbeti mjeshtër i shquar klasik i epigramës me artin e tij të hollë, plot kolorit e fantazi.

Epigramet e Marcialit i lexuan me endje në kohën e mesme dhe e çmuan shumë atë veçanërisht në epokën e Rilindjes dhe të Iluminizmit. Lesingu i quajti epigramet e Marcialit si modele të këtij lloji letrar.

Pothuaj se në një kohë me Marcialin ka jetuar dhe shkrimtari romak PLINI i RIU, që ishte nipi i Plinit Plak, autorit të "Historisë natyrore", që vdiq nga shpërthimi i Vezuvit në vitin 79 era e re.

Plini i Ri është autori i fjalimit "Panegjyrik kush-tuar Trajanit" dhe i "Letrave". Vepra letrare e tij përshkohet nga qëllime të hapura morale dhe është interesante për të njohur doket dhe zakonet e epokës.

### JUVENALI

Juvenali (55 - 140 era e re) u përpoq në fillim të gjejë mbrojtje në personalitetet e shquar romakë, por, më vonë, kur arriti një farë mirëqenie, siguroi një pozitë të pavarur.

La 16 satira në pesë libra, të shkruara të gjitha në periudhën e sundimit të perandorëve Trajan dhe Adrian.

Që në satirën e tij të parë Juvenali duke pasur parasysh realitetin romak, shpreh qartë programin e veprimtarisë së tij letrare kur thotë, se "është e vështirë të mos shkruash satira".

Vetëm nga një varg i njerës prej satirave të tij:

Dhe sikur të mos kesh talent, vargun e lind revolta, kuptohet se Juvenali hyri në arenë e letersisë si poet satirik demaskues.

Ashtu si Marciali, edhe Juvenali ve përballë gjiqëve mitologjike satiren, si gjini që kap "gjithçka që ka të bëjë me njerëzit : dëshirat, frikën, qejfet, gëzimet, zemërimin dhe përçarjen".

Ashtu si poeti romak Lucili dhe poetët e tjerë të lashtë që shkruan jambe therrëse edhe Juvenali do të kishte dashur të vinte në shenje të satirës së tij persona konkretë, por ai tregohet i vëmendshëm. Në një satirë të tij paraqet një njeri që e keshillon të jetë i kujdesshëm, sepse është punë me rrezik të zërë në gojë emra njerëzish të gjallë. Në kushtet e Perandorisë Romake metoda e Lucilit dhe e poetëve të tjerë satirikë të së kaluarës ishte e pamundur. Kështu që Juvenali gjen një rrugë shpëtimi; ai vepron me emrat e personave që kanë jetuar në kohën e Domicianit, madje edhe në kohën e Neronit. Megjithatë autori i satirave mundohet gjithsesi t'i bindë lexuesit e tij së vërtetë që satira e tij është vendosur në të kaluarën, shigjetat e saj i drejtohen së tanishmes.

Platforma e satirës së Juvenalit përshkohet nga ide përparimtare humaniste. Kritika e tij mbetet në sferën e kritikës kundër zakoneve dhe moralit të kohës.

Nga satirat e Juvenalit, sidomos nga ato të periudhës

së parë, që janë më të gjalla e të fuqishme, mund të krijohet një ide e qartë për dekadencën dhe krizën që jetonte atë kohë Perandoria Romake. Poeti tregon, se si nga dyndjet gjithnjë drejt Romës, banorët kanë shkatërruar qytetet me shpresë se do t'i shpëtojnë varfërisë; tregon konkurrencën e madhe që bëhet midis tregtarëve të huaj të ardhur në Romë dhe dyqanxhinjve romakë, që sa veng e shkatërrohen ekonomikisht.

Me figura të gjalla ai tregon gjendjen e mjeruar të poetëve, avokatëve, mësuesve të retorikës e të gramatikës etj., të cilët po të mos shesin ndergjegjen e kanë veshtirë të jetojnë.

Duke demaskuar regjimin despotik të perandorit Domician poeti rreh të godasë çdo lloj tiranie në pergjithësi. Në shumë satira ai fshikullon aristokracinë e degjeneruar, veset dhe luksin e saj të tepruar, ndersa fisnikërinë nuk e gjen në titujt dhe privilegjet e trashëguara:

Asgjëkundi nuk ka fisnikëri, përveç se në virtytet dhe pastërtinë e shpirtit.

Në veprën e Juvenalit shpesh tingëllon i fuqishëm zëri i shtresave jo të pasura të popullsisë italiane, të pakënaqura nga realiteti.

Në periudhën e dytë trajton kryesisht tema me karakter moralo-filozofik: flet për edukatën, për ndergjegjen dhe shqetësimet e saj, për dëshirat e frenuara etj. Kritika ndaj realitetit dobësohet dhe bëhet më e përgjithshme.

Juvenali me të drejtë është çmuar si një nga poetët më të shquar të satirës antike, si demaskues i mprehtë i aristokracisë dhe despotizmit.

Në kohën e mësonë interesi për veprën letrare të Juvenalit u përqëndrua më shumë në sentencat morale të disa satirave të tij. Ai u cilësua si "poet moralizues". Ndërsa lexuesit dhe poetët e epokës së Rilindjes dhe veçanërisht të periudhës së Revolucionit Borgjez frëng të 1789-ës, e ngritën lart Juvenalin si poet satirik e demaskues, duke e idealizuar dhe e paraqitur atë si luftëtar të flaktë në mbrojtje të lirisë republikane.

#### TACITI.

Midis historianëve më të shquar të Romës dhe Publ Kornel Taciti, (që ka jetuar nga vitet

55 deri në vitin 120). Duke qenë dhëndër i strategut të shquar Jul Agrikoles, që nënshtrroi Britaninë, Taciti arriti të zërë vende të rëndësishme në administratën e perandorisë. Disa vjet pas vdekjes së Agrikoles, që, siç mendohet u helmua nga perandori Domician, sepse ia kishte omirë laudinë, Taciti shkroi "Jetëshkrimin e Jul Agrikoles" (pas vrasjes së perandorit Domician, në vitin 96). Historiani iu paraqit kështu rasti të japë një tablo të zymtë të regjimit perandorak, duke e paraqitur Domicianin si një tiran. Me të gjallë të tij as do të kishte guxuar të thoshte qoftë edhe një gjysmë fjale kundër perandorit despot. Me ardhjen në fuqi të perandorit Nerva në vitin 96, që sundoi vetëm deri në vitin 98 dhe ishte me prirje liberale, Taciti e ndjeu veten më të lirë. Ai e përshëndeti sundimin e Nerves, i cili mundi "të bashkojë të pabashkuaren gjer atëherë principatin dhe lirinë".

Në vitin 98 Taciti shkroi veprën e njohur "Gjermania" me përmbajtje etnografike. Në të autori ka dhënë tablo interesante nga jeta dhe zakonet e fiseve gjermane. Vlera e madhe historike e kësaj monografie që shërbeu si një ngaburimet më të rëndësishme për veprën klasike të Engelsit "Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit" është e njohur tanimë në gjithë botën. Historiani flet në mënyrë të përgjithshme për të gjitha fiset, pastaj ndalet në mënyrë të veçantë në secilin prej tyre, përshkruan vendin ku banojnë dhe tregon nga mund të kenë ardhur.

Vepër tjetër e Tacitit është "Dialogu i oratorëve" ku përpiqet të zbulojë shkaqet e rënies së oratorisë. Në formë dialogu midis personazheve të ndryshme shfaqen mendime gjithë llojesh lidhur me shkaqet e rënies. Në pjesën përfundimtare të dialogut zbulohet pikëpamja e vetë autorit; arsytet e kësaj rënieje qëndrojnë në ndryshimet që ka pësuar rendi shoqëror. Sipas mendimit të Tacitit lulëzimi i oratorisë kushtëzohet nga liritë republikane.

Taciti shkroi edhe dy vepra të mëdha historike, që kabin periudhën nga vdekja e Augustit në vitin 14 deri në rënien e Domicianit në vitin 96. Ngjarjet nga viti 14 deri në 68 janë përfshirë në veprën "Analet", ndërsa ngjarjet që fillojnë nga viti 69, me turbullirat që sollën si pasojë rrëzimin e Neronit janë përfshirë në veprën "Historitë". Nga të 30 librat e këtyre dy veprave



është ruajtur vetëm një pjesë e tyre.

Taciti në kohën e tij ushqeu iluzione rreth rivendosjes së pushtetit të senatit. Por u bë e qartë se në kushtet e pushtetit perandorak kjo gjë ishte e pamundur. Me kalimin e kohës Taciti u bë pesimist. Ai e ndjente tani se shoqëria kish marrë tatëpjetën, se nuk kishte tjetër rrugëdalje, veç katastrofës që e priste atë në të ardhmen. Kjo bëri që në veprën e tij të ndihet një atmosferë tragjike në paraqitjen e historisë. Naracioni shtjellohet me dramatizëm veçanërisht atëhere kur ai sulmon despotizmin dhe degjenerimin social. Prandaj vepra e Tacitit dha një material të pasur për tragjeditë që shkroi në vonë Kornej, Rasini, Alfieri etj.

Taciti është një nga mjeshtrit më të shquar të portretit letrar në historiografinë antike. Ai synon gjithnjë të zbulojë shkaqet e fshehta të sjelljes së figurave historike, duke u futur thellë në psikologjinë e tyre. Shumë shprehëse janë figurat e perandorëve romakë Tiberit dhe Neronit. Arti këtu ndofta i ka dëmtuar faktet historike, megjithëse autori e siguron lexuesin për vërtetësinë e tyre.

Vepra e Tacitit si demaskues i despotizmit u çmua veçanërisht shumë në periudhën e revolucionit borgjez në Evropë dhe la gjurmën e saj në zhvillimin e mendimit politik evropian. Rusoi dhe enciklopedistet gjenin tek ai "ngjashmëri me shpirtin e tyre". Në atë periudhë u krijua gati një lloj kulti për Tacitin.

#### 4. LETËRSIA ROMAKE NË SHEKULLIN II ERA E RE

Në shekullin II era e re Perandoria Romake arriti pikën më të lartë të zhvillimit të saj. Tërë bota aso kohe mendohet se ishte "imperium romanum" (perandori romake). Kjo periudhë në historinë e Romës karakterizohet nga rritja e qyteteve, nga zhvillimi i rrugëve të komunikacionit dhe nga përhapja e kulturës romake në tërë territorin e perandorisë. Për këtë dhe për shekujt më pas veçori dalluese është zhvillimi ekonomik i qyteteve të provincave të Lindjes. Tregti të gjallë dhe tepër aktive bëjnë në këtë kohë qytete të tilla, si Mediolanum (Milano), Smirna (Izmiri), Efesi, Tiri, Sidoni, Damasku etj.

Në kohën e sundimit të perandorit Adrian, që zgjati

nga viti 117 deri në vitin 138, qendra e perandorisë, Italia, nuk e kishte më rëndësinë e mëparshme. Rëndësi të madhe në jetën ekonomike të perandorisë në atë kohë patën provincat e Afrikës së Veriut, Kartagjena, e rimëkëmbur qysh me planin e Jul Cezarit, u bë, krahas me Aleksandrinë, një nga qendrat më të mëdha tregtare të pellgut të Mesdheut. Në këtë pjesë lindore të perandorisë, ku rolin udhëheqës në gjithë jetën kulturore e luante gjuha greke, letërsia nisi të gjallërohet. U krijua kështu një lloj "Rilindje greke".

Në të njëjtën kohë në jetën shoqërore të Perandorisë Romake dolën në shesh më me forcë ato kondratikta, të cilat e çuan më vonë botën antike në krizë dhe në rënie të plotë. Tregues të kësaj krize të rendit skllavopronar që po afrohej me ritme të shpejta ishin dukuri të tilla, si shkatërrimi i pronarëve të vegjël dhe të mesëm të tokës, zhvillimi i kolonitit, koncentrimi i veglave dhe i mjeteve të prodhimit në duart e latifondistëve të mëdhenj të shoqërisë romake. Kjo ishte karakteristikë veçanërisht për Italinë. Por gjendja e masave të gjera popullore ishte e rëndë si në Itali ashtu dhe në të gjitha provincat e Perandorisë Romake. Kudo kishte taksa shumë të rënda, mjerim, shkatërrim. Në këto kushte letërsia romake nga shekulli në shekull shkoi duke u varfëruar dhe duke e humbur gjallërinë e saj të dikurshme. Një farë shtytje i dha kësaj lëvizja për të ringjallur letërsinë greke. Vetë perandori Adrian dhe rrethi i tij ishin helenofilë. Perandori Mark Aureli, që erdhi pas Adrianit, ditarin e tij me meditaciones "Vetvetes" e hartoi në gjuhën greke. Shumë shkrimtarë në këtë kohë shkruajnë në dy gjuhë. Një nga këta është dhe SVETON TRANKVILI. Ka jetuar rreth viteve 70-128 era e re. U shqua si mbledhës i palodhur i materialeve historiko-kulturore. Svetoni shkroi veprën "Mbi burrat e shquar" që është një burim i rëndësishëm për të njohur jetën e shumë shkrimtarëve romakë.

Në periudhën e sundimit të Adrianit perandoria hoqi dorë nga politika e pushtimeve sistematike dhe kaloi në gjendje mbrojtjeje. Por prapa kësaj qetësie të gënjeshtërt fshiheshin kontradikta të thella shoqërore, të cilat letërsia i kaloi në heshtje, duke u përqëndruar në çështje pa interes politik e shoqëror.

Ashtu si në letërsinë greke të kësaj periudhe edhe në Romë u duk rryma e arkaizmit, që tregoi interes për veprën e letërsisë së lashtë romake para Ciceronit. Udhëheqës i rrymës së arkaizmit ka qënë mësuesi i retorikës Frontoni (shk. II), i cili ka qënë dhe mësuesi i Mark Aurelit.

Krahas varfërimit të jetës letrare në Romë, në këtë kohë u shfaq një interes disi më i madh për letërsinë në ato kohë krahasa përëndimore të perandorisë, që kishin si gjuhë kryesore të kulturës gjuhën latine. Gjer në atë kohë Roma qe e vetmja qëndër e letërsisë në gjuhën latine dhe kishte tërhequr forcat më të mira të provincës. Tani e tutje gjendja do të ndryshojë. Edhe provinca romake, p.sh., Afrika, që kishte si kryevend Kartagjenën e që kishte fërkim me botën helenistike, dha shkrimtarin e saj Apuleun.

### APULEU

Apuleu lindi ( rreth 125 - 170 era e re)

në qytetin Madaura, në Afrikën e Veriut.

Mbasi mbaroi shkollën për retorikë në Kartagjenë, shkoi në Athinë për të mësuar filozofinë. Ai shëtititi shumë në vendet helenistike. Apuleu ka qënë retor-deklamator filozof poet, falltar.

Në veprën letrare të Apuleut kryqëzohen elemente të kulturave më të ndryshme. Ai shkroi në gjuhën latine dhe greke fjalime, vepra filozofike, vepra poetike të llojeve të ndryshme etj. Por ajo që i dha famë ishte romani "Metamorfozat", që më vonë e quajtën "Gomari i artë"!

Në këtë vepër tregohet për djalosin grek Luki, i cili për gabimin e një shërbëtoreje me anën e magjisë shndërron në gomar. Pas shumë aventurash dhe mundimesh ai mori përsëri trajtën njerëzore.

Romani i Apuleut ka karakter moralizues, pa çka se në të ka mjaft elemente erotike dhe aventuroze. Apuleu, siç kanë thënë në antikitet " të mëson duke të argëtuar". Në këtë vështrim romani qëndron shumë afër me romanet greke të periudhës aleksandrinë. Apuleu flet për pasionet dhe thotë se njeriu duhet t'u përmbahet atyre dhe të mos e lëshojë veten. Ai flet për domosdoshmërinë e përkryerjes morale. Karakter moralizues kanë dhe novelat e futura si shtojcë në roman, midis të cilave një margaritar i vërtetë i tërë veprës është novela, përrallë mbi Amurin dhe Psihen.

Pavarësisht nga prirja fetare moralizuese e veprës,

Apuleu ka dhënë në të një tablo mjaft reale të disa anëve të jetës së shoqërisë së kohës së tij. Ai tregoi karakterin autokratik të nëpunësve romakë në provincat e perandorisë dhe vizatoi, megjithëse fare pak, kushtet e tmerrshme të punës së skllavit ashtu dhe ato të punës së bujqëve të vegjël romakë.

## KREU V

### LETËRSIA ROMAKE NË SHEKULLIN III ERA E RE

#### DERI NË SHUARJEN E SAJ

Kontradiktat, të cilat kishin hedhur rrënjë në vetë themet e shoqërisë skllavopronare romake dhe që filluan të shfaqen shumë qartë nga fundi i shekullit II, në shekullin III shkaktuan një krizë të rëndësishme shoqërore ekonomike që çoi më vonë në dekompozimin dhe rënien e plotë të botës antike. Kriza në shekullin III erdhi si rrjedhim i mbështetjes së zëjtarisë dhe të tregtisë dhe i forcimit të ekonomisë së madhe ekstensive, e bazuar në punën e kolonëve.

Gjendja e masave të gjera të popullit ishte shumë e rëndësishme. Popullsia vuante nga taksat dhe nga dhuna e ushtrisë, që ishte mbështetja e pushtetit perandorak romak. Për periudhën e fundit të ekzistencës së Romës janë karakteristike kryengritjet e përbashkëta masive të skllavëve dhe të kolonëve. Ky ishte fillimi i revolucionit të skllavëve, që përmbysi më vonë shoqërinë antike skllavopronare.

Në shekullin IV Perandoria Romake u kthye në një monarki të centralizuar (dominati) me një aparat burokratik me një mori nëpunësish. Për këtë epokë karakteristike ishte zhvillimi i ekonomisë në natyrë, rritja e pronës së madhe mbi tokën dhe rënia e qyteteve. Popullsia u lidh me vendbanimin e saj dhe kjo bëri që asaj t'i ngarkohen mbi kurriz shumë taksa e detyrime në natyrë. Kristianizimi nga shekulli IV u njoh si fe zotëruese, dhe kisha nisi të luajë një rol shumë të madh në shoqërinë antike të shekujve të mëvonshëm.

Kultura e Perandorisë Romake e periudhës së fundit të saj pati të gjitha tiparet e rënies dhe të kalbëzimit.

Në filozofi u duk sistemi idealist i neoplatonizmit (Plotini, Porfiri), i cili karakterizohej nga misticizmi dhe asketizmi.

Në fushën e artit oratorik greko-romak kjo epokë ka-

rakterizohet nga ringjallja e sofistikes, por kjo sofistike ishte e zbehte persa i takon trajtimit te problemeve;

fjalimet e oratorëve vërtiteshin kryesisht në një rreth të mbyllur problemesh etike dhe synonin vetëm drejt efekteve të jashtme.

Duke filluar nga shekulli III e kësaj letërsia artistike e shkruar në gjuhën latine shkoi drejt një krize gjithnjë e më të madhe. Monarkia absolute, e centralizuar, siç u tha më lart, e formuar nga fundi i shekullit III, e zhvendosi qëndrën e saj nga Roma në Kostandinopol. Duke qënë se feja sunduese në këtë kohë u bë kristianizmi dhe letërsia kryesisht u zhvillua në ndikimin e fortë të tij. Megjithatë format e vjetra letrare vazhduan të mbijetojnë deri në rënien e plotë të pjesës perëndimore të perandorisë dhe të shkatërrimit të saj nga fiset barbare.

Për ruajtjen e kulturës së lashtë letrare rol të rëndësishëm luajti shkolla, ku nxënësit, përmes veprave letrare, mësonin gjuhën e vjetër klasike, nga e cila gjuha e folur në atë kohë ishte shumë larg; mësonin gramatikë dhe retorikë, mësonin metrikën klasike, që bazohej në dallimin e rrokjeve të gjata dhe të shkurtra, gjë që ishte zhdukur në gjuhën e folur. Latinishtja klasike u bë gjuha e klasës së lartë, pavarësisht nga dallimi fetar. Prozatorët kristianë Minuc Feliksi, Laktoni, Jeronimi, Augustini etj. përdorin në po atë stil teorikë që përdorën edhe shkrimtarët paganë, të cilët jetuan në një kohë me ta; kurse poetët kristianë iu vunë punës për të ritreguar subjektet biblike sipas mënyrës stilistike të Virgjilit.

Shfaqje interesante në letrësinë romake të shekullit IV është krijimi i një rrethi letrarësh, që u grupuan rreth oratorit Simah. Ky rreth, që i qëndroi besnik fesë së lashtë, përballë kristianizmit vuri traditat e kulturës së lashtë romake. Ky rreth bëri një punë të mirë duke komentuar dhe redaktuar tekstet e shumë shkrimtarëve të lashtë romakë.

Midis shkrimtarëve të fundit romakë të njohurit kanë qënë Aurel Nemesiani, Ausoni, Ammion Marcelini dhe Klau-diani. Por veprat e tyre nuk u dalluan për përmbajtje të thellë ideore. Këto ishin ose vjersha që himnizonin perandorët dhe të afërmit e tyre, ose ekloga baritore, ose

vepra që përsëritnin subjekte të lashta mitologjike. Në këtë poezi nuk trajtoheshin probleme të rëndësishme dhe as figura të gjalla njerëzore.

Në periudhën e perandorisë së vonët rëndësi të madhe mori letërsia kristiane. Ishte tanimë koha e lindjes së letërsisë mesjetare në gjuhën latine.

Shpesh përfaqësues të letërsisë romake në shekujt e mëvonshëm u bënë qytetare të romanizuar të ardhur nga provinca, si:

AUREL NEMESIANI, me origjinë nga Afrika, ( shek. III era e re) që shkroi ekloga baritore në ndikimin e Virgjilit. Në to ai pasqyroi prirjet që u shfaqën në atë kohë për të jetuar në gjirin e natyrës.

DECIM MAGN AUSONI ( shek. IV) nga Burdigali ( Bordoja e sotme) Në fillim ka qënë mësues në vendlindjen e tij, më vonë erdhi në Romë, ku zhvilloi veprimtarinë e tij si poet.

Ai shkroi vjersha lirike dhe poema të shkurtra, si poema " Mosela", në të cilën poeti përshkruan udhëtimin e tij në lumenjtë Rin dhe Mozellë. Poeti këndon bukuritë e lumit Mozellë, brigjet dhe lëndinat që e rrethojnë atë. Përshkrimet e natyrës janë tepër të gjalla e piktoreske, por ndonjëherë vërehen edhe elemente të tepruara të natyralizimit, p.sh., përshkrimi i peshqve etj. Në poemë janë futur dhe figura mitologjike, me të cilat poeti mahnitet duke i parë ato si krijime të mrekullueshme të fantazisë popullore.

Në veprën e Ausonit, spikat dashuria për vendlindjen e tij Galinë, veçanërisht për krahinën ku lindi.

KLAUD KLAUDIANI. Ka jetuar në gjysmën e dytë të shekullit IV deri në fillim të shekullit V-të erës sonë. Klaudian i takon atij drejtimi poetik, që himnizonte sukseset e Romës në luftë me barbarët. Me origjinë ishte grek nga Aleksandria. Shkroi në latinisht dhe greqisht idile, epigrame, poema të shkurtra. Midis tyre shumë e njohur u bë poema " Rrëmbimi i Prozerpinës", shkruar në subjekt mitologjik, me një stil të bukur dhe elegant.

Vjershat e Klaudianit, si vepra të shkruara në periudhën e krizës dhe të rënies së botës antike, nuk dallohen për ndonjë përmbajtje të thellë ideore. Në to kryesisht gjejmë përshkrime të bukura të natyrës si dhe figura të veçan-

ta mitologjike të vizatuara me një stil elegant. Qëndrimi i poetit ndaj miteve dallohet qartë nga qëndrimi ndaj mitologjisë i poeteve grekë të periudhës klasike po ashtu dhe nga qëndrimi i poetëve romakë të periudhës së hershme letrare. Për Klaudianin mitet janë vetëm arsenal, nga ku ai merr lëndë për artin e tij, por nuk arrin të krijojë mbi këtë lëndë vepra me ide e probleme të rëndësishme.

Shumë vjersha të kohëve të Vonë kanë ardhur deri tek ne në një përmbledhje me titullin "Antologjia latine", Kjo përmbledhje me sa duket është përpiluar në Afrikë në shekullin VI dhe përmban vjersha të kohëve të ndryshme.

AMMIAN MARCELINI. Ka jetuar në gjysmën e dytë të shekullit IV. Është historiani i fundit i madh i Romës në periudhën e rënies së saj. Ammiani vazhdoi veprën "Historitë" e Tacitit, që nga koha e sundimit të perandorit Nervë (96-98). Nga vepra e Marcelinit deri në ditët tona kanë ardhur librat, që përshkruajnë ngjarjet bashkëkohëse me autorin. Ammiani u bë ideolog i Perandorisë Romake, ndaj dhe në veprën historike të tij e ngre lart figurën e perandorit Julian, por për të qënë objektiv, vë në dukje edhe ndonjë të metë të tij. Ammiani ishte grek me origjinë, nga qyteti Antiohia, ndaj edhe gjuha e tij është e mbushur me greqizma dhe me ndërtime fjalish që janë të huaja për gjuhën latine.

Zhvillim të veçantë në këtë periudhë mori proza narative. Vepra si "Bëmat e Aleksandrit", "Diktis", "Dareti" etj., që i përkëmbin letërsisë greke të periudhës romake, u përpunuan në gjuhën latine dhe, në sajë të këtij përpunimi.

Evropa u njoh me këto tregime, të cilat në origjinal nuk na kanë arritur. Poeti i letërsisë kalorsore në kohën e mesme, Benua de Sent Mor më tepër u mbështet në këto vepra sesa në "Iliadën" e Homerit për të shkruar "Romanin mbi Trojën".

Sukses të madh në kohën e mesme pati dhe romani latin aventuror "Historia e Apoloniut, mbretit të Tirit", ku është trajtuar subjekti i njohur në letërsinë botërore rreth familjes që e shpërndajnë dallgët e fatit dhe më në fund e bashkojnë.

Këto janë rrugët nëpër të cilat eci dhe u zhvillua letërsia romake deri në rënien e pjesës perendimore të pe-



randorisë , deri në shkatërrimin e saj nga kontradiktat e brendshme ( lëvizjet dhe kryengritjet e sklleverve, të kolonëve dhe të shtresave të tjera të shtypura të popullsisë romake), si dhe nga faktorë të jashtëm ( dyndja e fiseve barbare në territorin e gjerë të perandorisë, të cilën e nënshtruan ).Këto fise e popuj barbarë, me strukturë shoqërore politike dhe me zakone krejt të ndryshme nga ato të popujve të pushtuar nga Roma, mbi rrënojat e perandorisë ndërtuan bërthamën e shteteve të ardhshme mesjetare feudale.

----- 0 -----

44

## PASQYRA E LËNDËS

### Kreu I

- Letërsia romake ,	1
1. Periudha paraletrare	3
2. Shoqëria dhe kultura romake në shekullin III dhe në gjysmën e parë të shekullit II para erës së re.	12
3. Poetët e parë romakë.	15
Liv Androniku	15
Gnej Nevi	16
Kuint Enni	17
4. Komedia romake	18
Plauti	18
Terenci	27
5. Zhvillimi i prozës	33
Katoni	33

### KREU II

- Letërsia e shekullit të fundit të republikës	37
Gaj Lucili	44
Ciceroni	45
1. Zhvillimi i historiografisë romake	51
Jul Cezari	51
Salust Kripsii	52
Kornel Nepoti	54
Lukreci	54
Katuli	64

### KREU III

- Letërsia romake në epokën e Augustit	70
1. Shoqëria dhe kultura romake .	70
Virgjili	76
Horaci	93
2. Zhvillimi i elegjisë romake	105
	149

Gaj Kornej Gali .	105
Tibuli	106
Properci	107
Ovidi	110
3. Zhvillimi i historiografisë	188
Tit Livi	

#### KREU IV

- Zhvillimi i letërsisë romake në shekullin I dhe II të erës së re.	121
1. Shoqëria romake dhe kultura në shekullin I.	125
Seneka	
2. Poetë të tjerë të shekullit I të erës së re	129
Mark Anes Lukani	131
Aul Pers Flaku	131
Gaj Petroni	132
Fedri	133
3. Prirje klasiciste në letërsi.	135
Marciali	137
Juvenali	138
Taciti	140
4. Letërsia romake në shekullin II era e re	142
Apuleu	

#### Kreu V

- Letërsia romake në shekullin III era e re deri në shuarjen e saj	144
--	-----

Khaxhiu Myzafer  
Historia e letërsisë romake: Ripunim/  
Përgatitur nga Myzafer Khaxhiu; Red.:  
M.Mato..T.Shtëpia Botuese e Librit  
Universitar, 1989...f.;...cm. (U.T.  
" Enver Hoxha".Fakul.i Historisë dhe i  
Filologjisë)

871(09)(075.8)

Xh 39